



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI
KOMBËTARI I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

KRYETARI I K.K.T-së

Z. DAMIAN ÇIKNURI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Z. SHKELQIM SHERO

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr.27 Datë 16.08.2017

Kryetari i Bashkisë

Z. SHUAIP BEQIRI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË KONISPOL

PLANI I ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.4 , Datë 16.10.2017

DPKZHT: **ARTUR BEQIRI**

STUDIO KONSULENTE “DEA STUDIO” Nr.Liç. 4919/4 dhe “THYMIO PAPAYANNIS &
ASSOCIATES INC”



TABELA E PËRMBAJTJES

1. PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE	5
1.1 NDARJA E TERRITORIT SIPAS PESË SISTEMEVE TERRITORIALE	5
1.2 ZONIMI SIPAS KATEGORIVE BAZË DHE NËNKATEGORIVE TË PËRDORIMIT TË PROPOZUAR TË TOKËS.....	9
1.3 NDARJA E TERRITORIT NË NJËSI ZHVILLIMI.....	26
1.4 POZICIONIMI I RRJETEVE TË INFRASTRUKTURËS SI EDHE KUSHTET TEKNIKE PËR REALIZIMIN E TYRE.	29
1.4.1 Transporti ekzistues.....	29
1.4.2 Infrastruktura publike ekzistuese	30
1.4.2.1 Infrastruktura rrugore	30
1.5 ZONAT E MBROJTURA KOMBËTARE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE MONUMENTEVE	44
1.6 ZONAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN	49
1.7 TIPOLOGJITË E PROPOZUARA HAPËSINORE DHE METODAT E NDËRHYJES NË TERRITOR	53
1.8 PËRCAKTIMI I NJËSIVE QË DO TI NËNSHTROHEN HARTIMIT TË PDV-VE SIPAS LIGJIT.....	59
1.9 SHPËRNDARJA E POPULLSISË DHE PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE	62
1.10 PLANI STREHIMIT	68
1.11 PËRCAKTIMI I ZONAVE/NJËSIVE, KU DO TË ZBATOHEN INSTRUMENTAT PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT DHE ZBATIMIN E PDV - VE	68
2. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT	71
2.1 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E PEJAZHIT NATYROR DHE KULTUROR	75
2.2 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E ELEMENTEVE UJORE	76
2.3 PARASHIKIMET PËR SHTIMIN DHE/OSE ZGJERIMIN E HAPËSIRAVE TË GJELBRA. MBROJTJA E BIODIVERSITETIT	80
2.4 PARASHIKIMI I VARIANTEVE PËR ZGJIDHJE TË PROBLEMATIKËS SË EVIDENTUAR PËRSA U PËRKET HOTSPOTEVE	82
2.5 PARASHIKIMET PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT	82
2.6 ZHURMAT DHE NDOTJA AKUSTIKE	84
2.7 PARASHIKIME PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE	85
2.8 PARASHIKIME PËR MBROJTJEN E TOKËS	85
2.9 VEPRIMI MBI ASETET E BASHKISË KONISPOL/ KOHEZIONI SOCIAL	86
3. PLANI I SHERBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE	89
3.1 INFRASTRUKTURA PUBLIKE E PROPOZUAR	89
3.1.1 Transporti i propozuar.....	89
3.1.2 Infrastruktura rrugore e propozuar.....	92
3.2 RRJETI I PROPOZUAR I INFRASTRUKTURES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE	94
3.2.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë.....	96
3.2.2 Rrjeti i propozuar i kanalizimeve.....	102
3.2.3 Rrjeti i furnizimit me energji dhe telekomunikacioni.....	108
3.2.4 Menaxhimi i mbetjeve urbane.....	110
3.2.5 Administrim mbetjesh dhe mbrojtje e mjedisit	110
3.2.6 Administrim burimesh natyrore dhe kulturore.....	111
3.2.7 Mbrojtje kombëtare, civile e kundër zjarrit	113
3.3 KONSIDERATA MBI PLANET E NIVELEVE TE TJERA DHE NDIKIMI I TYRE MBI TERRITORIN.....	114
3.4 TIPOLOGJIA DHE SHPËRNDARJA NË TERRITOR E SHËRBIMEVE SOCIALE	115
4. PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PPV-VE.....	126
4.1. FAZAT E ZBATIMIT TË ZHVILLIMIT, TË NDARA NË PERIUDHA KOHORE BRENDA VLEFSHMËRISË SË PLANIT.....	126
4.2 KOSTO E PËRGJITHSHME PËR ZBATIMIN DHE AKTIVITETET KRYESORE TË FINANCUARA, TË SHOQËRUARA ME PLANIN E INVESTIMEVE KAPITALE.....	132
4.3 NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË KUADRIN LIGJOR DHE ADMINISTRATIV NË NIVEL VENDOR	137
4.4 INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PPV.....	138
4.5 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCËS PËR PLANET E DETAJUARA VENDORE	142
4.6 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCËS PËR PLANET SEKTORIALE	145



4.7 EVIDENTIMI I FAKTORËVE, QË MUND TË SHKAKTOJNË NJË RISHIKIM TË PJESSHËM TË PPV-VE.....	146
5. SHTOJCA E PPV-VE.....	148
5.1. VLERËSIMET PËR PLANIN	148
6. RAPORTI PËR KAPACITETET INSTITUCIONALE	154
6.1 VLERËSIMI I SHPEJTË I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DEPARTAMENTIT TË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT.....	154
6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki	155
6.1.2 Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit	156
6.1.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit	158
6.1.4 Vlerësimi i aftësive të stafit ekzistues për të vepruar në departamentin e propozuar.	158
6.2 ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE MARRËVESHJET E ZBATIMIT	158
6.2.1 Përgatitja e një raporti të shkurtër, që përcakton marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim.....	158
6.2.2 Korniza e zbatimit, e cila përdor gjetjet nga pika 4.1 dhe identifikon fazën, në të cilën shkrihen propozime organizative, administrative dhe politike dhe/ose ndryshime që mund të prezantohen.	159
7. DËGJESA ME PUBLIKUN.....	162
FORUMI	164

Lista e Tabelave:

Tabela 1. Ndarja e Territorit sipas pesë sistemeve territoriale.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 2. Kategorizimi sipas Shtojcës III. VKM Nr.671	7
Tabela 3. Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 4. Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi	27
Tabela 5. Kategoritë e sistemit rrugor	36
Tabela 6. Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në bashkinë Konispol.....	46
Tabela 7. Lista e monumenteve të kulturës në bashkinë Konispol.....	47
Tabela 8. Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së	60
Tabela 9. Projektionet e popullsisë 2016-2031, bashkia Konispol.....	62
Tabela 10. Projektionet e popullsisë 2016-2031, bashkia Konispol	64
Tabela 11. Të dhënat për përllogaritjen e popullsisë së turizmit.....	65
Tabela 12. Shpërndarja e zonave të zhvillimit.....	65
Tabela 13. Shpërndarja territoriale e popullsisë.....	66
Tabela 14. Statusi i banimit të banesës.....	68
Tabela 15. Kërkesat cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE-në.....	77
Tabela 16. Treguesit fiziko-kimike të ujit të pishëm të bashkisë Konispol dhe objektivat.....	77
Tabela 17. Treguesit mikrobiologjike të ujit të pishëm të bashkisë Konispol dhe objektiva	78
Tabela 18. Siperfaqet e propozuara të zonave të mbrojtura, të trashgimisë kulturore dhe monumenteve... ..	81
Tabela 19. Siperfaqet e gjelbra dhe publike	82
Tabela 20. Monitorimi i gurave dhe rehabilitimi.....	82
Tabela 21. Vlerat e kufi të ndotësve	83
Tabela 22. Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t'u monitoruar në bashkinë Konispol.....	83
Tabela 23. Objektivat për reduktimi e mbetjeve.....	85
Tabela 24. Monitorimi i tokës bujqësore	85
Tabela 25. Monitorimi i pyjeve dhe zonave të mbrojtura dhe të gjelbra	114
Tabela 26. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësisë për shërbime sociale - Njësia Administrative Xarrë.....	116
Tabela 27. Propozime për shërbime sociale.....	119
Tabela 28. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësisë për shërbime sociale - Njësia Administrative e Konispolit	119



Tabela 29. Propozime për shërbime sociale.....	120
Tabela 30. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësisë për shërbime sociale - Njësia Administrative Markat	122
Tabela 31. Propozime për shërbime sociale.....	123
Tabela 32. Modulet e trajnimit	160

Lista e Figurave:

Figura 1. Hierarkia rrugore.....	35
Figura 2. Gropa septike familjare	39
Figura 3. Humbje teknike të ujit	39
Figura 4. Harta e zonës RAMSAR Butrint sipas VKM 134.....	45
Figura 5. Shpella e Konispolit dhe Kanali i Vivarit.....	46
Figura 6. Rehabilitimi i unazës ekonomike të Bashkisë Konispol (Vrinë - Shkallë)	49
Figura 7. Objektet e njësive bujqësore të përpunimit dhe paketimit të ullinjve,	50
Figura 8. Renditja, ruajtja, paketimi dhe shpërndarja e produkteve bujqësore, kompania private	51
Figura 9: Grafiku i projeksioneve të popullsisë për bashkinë Konispol	63
Figura 10. Mbetje të hedhura në mjedise të ndryshme	87
Figura 11. Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore	94
Figura 12: Harta skematike e trashëgimisë së Konispolit	112
Figura 13. Poli ekonomik Gjirokastër-Sarandë, Porta Jugore e Rivierës Shqiptare.....	114
Figura 14. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV Konispol.....	163
Figura 15. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV-në Konispol	163
Figura 16. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV-në Konispol	163

Lista e Hartave:

Harta 1 - (18a) Pesë sistemet territoriale	9
Harta 2 - (18b) Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara	12
Harta 3 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Konispol.....	21
Harta 4 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara, Dishat-Verve.....	211
Harta 5 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara, Janjar	222
Harta 6 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Markat-Ninat	222
Harta 7 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Shkallë-Ciflik.....	223
Harta 8 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Vrinë-Shendelli.....	223
Harta 9 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Xarre	224
Harta 10 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Mursi	224
Harta 11 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Kepi i Stillos.....	225
Harta 12 - (18c) Nënkatëgoritë të përdorimit të tokës të propozuara , Shales	225
Harta 13 - (18i) Njësitë strukturore.....	2828
Harta 14 - (19c) Rrjeti rrugor dhe vendparkimet publike të propozuara	377
Harta 15 - (19e) Hapësirave publike, rrugëve të biçikletave dhe këmbësore të propozuar.....	433
Harta 16 - (18g) Harta e objekteve dhe zonave të rëndësishme kombëtare të propozuara	4848
Harta 17 - (18d) Zonat, polet, korridoret ekonomik të propozuara	522
Harta 18 - (18f) Harta e tipologjisë hapësinore të ndërtimeve.....	544
Harta 19 - (18e) Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar.....	5858
Harta 20 - (18h) Zonat subjekt i PDV/PDZRK	611
Harta 21 - (18j) Shpërndarja e popullsisë dhe plani i strehimit.....	677
Harta 22 - (20) Instrumentet e zhvillimit të propozuar	70
Harta 23 - (2f) Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore.....	744
Harta 24 - (19g) Transporti publik	911
Harta 25 - (19a) Rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm të propozuar	1011
Harta 26 - (19b) Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të propozuar.....	1077
Harta 27 - (19d) Rrjeti i furnizimit me energji të propozuar.....	1099
Harta 28 - (19f) Objektet e shërbimeve sociale.....	1255
Harta 29 - (21) Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe infrastrukturave.....	1311



1. PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE

1.1 Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) është drejtimi i zhvillimit të sistemit urban të banimit dhe harmonizimi i tij me 4 sistemet e tjera në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Në këtë kontekst, ruajtja, mënyra e përdorimit dhe, sipas rastit, konsolidimit të sistemeve të tjera territoriale janë pjesë e këtij objekti. Pikërisht për qëllime planifikimi dhe menaxhimi, territori ndahet në 5 sisteme territoriale, të cilat përcaktohen në nivel makroplanifikues që në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, dhe detajohen përmes Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së PPV-së. Propozimet territoriale të prezantuara në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të bashkisë Konispol, të detajuara në këtë dokument, janë reflektuar edhe në sistemet territoriale të propozuara, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit (VKM nr.671), si më poshtë:

Sistemi urban. Ky sistem përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme në territor. Analiza e këtij sistemi është të na japë një vështrim të përgjithshëm të të gjithë pejzazhit të ndërtuar dhe të theksojë llojshmërinë tipologjike të pranishme në zonën e territorit bashkiak. Ky sistem formohet nga bashkimi i territoreve urbane. Konispoli është më pak i urbanizuari nga të katër bashkitë bregdetare. Ai përbëhet nga vendbanimet rurale të luginës së Vrinës, fshatit të vjetër të Konispolit dhe disa hapësirave urbane përgjatë rrjetit të rrugëve kryesore.

Sistemi infrastrukturor. Ky sistem përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar dhe në nivel vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”(IN). Infrastruktura rrugore që lidh Konispolin me qendra të tjera apo me rrugët nacionale është në gjendje tejet të keqe, ndërkohë që lë mjaft për të dëshiruar edhe infrastruktura urbane. Aksesueshmëria rrugore në zonën e studimit nëpërmjet korridoreve rrugore të jugut të Shqipërisë është përmirësuar ndjeshëm kohët e fundit, kryesisht për shkak të zgjerimit të dukshëm dhe programit të përmirësimit të infrastrukturës zbatuar në të gjithë vendin.

Sistemi bujqësor. Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë e tokës, kanalet vaditëse dhe rezervuarët në shërbim të saj. Ky sistem është shumë i rëndësishëm për bashkinë e Konispolit. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”(B). Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njëjësore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor.



Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi. Në pjesën më në brendësi të territorit, midis Konispolit dhe Çiflikut, i cili është kodrinor, janë promovuar kultivimet e reja të ullirit. Dy janë çështjet kryesore të lidhura me rregullimin dhe modernizimin e prodhimit bujqësor si edhe me rritjen e konkurruesmerise. E para ka të bëjë me strukturën e pronësisë mbi tokën. Toka është pothuajse tërësisht e privatizuar dhe e copëzuar. E dyta për rrjedhojë është niveli shumë i ulët i prodhimit në krahasim me nevojat për eksport. Bujqësia në zonën e Konispolit është e përqëndruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat.

Sistemi ujqor. Të gjithë elementet që lidhen me ujin përbëjnë sistemin ujqor. Bashkia e Konispolit është formuar nga një kombinim i elementeve të ujërave tokësorë me ato bregdetarë. Sistemi ujqor formohet nga rrjeti mekategori bazë tëpërdorimit të tokës “ujë” (U).

Sistemi natyror. Ky sistem zë sipërfaqen më të madhe të territorit të Konispolit. Ai përbëhet kryesisht nga kullota dhe tokë pyjore (shkurre e shkozë). Në sistemin natyror përfshihen pejzazhet, hapësirat e paprekuara të natyrës që kanë si kategori bazë të përdorimit të tokës “natyrë” (N) dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm. Për sistemin natyror, është i rëndësishëm të theksohet se teritori i bashkisë Konispol kufizohet me Parkun Kombëtar të Butrintit dhe madje një pjesë e territorit të kësaj Bashkie është pjesë përbërëse e territorit të mbrojtur të Parkut.

Përgjithësisht, kjo PPV ka adaptuar një qasje konservative përse i përket konvertimit të sistemeve territoriale, duke u munduar të ruajë sa më shumë tokat e sistemit bujqësor dhe natyror. Për këtë arsye, PPV-ja propozon kryesisht tipologji ndërhyrjeje në territor që kanë të bëjnë me konsolidimin apo rigjenerimin e përdorimeve ekzistues për të përmbushur nevojat ekzistuese dhe ato të propozuara për zhvillim të bashkisë Konispol.

Tabela 1: Ndarja e Territorit sipas Pesë Sistemeve Territoriale

Sistemet Territoriale	Sipërfaqe (ha)	Xarre	Konispol	Markat	Total	Ndryshimi në %
Sistemi Urban	Ekzistuese	174.59	131.03	123.39	429.01	27.57%
	E propozuar	250.99	165.07	131.21	547.27	
Sistemi Natyror	Ekzistuese	5344.47	3456.04	7397.41	16197.92	1.47%
	E propozuar	5595.23	3449.66	7391.02	16435.91	(-0.07%)
Sistemi Bujqësor	Ekzistuese	2588.28	951.48	1134.67	4674.43	-7.73%
	E propozuar	2261.12	919.96	1132.24	4313.32	(-2.37%)
Sistemi Ujqor	Ekzistuese	583.88	103.65	324.55	1012.08	0.00%
	E propozuar	583.88	103.65	324.55	1012.08	
Sistemi Infrastrukturor	Ekzistuese	23.44	10.37	28.33	62.14	7.02%
	E propozuar	23.44	14.23	28.83	66.50	



Tabela 2. Kategorizimi sipas Shtojcës III. VKM Nr.671

SISTEMI URBAN	2031
Sipërfaqja e territorit urban	547.27 ha
Sipërfaqja e infrastrukturës	66.50 ha
Popullsia Instat Census 2011	8245 banorë / progresion 8053
Popullsia Gj.Civile aktuale	13.968 banorë
Strehimi social	0 ha
Shërbime administrative	1.11 m ² /ba
Shërbime sociale - arsim	3.17 m ² /ba
Shërbime sociale - shëndetësi	0.46 m ² /ba
Transporti publik	1 Linje expres interurbane 4 Linja Lokale (furgon)
Ndarja në zona (njësi)	13 Zona ; 187 Njesi strukturore
Sipërfaqe të gjelbra	27.81 m ² /ba
Sipërfaqe sportive	5.55 m ² /ba
Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banorë	1.07 m ² /ba
Monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore	82.55 ha
Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare	1.88 ha
Dendesia për ha	0.62 ba/ha
Parkime	230
Indikatorët Gdp/sectorë/lloji bizneseve/çmimet/punësimi/ punësimi për sektor/taksat vendore/borxhi/shpenzimet sipas sektorit	Sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik: Bujqësia, blegtoaria, agroturizëm.
Pronat publike dhe private (from analiza)	128.85 ha
Parkime/banorë	4 Zona

SISTEMI BUJQESOR	2031
Sip. Territor bujqësor	4313.32 ha
Sip. Territor bujqësor primar (Boniteti I-IV)	3977.61 ha
Sip. Territor bujqësor dytësor (Boniteti V-X)	331.88 ha
Sip. Territor bujqësor me sistem ujitjeje	3629.27 ha
Sip. Territor bujqësor pa sistem ujitjeje	635.68 ha
Sip. Tok pafryt	0 ha

SISTEMI UJOR	2031
---------------------	-------------




Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol

Ujëra tokësore	594.56 ha
Ujëra bregdetare	452.56 ha

SISTEMI INFRASTRUKTUROR	2031
Rrugë kombëtare	0 km
Rrugë interurbane	63.87 km
Rrugë urbane parësore	0 km
Hekurudha	0 km
Porte	0 km
Ujësjiellës-Kanalizime (km)	38.92 km

SISTEMI NATYROR	2031
Sip. e përgjithshme	14579.71 ha
Sip. pyjore	607.28 ha
Sip. Kullota	6613.73 ha
Sip. të gjelbra	1093.16 ha
Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm	2756.37 ha



Harta 1 - (18a) Pesë sistemet territoriale

1.2 Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës.

Komponenti themelor i Planit të Zonimit është harta e propozuar e përdorimit të tokës. Çdo zonë e propozuar, përfshin parimet e zhvillimit, që do të shprehet në formën e rregulloreve në fazën e ardhshme. Procesi i zonimit, në vetvete, ka një rëndësi strategjike për të bërë planifikimin dhe është i bazuar në praktikat më të mira dhe eksperiencën profesionale të Konsulentit. Një qasje sistematike, e cila merr në konsideratë një sërë parimesh udhëzuese, normash ekzistuese, si edhe kufizimet kryesore në nivel kombëtar, është hartuar për të mbështetur procesin e zonimit dhe për të minimizuar zgjedhjet arbitrare, duke synuar paralelisht planifikimin e një sërë rregullash të thjeshta dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i cili do të lehtësojë procesin e zbatimit.

Parimet gjithëpërfshirëse të zonimit

Parimet e procesit të zonimit, të përdorura në krijimin e Planit të Zonimit, kanë marrë parasysh evolucionin historik të zonës, si edhe diferencimin gjeografik dhe morfologjinë e territorit të cilat krijojnë një strukturë hapësinore unike të bregdetit të bashkisë Konispol. Në të njëjtën

kohë, procesi i zonimit përfshin edhe filozofinë e qëndrueshmërisë të miratuar në nivel global me konsideratë të veçantë në udhëzimet e politikave kombëtare dhe praktikat e suksesshme të ndjekura në vendet evropiane. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor përpigjen të krijojnë barazi dhe drejtësi brenda zonës së planifikimit, duke ruajtur edhe rritjen e potencialit të zhvillimit për brezat e ardhshëm.

Një detyrë e rëndësishme në procesin e zonimit është identifikimi dhe propozimi i zonave urbane dhe rurale të zgjerimit për çdo njësi të zonës së studimit, si edhe përcaktimi i zonave të reja të zhvillimit. Kjo nënkupton një seri vendimesh që janë të bazuara në:

- Vizionin hapësinor për zhvillimin e ardhshëm në bashkëpunim me Bashkinë.
- Identifikimin e nevojave programore në bazë të parashikimeve shkencore, adaptimin e standarteve kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Detajimin e hollësishëm të tokës për çdo lokalitet në studim.
- Planifikimin ekzistues dhe rregulloren e kufizimeve.

Mënyra se si faktorë të ndryshëm janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit të nënndarjeve, shpjegohet si më poshtë:

Modelet primare të përdorimit të tokës. Kjo përfshin evidentimin e përdoruesve primarë të tokave, që ndodhen në nënndarjet ekzistuese në nivel rajonal, duke përfshirë të gjithë territorin e Bashkisë. Një klasifikim i parë është bërë ndërmjet tokës urbane dhe asaj jourbane, bujqësore dhe sistemeve natyrore të zonës së planifikimit. Zona është identifikuar fillimisht sipas përdorimit kryesor të tokës dhe në rastet kur mbizotëron një larmi përdorimesh, duhet të bëhen nënndarje të tjera, që korrespondojnë me përdorimin ekzistues. Konsulenti ka përdorur klasifikimin e hartave PINS Bregdeti për klasifikimin e zonave si tokë urbane, tokë bujqësore, pyje dhe kullota.

Ndarja dytësore e përdorimit të tokës. Në një fazë të dytë, për ndarjen e zonave të ndryshme, duhen marrë parasysh karakteristikat e veçanta brenda një modeli të përdorimit kryesor të tokës. Kjo përfshin një studim të ndryshëm për zona të ndryshme, në të cilin bëhet dallimi mes zonave të banuara dhe zonave me karakter të përzier (banim i kombinuar me veprimtari të tjera), si edhe nivele të ndryshme të densitetit. Analiza është bërë në mënyrë të ngjashme, edhe pse me më pak hollësi për kategoritë jourbane të tokës, sidomos në zonat që janë identifikuar si zona zhvillimi nga vizioni hapësinor.

Zhvillimi historik. Përcaktimi i strukturës hapësinore do të thotë marrjen në konsideratë të proceseve të ndryshme të zhvillimit urban, të cilat kanë përcaktuar karakterin e pejzazhit, që është formuar nga vendndodhja e zonave dhe rrethinat e tyre kufitare. Kjo nënkupton një trajtim të diferencuar midis pjesëve malore dhe zonës në drejtim të detit, në lidhje me vendndodhjen e zhvillimeve të reja, si edhe mënyrën se si zona të ndryshme janë të lidhura me njëra - tjetrën. Në shkallë urbane ajo përfshin konsideratat për zonat e ndërtuara në kohë dhe regjime të ndryshme, lagjet e vjetra në zonat historike dhe rolin historik të lokaliteteve të caktuara brenda qytetit.



Sistemi Infrastrukturor - Referenca për hierarkinë e rrjetit rrugor. Nënndarjet hapësinore të zonave të zhvillimit duhet të kryhen në përputhje me hierarkinë e rrjetit rrugor. Zonat homogjene të banimit (lagjet) dhe zonat periferike (fshatrat) duhet të përcaktohen dhe jo të përshkohen nga arteriet rrugore urbane (kryesore dhe dytësore), dhe ato ndërrubane (kombëtare ose rajonale). Vëmendje e veçantë i është kushtuar artikullimit të trafikut automobilistik në brendësi të qendrës së zonave tradicionale dhe atyre turistike, si edhe atyre që lidhen me ambientet ujore, me qëllim për të shmangur parandalimin e varësisë së zonave të banuara me detin. Kategorizimi i hierarkisë së rrjetit ekzistues dhe atij të ri rrugor në çdo zonë, u bë paralel me procesin e zonimit të shfrytëzimit të tokës.


Referenca të kufizimeve gjeografike. Nënndarja sipas kufizimeve gjeografike (lumenj, thyerje, kodra dhe fusha etj), është një qasje shumë praktike në procesin e përcaktimit me të hollësishëm të zgjerimeve urbane dhe atyre periferike, si edhe të zonave të reja të zhvillimit. Në fazën e analizës Konsulenti identifikoi në kontekstin e Hartave Përrjashtimore fushat dhe kriteret e përjashtimit të zhvillimit, të bazuar në përkufizimin e zonave natyrore, sipërfaqet e shpateve të pjerrëta, zonat e prirura për përmbytje, sikurse ato të mbrojtjes së burimeve ujore sipas legjislacionit kombëtar dhe PINS Bregdeti. Në mënyrë të ngjashme janë vendosur një sërë kriteresh për zonat e mbrojtjes mjedisore dhe pejsazheve, të cilat marrin në konsideratë parametrat topografikë dhe vizualë, të tilla si mbrojtja e majave, grykave dhe luginave, deltave aktive, etj, sikurse përmendet në pikat e mëposhtme:

Mbrojtja e sistemit natyror. Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol



Harta 2 - (18b) Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara

Sistemi Bujqësor. Nënndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me toka bujqësore.

Mbrojtjen e peizazheve kulturo-bujqësore, të cilat pasqyrojnë historinë e bujqësisë tradicionale në rajon janë përcaktuar nga zonimi i territorit.

Përveç faktorëve të mësipërm, ndarja e zonave dhe përcaktimi i zonave të zhvillimeve të reja, si edhe zonat e reja të zgjerimit, janë bazuar në parimet e mëposhtme duke marrë në konsideratë udhëzimet ekzistuese dhe praktikën më të mirë të vlerës universale, si më poshtë vijon:

Përqendrimi i zhvillimit. Bazuar në parimet e PINS Bregdeti, zonimi ka për qëllim të mbështesë një numër të kufizuar polësh zhvillimi, të identifikuar aktualisht me ndikim të ulët, duke respektuar nevojën primare për të ruajtur vlerën e një peizazhi thelbësisht të paprishur dhe të pazhvilluar në shkallë rajonale. Zonimi synon në këtë mënyrë të shmangë zhvillimet sporadike (të shpërndara, autonome), që ndikojnë në natyrën e virgjër të peizazhit dhe komprometojnë vlerën e saj të përgjithshme.

Racionalizimi i zhvillimeve ilegale. Zonat e zgjerimit urban duhet të përcaktohen për lehtësimin, racionalizimin dhe konsolidimin e zhvillimit ekzistues sporadik, dhe/ose të



paligjshëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të politikës së planifikimit, strategjive dhe planeve, si edhe me skemat përkatëse të planifikimit.

Përdorimi ekonomik i infrastrukturës

Zonimi ka për qëllim të mbështesë shfrytëzimin ekonomik të infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të propozuar, pa shkaktuar dëmtime gjatë përdorimit.

Homogjeniteti i zonave:

Ka të bëjë me një procesin që siguron rregulla të plota në mënyrë të thjeshtë, që do të jenë të lehta për t'u zbatuar. Shkalla e zonave duhet të marrë parasysh:

Sigurimin e një zone të një madhësie absolute, në mënyrë që të shmanget një strukturë e fragmentuar urbane dhe rregulloreje të komplikuar, duke ruajtur korrektësinë brenda morfologjisë urbane.

Të mund të përgjithësojë përdorimin sipas përdorimit kryesor në çdo zonë. Për shembull, një zonë rezidenciale do të jetë përshkruar si një zonë homogjene, pa pasur nevojën për të detajuar në një hartë të përdorimit të tokës hapësirat publike të hapura, zonat e parkimit që gjenden brenda tij etj.

Bazuar në mjetet metodologjike të paraqitura më lart dhe përkufizimet e 14 kategorive bazë të tokës është përdorur sipas nenit 76 të VKM 671 të 2015. Sistemi i klasifikimit të zonave të përdorimit të tokës, është analizuar me tej nëpërmjet nënkategorive brenda çdo zonë të përdorimit të përgjithshëm të tokës, në lidhje me destinacionin e tij të dëshiruar. Konsulenti ka konsideruar dokumentate PPK edhe PINS Bregdeti të miratuar, si udhëzues kryesor për të përcaktuar metodologjinë e përdorimit të tokës për planin lokal duke përfshirë dhe kufizimet e saj, si edhe sigurimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore të miratuara rishtazi për planifikimin territorial. Sistemi i propozuar i klasifikimit, i cili është paraqitur më poshtë dhe është reflektuar në hartat e përdorimit të propozuar të tokës, do të finalizohet në formulimin e Rregullores Lokale.

Për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara në vizionin për zhvillimin e territorit, PPV-ja përcakton kategoritë dhe nënkategoritë sipas përdorimit të propozuar të tokës për secilën nga njësitë strukturore të përcaktuara. Përkufizime dhe propozime të lidhura me kategoritë e përdorimit të tokës përshkruhen më poshtë:

1. N- Tokë natyrore

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.

Përdorimi N-Tokë natyrore, përfshin, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin dhe biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme.

Brenda kategorisë N-Tokë natyrore janë identifikuar 8 nënkategoritë:



- N1-** Rezerve strikte natyrore [Zona A1, Strikte e Mbrojtur (K.I)];
- N2-** Zona për Rekreacion Natyror [Zona A2, Parku Kombëtar i Butrintit (K.II)];
- N3-** Zona buferike [Zona B, Parku Kombëtar i Butrintit (K.II)];
- N4-** Zona Rekreative (Ekoturizëm) [Zona D, Park Kombëtar i Butrintit(K.II)] - Në këtë zonë lejohen përdorimet sipas MP-së së Butrintit për zonat D të projektuara,
- N5-** Rrafshnaltat strategjike dhe luginat e thella. Brigjet bregdetare, shpatet larta, shkëmbinjtë bregdetare, zonat me zhvillim të ndaluar;
- N6-** Zonat e mbrojtura të pejzazhit (përcaktuar në kriterin vizual, zonat me zhvillim të ndaluar, pejzazh publik) - janë lejuar vetëm funksionet me përdorim rekreativ sikurse është belvedere, shtigjet, zonat e pushimit dhe sinjalistikat;
- N7-** Tokë Natyrore (mbetet zonë natyrore) dhe që mund të lejohet të zhvillohet në disa raste me intensitet të ulët;
- N8-** Plazhet - zona me ndalim të përgjithshëm zhvillimi.

2. B - Bujqësi

Nëndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me tokat bujqësore.

Brenda kategorisë B- Bujqësi, janë identifikuar 6 nënkategoritë:

- B1-** Tokë bujqësore të mbrojtura fushore - Kultivime me ara. Kjo i referohet tokave bujqësore me ara me produktivitet të lartë përgjatë luginës së Vrinës dhe Pavlës;
- B2-** Tokë bujqësore e mbrojtur kodrinore - Kultivime me ullishte, pemëtore, vreshtë. I referohet kultivimit me ullinj në zonat kodrinore;
- B3-** Tokë bujqësore dytësore - Kultivime të përziera që mund të lejojnë disa zhvillime të bujqësisë (depot dhe magazinat e fermës duhet të kenë një intensitet të ulët). I referohet kultivimeve në shkallë të vogël në zonat përreth fshatit;
- B4-** Zonat e dedikuara për aktivitete mbështetëse për bujqësinë dhe blegtorinë. Janë zona në afërsi të fshatit ku janë përqëndruar depot me produkte bujqësore;
- B5-** Zona e propozuar me mundësi për zhvillimin e agroturizmit. Janë zona me kualitet të lartë piktoresk dhe me pamje të mirë në afërsi të vendbanimeve, sikurse janë ullishtet tradicionale të Konispolit;
- B6-** Tokë e pafrytshme për rigjenerim. I referohet tokës së kripëzuar në afërsi të lagunave bregdetare.

Objektet agroturistike në zonat e propozuara me mundësi për zhvillimin e agroturizmit (B5) Agroturizmi përbën një potencial të veçantë, pozitiv, për zhvillimin ekonomik lokal në zonat rurale të Konispolit, në promovimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore të zonës. Objektet agroturistike të zhvilluara janë të tipit fermë për rritjen, vjeljen dhe përpunimin e ushqimeve lokale tradicionale. Turistët kanë mundësinë për të shijuar pejzazhet bujqësore dhe të provojnë shijet e prodhimeve vendase dhe ushqimin tradicional, njohjen nga afër me jetën e përditshme në fshat, të marrin informacion në lidhje me historinë e zonës, dhe të marrin pjesë në aktivitetet rurale.



Kriteri për pozicionin e objekteve agroturistike përfshin:

- Vendodhje në brendësi të zonave të pejzazhit bujqësor.
- Vendodhje atraktive në lidhje me natyrën dhe mjedisin ndërtimor.
- Në afërsi të zonës me vlera historike, kulturore apo natyrore, sikurse janë vendndodhjet tradicionale, vendet arkeologjike, parqet periferike dhe mjediset ujore.
- Aksesueshmëri e lehtë me transport publik;
- Distançë e mjaftueshme nga zhurmat dhe aktivitetet ndotëse.

Objektet agroturistike mund të përmbajnë:

- Një shtëpi fshati.
- Akomodime me dendësi të ulët në fshat, akomodimi në vila tradicionale apo njësi apartamentesh.
- Restorante.
- Hapësira ndihmëse në shkallë të vogël për informimin e turistëve të produkteve lokale apo aktiviteteve kulturore.
- Prezantime të mënyrës së përgatitjes së ushqimit.
- Hapësira parkimi.
-

3. IN - Infrastrukturë

Kjo kategori i referohet të gjitha pjesëve të infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin elektronik, furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjen kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm. Prandaj më poshtë do argumentojmë nënkategoritë specifike:

IN1- Sipërfaqe rrugë kombëtare, sipërfaqe rrugë interurbane, sipërfaqe rrugë urbane parësore. Parking publik;

IN6- Nënstacioni elektrik, zona buferike e linjës së tensionit të lartë;

IN7- Ujësjiellës-Kanalizime. Impianti trajtimit të ujërave të ndotura-depot e ujit;

IN8- Telekom [Antena buferike 30m];

IN9- Zona për përdorimin e pikave të karburantit;

4. U - Ujëra

Territoret që përfshihen në kategorinë ujëra përfaqësohen nga brigjet lumore dhe përrenjtë, sipas nënkategorisë përkatëse. Në këto zona është rreptësisht i ndaluar çdo lloj zhvillimi.

U1- Lumenjtë, liqenet, rezervuar artificialë;

U3- Ujërat bregdetare

U4- Zona të mbrojtura ujore. Janë pjesë e trupave ujore, të cilat janë brenda kufinjve të zonave të mbrojtura kombëtare. [Zona A, Parku Kombëtar i Butrintit (K.II)];

U5- Zonë rekreative ujore.

5. A - Banim



Zonat rezidenciale përbëjnë një pjesë të vogël të territorit të urbanizuar të bashkisë së Konispolit. Disa nga shërbimet ndihmëse për turizmin mund të përfshihen në këto zona, sigurisht sipas kushteve specifike për secilën prej tyre, sikurse edhe shërbime të tjera, që janë në përputhje me zonat rezidenciale. Zonat rezidenciale përfshijnë këto territore:

Zonat ekzistuese urbane dhe ato fshatare me kufijtë e përcaktuar nga ortofotot e vitit 2013 dhe 2015.

Zonat e zgjeruara të propozuara për qendra urbane nga Konsulenti, për të mundësuar mbulimin e nevojave në të ardhmen, duke u bazuar në projeksionet programatike

Fshatrat e trashëgimisë kulturore. Kategoritë e propozuara për zonat e zhvillimit rezidencial dhe shërbimet që i shoqërojnë ato janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

Brenda kategorisë A-Banim janë identifikuar nënkategoritë:

A1- Qendra historike/vendbanim tradicional. I referohet disa pjesëve të lagjeve të Konispolit, Murësit dhe Markatit;

A2- Zona banimi në qendrën e qytetit;

A3- Zona banimi me përdorim miks (me shërbime). I referohet zonave të qendrës lokale në disa vendbanime. Gjithashtu në disa zona kanë përdorim rezidencial miks dhe workshope në (hyrje të vendbanimit në Shkallë);

A4- Zona banimi;

A5- Zona me shtëpi të dyta;

A6- Zona e strehimi social.

6. S - Shërbime

Përdorimi i S-shërbimit është i ndarë në dy tipe kryesore: shërbime tregtare dhe turizëm. Janë përcaktuar 2 nënkategoritë për shërbimet tregtare:

S1- Dyqane, shërbime personale, zyra, biznesi;

S4- Bar, kafe, restorante, shërbime plazhi.

Përdorimi i tokës dhe i strukturave në të për shërbime (S1) (S4), përfshin ato zhvillime të lejuara që bëhen për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave përkatëse, dhe ku sipas rastit jo më shumë se 10% e zonës dhe strukturave të saj shfrytëzohet për qëllime banimi, sipas sipërfaqes së ndërtimit.

Zonat e zhvillimit turistik, janë zonat e destinuara për zhvillimin e formave të ndryshme, të përgjithshme të një turizmi të interesit të veçantë, të cilat formojnë profilin e zonës, ashtu si ato janë identifikuar në fazën e mëparshme të studimit si pjesë e vizionit dhe strategjisë territoriale. Si rregull i përgjithshëm zonat e përcaktuara posaçërisht turistike, përjashtojnë aktivitete të tjera, të cilat nuk janë në përputhje me karakterin e zonës dhe zhvillimet rezidenciale, që nuk janë të lidhura me skemën e përgjithshme të zhvillimit.

Kategoritë e propozuara të zonave të zhvillimit turistik, janë të përshkruara si më poshtë:

S2- Turizëm brenda zonave të vendbanimeve (hotele)

S3- Turizëm jashtë zonave të vendbanimeve (resorte, vila)



S5- Format speciale të turizmit (ekoturizëm dhe agroturizëm)

S6- Infrastruktura speciale për turizëm, (SPA-golf etc).

S7- Kamping.

7. M - Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat historike. Monumentet e trashëgimisë kulturore me vlerë të jashtëzakonshme rregullohen me anë të një zonimi të veçantë hapësinor dhe udhëzimesh shoqëruese, të nxjerra sipas Ligjit 9048/2003. Zona tampon e ruajtjes së pejzazhit prej 250 m, është për të siguruar ekzistencën e monumenteve të regjistruara si të tilla, duke iu referuar Ligjit 9048/2003.

M1- Zona arkeologjike A;

M2- Zone arkeologjike B (buferike);

M3- Kala / Monument Kulturor.

8. IE - Ekonomi dhe industri

Zonat me aktivitete ekonomike industriale krijojnë tipin e tretë të kategorisë së përdorimit të përgjithshëm të tokës, që përfshin të gjitha pjesët e urbanizuara të territorit të Bashkisë, të cilat i takojnë aktiviteteve ekonomike që nuk duhet të shtrihen në zonat rezidenciale dhe/ose zonat për zhvillimin e turizmit. Këtu dallohen kategoritë, si më poshtë:

IE2-Zonë ekonomike-tregëtare. Kapanone të mëdhenj. I referohen disa zonave të projektuara përgjatë rrugës nacionale dhe aksit ekonomik të Bashkisë.

IE3-Zona magazinimi dhe tregëtimi. Industri agropërpunimi. I referohet zonave të përpunimit të produkteve agrikulturore përgjatë aksit ekonomik të Bashkisë

IE4-Qendra rajonale agroekonomike. I referohet objekteve të paketim grumbullimit bujqësor në aksin ekonomik ndërmjet fshatit Xarrë dhe Murësi.

IE5-Nxjerrje dhe përpunim mineralesh (guroret / fabrikat e çimentos)

Një kategori toke, që nuk është e nevojshme të lokalizohet në zona specifike, por të përcaktohet sipas kërkesave specifike si p.sh. distanca e shkurtër nga vendbanimet dhe zonat e turizmit. Njësitë e prodhimeve blegtorale bëjnë pjesë në këtë kategori dhe kategorizohen në tri nënkategori, në varësi të numrit të kafshëve të vogla, të mesme dhe të mëdha. Impiantet e rritjes së peshkut janë gjithashtu objekt i kufizimeve të largësive nga zonat e zhvillimit të turizmit, e që mbështetet në një vlerësim të specializuar. Po ashtu mund të thuhet edhe për guroret dhe vendhedhjen e materialeve inerte.

Kategoria tjetër është ajo që përfshin tokën me impakt ekonomik të ulët ku përfshihen hapësira relativisht të mëdha, të cilat janë të lidhura dhe që mbështesin zonat urbane. Këtu përfshihen magazinat, dyqanet e mëdha të shitjes me pakicë dhe supermarkëtët, njësitë prodhuese të vogla ushqimore, panairët, që duhet të përqendrohen në zona të caktuara me akses të veçantë dhe që të mos jenë të dukshme nga zonat përreth. Konsulenti ka përzgjedhur hapësira të përshtatshme për këtë qëllim në afërsi të qytetit të Konispolit. Gjithashtu mund të përfshihen në këtë zonë



edhe infrastruktura speciale e Bashkisë, si parkingu për automjetet e Bashkisë, thertoret, prodhues energjie etj.

9. IS - Institucione

Brenda kategorisë IS- Institucione janë identifikuar nënkategoritë:

IS1-Institucionet publike vendore, institucionet publike qendrore (administratat, gjykatat, burgjet, mbrojtja civile, institucionet e mbrojtjes kombëtare, mirëqenia sociale).

Kryesisht janë përqëndruar në qendër të Konispolit dhe në Shkallë;

IS2-Institucionet fetare.

10. AR - Sociale dhe Rekreative

Kategoria aktiviteteve AR- sociale dhe rekreative përfshin aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, dhe fusha të ndryshme, sipas legjislacionit të posaçëm.

AR1-Aktivitete kulturore

AR2-Zona Sportive

AR3-Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara

AR4-Park, zona shplohëse periurbane

11. AS - Arsimi

Ky përdorim përfshin të gjitha trojet e rezervuara për institucionet arsimore apo institucionet ndihmëse në funksion të arsimit, ekzistues dhe të propozuara. Propozimet, siç shpjegohen në kapitullin përkatës të këtij dokumenti, janë bërë duke u bazuar mbi analizën e gjendjes ekzistuese dhe evidentimin e nevojave për planifikimin e infrastrukturës arsimore, bazuar në parashikimet ligjore të VKM nr.671 (Neni 83) dhe legjislacionin sektorial përkatës. Në shumë raste, duke pasur parasysh që sipërfaqja e trojeve të rezervuara për institucionet arsimore është disa here më e vogël sesa sipërfaqja minimale e njësive strukturore të cilat akomodojnë edhe përdorime të tjera toke si banim (A), shërbime (S), etj. Nënkategoritë e evidentuara për këtë përdorim toke janë:

AS1- Arsimit parashkollor

AS2- Arsimit 9-vjeçar

AS3- Arsimit mesëm

AS4- Arsimit profesional

12. SH - Shëndetësi

Ky përdorim përfshin të gjithë sipërfaqet territoriale të rezervuara për institucionet shëndetësore apo strukturat ndihmëse në funksion të tyre, të klasifikuara sipas dy nënkategorive kryesore:

SH2- Qendër shëndetësore, ambulancë

13. V - Përdorim i vecantë

Strukturat dhe territoret që përfshihen në kategorinë të veçanta, janë zona e varrezave publike, të dëshmorëve, varrezat e fshatrave dhe çdo territor apo strukturë që nuk përfshihet në

Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë,
Himarë, Konispol

kategoritë e tjera bazë. Këto zona shoqërohen gjithmonë me zonën mbrojtëse buffer. Varrezat e qytetit janë parashikuar të zgjerohen aty ku ndodhen edhe varrezat ekzistuese.

V1-Varreza

14. ZU - Zona Ushtarake

Duke ju referuar territoreve dhe objekte të klasifikuara si të tilla në territor apo në legjislacionin e posaçëm.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol


Tabela 3: Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë

Kategoritë bazë të përdorimit të tokës	Sipërfaqe (ha)	Xarre	Konispol	Markat	Total	Ndryshimi në %
A	Ekzistuese	121.16	86.78	120.34	328.28	17.54%
	E propozuar	152.74	108.49	124.63	385.86	
IE	Ekzistuese	2.09	0.00	0.07	2.16	1150.93%
	E propozuar	21.05	5.97	0.00	27.02	
B	Ekzistuese	2588.28	951.48	1134.67	4674.43	-7.73% (-2.37%)
	E propozuar	2261.12	919.96	1132.24	4313.32	
S	Ekzistuese	0.00	0.00	0.00	0.00	500%
	E propozuar	0.93	1.86	2.21	5	
V	Ekzistuese	1.22	1.56	2.01	4.79	0.00%
	E propozuar	1.22	1.56	2.01	4.79	
U	Ekzistuese	583.88	103.65	324.55	1012.08	0.00%
	E propozuar	583.88	103.65	324.55	1012.08	
N	Ekzistuese	5344.47	3456.04	7397.41	16197.92	1.47% (-0.07%)
	E propozuar	5595.23	3449.66	7391.02	16435.91	
M	Ekzistuese	42.26	40.71	0.01	82.98	0.00%
	E propozuar	42.26	40.71	0.01	82.98	
ZU	Ekzistuese	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%
	E propozuar	0.00	0.00	0.00	0.00	
IS	Ekzistuese	1.40	0.17	0.07	1.64	122%
	E propozuar	2.07	0.72	0.07	2.86	
AR	Ekzistuese	5.85	1.04	0.13	7.02	408.26%
	E propozuar	29.28	5.02	1.38	35.68	
AS	Ekzistuese	0.55	0.66	0.74	1.95	38.97%
	E propozuar	1.24	0.62	0.85	2.71	
SH	Ekzistuese	0.06	0.11	0.02	0.19	94.74%
	E propozuar	0.20	0.12	0.05	0.37	
IN	Ekzistuese	23.44	10.37	28.33	62.14	7.02%
	E propozuar	23.44	14.23	28.83	66.50	




[illegible][illegible]

Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol




Harta 5-(18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës të propozuara, Janjar




Harta 6 - (18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës së propozuara , Markat-Ninat



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol



Harta 7-(18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës së propozuara, Shkallë-Çiflik




Harta 8-(18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës së propozuara, Vrinë-Shëndëlli




© 2006-2017 All rights reserved. No part of this publication may be reproduced without prior written permission from the publisher. This book is intended for personal use only. It may not be sold, lent, or otherwise distributed outside the family unit.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol



Harta 11 - (18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës së propozuar , Kepi i Stillos



Harta 12 - (18c) Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës së propozuar , Shales



1.3 Ndarja e territorit në njësi zhvillimi

Organizimi hapësinor i njësive dhe nënnjësive strukturore është një proces paralel me procesin e zonimit të përdorimit të tokës, i cili shërben si mjet themelor metodologjik për llogaritjen e standardeve të planifikimit në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe shpërndarjen e shërbimeve. Përcaktimi i njësive dhe nënnjësive është i lidhur direkt me popullsinë ekzistuese dhe atë të planifikuar, dendësinë e popullsisë, numrin e parashikuar të turistëve dhe të vizitorëve, si edhe shpërndarjen e shërbimeve sociale (arsimi, kujdesi shëndetësor, kultura, sporti dhe gjelbërimi).

Përcaktimi i njësive dhe nënnjësive strukturore zbatohet vetëm për pjesën e urbanizuar të territorit të parashikuar, duke marrë në konsideratë modelin ekzistues të vendbanimeve. Zonat janë njësi relativisht homogjene, ku përqendrohen një sërë karakteristikash të përbashkëta, si përdorimi i tokës, tipologjitë hapësinore të ndërtimit, destinacioni i zhvillimit dhe profili social- ekonomik. Ata paraqesin midis njëra-tjetrës varësi funksionale të cilat janë të shprehura në formën e njësive të rendit të lartë hapësinor, të cilat janë formuar nga grupimet e vendbanimeve bredgetare dhe rurale, me funksionimin dhe lidhjet historike me njëri-tjetrin, në lidhje me plazhet, aktivitetet e tyre prodhuese, tokën dhe kultivimin e tyre.

Njësia strukturore përbën qelizën më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në njësinë strukturore përkatëse.

Numri i njësive strukturore është 213 (dyqind e trembëdhjetë), të cilat janë përcaktuar duke iu referuar këtyre kritereve:

- a. Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elemente me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastit përfshijnë linja hekurudhore, vija ujore, lumenj, kanale të hapura, breza sanitarë, dhe të tjera të kësaj natyre;
- b. Ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit të cilët garantohen në çdo njësi përbërëse të njësisë strukturore;
- c. Ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njëri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane.
- d. Bashkëkzistenca e përdorimeve të tokës dhe të strukturave në një njësi strukturore që janë të përputhshme dhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, në të gjithë njësinë;
- e. Garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë së tipologjisë hapësinore ekzistuese ose të propozuar;
- f. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;



- g. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të;
- h. Kufizimin nga rrjeti rrugor, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve, nga linja hekurudhore, kanale të hapura, breza sanitare, vija ujore, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre.

Tabela 3. Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi

Njësia Administrative	Vendbanim	Sipërfaqe (ha)	Zona	Njësi Strukturore
KONISPOL	CIFLIC	22	KO.UB.1	14
	KONISPOL	98,56	KO.UB.2	35
	QAFE BOTA	0,48	KO.UB.2	1
	Sub-Total	121,04		50
MARKAT	DISHAT	7,73	MA.UB.2	3
	JANJAR	29,92	MA.UB.6	11
	MARKAT	25,66	MA.UB.4	19
	NINAT	13,48	MA.UB.5	9
	SHALES	43,62	MA.UB.1	17
	VERVE	10,81	MA.UB.3	3
	Sub-Total	131,22		62
	TOTAL	461,25		187
XARRË	MURSI	59,63	XA.UB.4	23
	SHENDELLI	29,33	XA.UB.2	12
	SHKALLE	22,4	XA.UB.5	9
	VRINE	13,24	XA.UB.1	10
	XARRE	84,39	XA.UB.3	21
	Sub-Total	208,99		75



[Home](#)
[About Us](#)
[Contact Us](#)
[Privacy Policy](#)
[Terms of Service](#)
[FAQ](#)
[Blog](#)
[Partners](#)
[Press](#)
[Careers](#)



1.4 Pozicionimi i rrjeteve të infrastrukturës si edhe kushtet teknike për realizimin e tyre.

1.4.1 Transporti ekzistues

Konispoli ndodhet në zonën më jugore të shtetit shqiptar, në pjesën ku ndahet kufiri midis Shqipërisë dhe Greqisë. Konispoli shtrihet në një luginë me lartësi mesatare rreth 400 metra mbi nivelin e detit. Bashkia e Konispolit ndahet nga shteti grek në pikën kufitare të Qafë-Botës e më në Jug ndodhet Sajadha, në juglindje kufizohet me Kocikën, e në lindje me Palampasin, të gjitha këto vendbanime janë pjesë e kufinjve zyrtarë të Greqisë. Mund të konsiderohet që zona e Konispolit deri më 2005 ka patur probleme të medha të konektivitetit. Vetëm në këtë vit u bë e mundur lëvizja e lirë e banoreve dhe e mallrave me hapjen e pikës doganore të Qafë Botës. Brenda territorit të Shqipërisë bashkia e re e Konispoli kufizohet në veri me bashkinë Finiq dhe në përfundim me bashkinë e Sarandës. Konispoli është pika më e largët në distancën 302 km nga kryeqyteti i vendit dhe si i tillë ka disa disavantazhe të lidhura me distancën por ky është gjeografikisht i lidhur ngushtë me Sarandën si edhe me Gjirokastrën.

Transporti Ajror

Shërbimi i transportit ajror në Jug të vendit sigurohet në mënyrë indirekte - kryesisht për turistët ndërkombëtarë së pari nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit - Greqi.

Aeroporti i Tiranës, duke qenë i vetmi aeroport ndërkombëtar në vend, është i vendosur në një distancë prej 310km (4h55m) nga Konispoli, dhe nuk konsiderohet i përshtatshëm siç duhet për të mbuluar nevojat e udhëtimit të flukseve turistike ndërkombëtare të jugut të Shqipërisë.

Nga ana tjetër, aeroporti i Korfuzit, Greqi edhe pse gjeografikisht më i afërt se aeroporti i Tiranës, nuk është shumë i aksesueshem për destinacionet e Himarës, Sarandës dhe Konispolit për një sërë arsesh. Duke pasur parasysh faktin që një pjesë e konsiderueshme e fluksit turistik ndërkombëtar, mund të vijnë nga distanca mjaft të largëta nga Shqipëria, ku fluturimet ajërore janë alternativa kryesore e udhëtimit, nevoja për një aeroport në afërsi të bregdetit, në jugperëndim të Shqipërisë, për të shërbyer kryesisht në mënyrë sezonale (me fluturime charter), është evidente

Saranda është vendi më i mundshëm për ndërtimin e aeroportit që i shërben pjesës jugore të Shqipërisë. Mundësia e një aeroporti në Sarandë është vlerësuar fillimisht në planin e zhvillimit të bregdetit të jugut në vitin 2008, ku janë shqyrtuar dy zona të ndryshme dhe që do t'i shërbejë direkt bashkisë së Konispolit.

Transporti hekurudhor

Vendi aktualisht nuk është i aksesueshem me tren. Për shkak të pozicionit gjeografik, relievit dhe kostove relativisht të larta nuk është parashikuar lidhja nëpërmjet transportit hekurudhor në këtë territor. Linja hekurudhore përfundon në Vlorë.



Transporti detar

Transporti detar, ekziston si një lidhje e tërthortë ndërmjet Konispolit dhe Igumenicës si dhe Konispolit me Korfuzin, ky i fundit operon me shumë gjatë sezonit të verës nëpërmjet portit të Sarandës. Zona e Konispolit është tepër e lidhur me zonën e Igumenicës ku dhe popullsia vendase është e punësuar sezonalisht në këtë rajon. Infrastruktura duhet të përmirësohet në mënyrë që kjo lidhje të jetë sa më e lehtë. Vija bregdetare është rreth 11km. Pjesa e transportit ujor është tepër e rëndësishme për zonën e Konispolit pasi mallrat dhe popullsia nëpërmjet kanalit të Vivarit lidhen me pjesën jugore të bashkisë Sarandë veçanërisht zonat e Xarrës dhe Mursisë. Pozita gjeografike e këtyre dy njësive administrative e bën tepër të rëndësishëm këtë lloj transporti. Konispoli ka vetëm një dalje në det, në pjesën jugpërfundimore të tij nëpërmjet kanalit të Vrinës e përreth. Dalja në det e Konispolit megjithëse tepër e kufizuar është faktor shumë i rëndësishëm për peshkimin dhe zhvillimin e ekonomisë familjare nëpërmjet këtij aktiviteti. Kjo zonë njihet si zonë e mbrojtur natyrore.

Transportit publik

Transporti publik për bashkinë Konispol është tepër i kufizuar. Ai përbëhet nga linja Tiranë-Konispol (nëpërmjet Fierit) dhe Konispol-Tiranë, në oraret 13.00-1.00. Aktualisht transporti ndërrurban i udhëtarëve kryhet nga operatorë të cilët janë licencuar nga Bashkia.

Përveç autobusëve, shërbimi ndërqytetas i udhëtarëve bëhet edhe me taksì apo furgon të cilët operojnë kryesisht në qytetin e Konispolit (taksi) dhe Vrinë, Markat, Mursi etj (kryesisht furgonë).

Parkimi publik

Në të tri njësitë administrative të bashkisë Konispol ka mungesë të parkimit publik.

1.4.2 Infrastruktura publike ekzistuese

1.4.2.1 Infrastruktura rrugore

Aksesi rrugor i zonës së studimit, nëpërmjet korridoreve rrugore të jugut të Shqipërisë, është përmirësuar ndjeshëm kohët e fundit, kryesisht për shkak të zgjerimit të dukshëm dhe të programit të përmirësimit të infrastrukturës zbatuar në të gjithë vendin. Pas përfundimit të korridorit kryesor Tiranës – Durrës – Lushnjë – Fier – Vlorë, i cili aktualisht është përmirësuar pjesërisht, dhe pjesërisht është në proces modernizimi, pritet që Konispoli të ketë një aksesueshmëri më të lartë me Shqipërinë Qendrore dhe Veriore, Kosovën, Malin e Zi etj. Kjo rrugë është një nga drejtimet që akseson Konispolin e më gjere rajonin e Greqisë se veriut. Një rëndësi të vecantë ka lidhja infrastrukturore me Gjirokastrën nëpërmjet rrugës së Qafë-Botës e cila lejon të zhvillohet aktiviteti ekonomik dhe lëvizja e popullsisë për punë apo lëvizje të lirë. Përmirësimi i sistemit rrugor dhe aksesueshmëria në portin e Sarandës është një domosdoshmëri për zhvillimin e bashkisë Konispol.



Bashkia Konispol- Infrastruktura rrugore ndërrajonale

Bashkia e Konispolit është vendosur në pjesën e fundme jugore të qarkut të Vlorës dhe është qyteti më i afërt i Shqipërisë me Greqinë fqinjë. Konispoli ndodhet vetëm 2.5 km larg me rrugën kryesore që lidh kufirin Qafë Botë - Sagiada me pjesën tjetër të Shqipërisë (SH97), 4.5 km larg nga kufiri shqiptaro-grek, 14.5 km nga Sagiada dhe 35 km nga qyteti i Igumenicës. Qyteti i Konispolit është 35 km larg nga Saranda dhe në njësinë administrative përfshihen disa fshatra/ vendbanime. Edhe pse distanca e shumicës prej tyre është më e afërt me Konispolin se me Sarandën, fshatrat komunikojnë më shumë me qytetin e Sarandës pasi ofrohen më shumë shërbime dhe mundësi të aktivitetit. Përveç kësaj për shkak të terrenit malor të rajonit dhe vendndodhjes në lartësi të Konispolit aksesit në qytet në shumicën e këtyre fshatrave bëhet përmes lidhjeve rrugore kryesore (SH81, SH97, SH98) të cilat krahasimisht favorizojnë qytetin e Sarandës i cili ka një lidhje më të shpejtë dhe më të drejtpërdrejtë sesa Konispoli.

Për shkak të afërsisë me kufirin shqiptaro-grek të Qafë Botit, Konispoli është pjesë e Programit të Fqinjësisë Greqi-Shqipëri të Bashkimit Europian për përmirësimin e standardit të jetesës të popullsisë lokale, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal në zonën ndërkufitare mes dy vendeve. Bashkia Konispol ka dy pika kalimi kufitar me Greqinë, Qafë Botit dhe Ripsin. Rrjeti kryesor rrugor, si edhe hallka lidhëse nëpërmjet autostradës kombëtare 97 me qytetin e Konispolit e cila aktualisht mban rreth 3000 AADT, janë në gjendje të mirë. Rrugët e mbetura që çojnë në fshatra të ndryshme janë në gjendje më të keqe dhe kalojnë nga rrugë të asfaltuara, me nivel të kënaqshëm në rrugë me zhavorr të pamirëmbajtura.

Infrastruktura rrugore e bashkisë Konispol do të analizohet sipas hierarkisë së rrugëve si dhe karakteristikave të tyre duke përfshirë të gjitha ish-komunat. Në pamje të parë Konispoli si pjesa më fundore e jugut të Shqipërisë ka një aksesibilitet të ulët por megjithatë është pikë hyrje dhe dalje kufitare me Greqinë. Infrastruktura rrugore që lidh Konispolin me qendra të tjera apo me rrugët nacionale është në gjendje tejte të keqe, ndërkohë që lë mjaft për të dëshiruar edhe infrastruktura urbane. Sistemi rrugor i bashkisë Konispol përbëhet nga rruga nacionale sekondare SH97, 35 km që lidh Sarandën (Mesopotami) me pikën kufitare të Qafë Botës që përfundon në shtetin grek dhe është në gjendje shumë të mirë. Kjo rrugë është ndërtuar nga 'Egnatia Odos' në paralel me rrugën e vjetër ekzistuese Sh 98 e cila është në gjendje jo shumë të mirë. Ajo i shërben trafikut ndërrajonal dhe ndërrurban.

Njësia administrative Konispol

Qyteti i Konispolit. Aktualisht po bëhet rikualifikimi i qendrës së Konispolit duke regulluar sheshin e qytetit dhe pedonalen. Nga rruga kryesore 2.7 km, lidhja me fshatrat e njësive së Konispolit është e asfaltuar edhe në gjendje të mirë. Si pjesë e zgjidhjes së problemit të infrastrukturës rrugore duhen parë edhe rrugët e brendshme të qytetit të cilat janë në kushte jo të mira fizike dhe kanë nevojë të rristrukturohen. Rrugët e qytetit janë të kategorisë rezidenciale dhe pjesërisht në gjendje të mirë. Zona e jugut të qytetit, zona e vjetër ka rrugë të mirëasfaltuara 500 deri 800 m. Pjesa e sipërme e Konispolit ka rrugë në gjendje të keqe të shtruar me beton 600 deri në 800 m. Rruga në pjesën më të madhe të unazës së qytetit Konispol është e dëmtuar si në rrugën hyrëse me gjatësi 2,2 km ashtu edhe segmenti i rrugës Buar-



Qafbotë me gjatësi 2,5 km, që fillon në zonën e quajtur Buar dhe mbaron para fushës së sportit e cila nuk ka parametrat e duhur të një rruge urbane.

Çiflik- Rruga Shkallë-Çiflik 1.20 km është me dëmtime dhe jo në kushte të mira.

Njësia Administrative Xarrë

Lidhja e brendshme rrugore nga Shkalla në Xarrë, e cila kalon përmes Mursisë dhe lidhet me Çiflikun është në gjendje të mjeruar, përveç rrugëve me gropa ka segmente ku nuk ekziston më asfalti. Ky është segmenti më i rëndësishëm i Bashkisë 'aksi ekonomik' dhe përbën zonën ku ka zhvillim më të madh ekonomik. Lidhjet rrugore më të varfëra janë nga fshati Shalës në Dishat dhe në Vervë ku rruga është e pashtuar dhe në gjendje të keqe. Lidhjet midis fshatrave Vrinë, Shëndëlli dhe Xarrë janë në një gjendje pak më të mirë por megjithatë janë të ngushta dhe me mirëmbajtje të dobët jashtë standardeve.

Në Mursi aktualisht rrugët janë në gjendje të keqe. Gjithashtu segmenti liqeni Mursi-Shkallë 1.41 km. Në Xarrë rruga Xarrë-Xarrë 0.63 km është në gjendje të keqe dhe e dëmtuar. Ndërsa në Shkallë rruga Piqeras-Shkallë 3.52 është në gjendje të keqe dhe e dëmtuar.

Njësia Administrative Markat

Lidhjet e rrugës nacionale me fshatrat Shalës dhe Markat nuk janë të asfaltuara dhe në gjendje të mjeruar. Ajo është e dëmtuar dhe në gjendje jo të mirë si segment rrugor Kthesa Vilë-ura Haliqe me një gjatësi 3.15 km lidh njësinë administrative Markat me rrugën nacionale Sarandë-Konispol. Ndërsa rruga me gjatësi 10 km që lidh dy fshatrat Vervë dhe Ninat dhe është tepër e amortizuar. Në të njëjtën situatë është edhe lidhja me rrugë nga Markati në Ninat dhe Janjar. Rruga ka një gjatësi prej 8 km dhe është në një gjendje shumë të keqe. Vetëm segmenti 0.76 km i rrugës së Ninatit nga Markati është i asfaltuar. Rruga Ura e Bogazit-Markat 8.20 km është në gjendje jo të mirë dhe me dëmtime. Ndërsa Janjari është një zonë malore shumë periferike me vështirësi të lartë në aksesibilitet. Për të arritur në qendër të Janjarit duhet kaluar nëpërmjet Markatit në një rrugë prej 5.7 km. Për të kaluar në rezervuarin e Janjarit janë dy rrugë të vështira që mund të konsiderohen shtigje. Rruga më e afërt është 500 m dhe rruga tjetër është 2.2 km, të dyja në gjendje shumë të keqe. Rrjeti rrugor, është një pjesë integrale e rëndësishme, pasi lidh zonat e ndryshme duke filluar që nga bashkitë mes tyre, deri te qytet e fshatrat, duke lehtësuar lëvizjen mes njërezve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë, karakterin, llojin e shërbimeve që ajo ofron sipas zonës ku ajo kalon, funksionin dhe qëllimin.

Hierarkia rrugore: Hierarkia rrugore e detajuar më poshtë është e bazuar në dispozitat e kuadrit ligjor shqipëtar, dhe i referohet projekteve ndërkombëtare dhe standarteve funksionale me një qëllim të veçantë për t'u përshtatur me karakteristikat e veçanta të bashkisë Qendër. Kjo hierarki është projektuar për t'i shërbyer vëllimeve të ndryshme të trafikut, në përputhje me



përdorimin. Një vëmendje e veçante gjatë planifikimit të rrugës i është kushtuar dhe shmages së turbullimeve të ekosistemit të lagunës dhe kontrollit të flukseve të vizitorëve sipas parimeve ekologjike të planifikimit.

(i) *Rrjeti interurban*

Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në të gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësitë e udhëtimeve, duke filluar nga autostradat në zinxhirët e rrugëve të vogla rajonale të qendrave të vogla urbane dhe fshatrat, duke ndikuar relativisht në kufijtë e moderuar të shpejtësisë. Në kuadër të Planit, rrugë interurbane mendohen të jenë:

- **Rrugët Interurbane Kryesore (Kat. C)** - Është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime, autostradë me shpejtësi të lartë, domethënë shtylla ekzistuese e rrugës kombëtare. Përfshihen rrugët nga Mesopotami deri në Qaf Bote.
- **Rrugët interurbane dytësore (Kat. C)** - Është një rrugë e vetme, me dy kalime ose me një kalim, që përbën lidhjet primare nga rruga kombëtare për në vendbanimet e veçanta. Përfshihen rrugët ekzistuese nga Ksamili deri në Shkallë duke përfshirë dhe aksin ekonomik të Bashkisë dhe rrugët lidhëse me Markatin dhe Shalës.
- **Rrugë interurbane lokale (F)** - Është një rrugë e vetme, me dy kalime ose me një kalim me standarte më të ulëta të projektimit dhe të shpejtësive të trafikut, e cila lidh vendbanimet individuale dhe/ose zonat e zhvillimit. Janë të gjitha rrugët e tjera jashtë kufijve të vendbanimeve (të shtruara ose të pashtuara).

(ii) *Rrjeti urban*

Rrugët urbane përbëjnë pjesë të rrjetit rrugor, që shtrihet brenda vendbanimeve të zonës. Ato ndryshojnë në madhësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga rrugët kryesore në rrugët vetëm për këmbësorë. Të gjitha rrugët urbane duhet të lehtësojnë qarkullimin e këmbësorëve, prandaj trotuaret janë të nevojshme. Për më tepër, shumica e tyre kanë nevojë për të mbuluar nevojat e rastit për parkime në rrugë. Madhësitë e trotuareve dhe numri i vendeve të parkimit, duhet të përcaktohen mbi bazën rast pas rasti, sipas nevojave edhe tipareve hapësinore të çdo vendbanimi.

Më konkretisht rrugët urbane përfshijnë:


- **Rrugët urbane kryesore (D)** - Janë rrugë me dy kalime, të projektuara për lëvizje të njëkohësishme përmes trafikut nëpër qytet, dhe për të lidhur nyjet e mëdha ose rajonet. Rrugët kryesore urbane gjenden në qendrat e aktiviteteve kryesore të qytetit, duke përfshirë edhe qendrën e tij dhe qendrat e lagjeve. Kjo kategori rrugësh nuk aplikohet në Konispol.
- **Rrugët urbane dytësore (E)** - Janë orientuesit me dy kalime ose me një kalim të trafikut automobilistik në rrugët kryesore urbane, duke organizuar strukturën e qarkullimit të lagjeve të veçanta. Ato funksionojnë si plotësuese të rrugëve kryesore urbane dhe kanë standarte projektimi, në përgjithësi, më të ulëta se të parat.
- **Rrugët lokale (F)** - Janë rrugët e mbetura me dy kalime ose me një kalim, që lidhen me rrugët dytësore dhe mundësojnë qasje të automjeteve në parcela të veçanta. Meqënëse këto




rrugë janë të lidhura ngushtësisht me zonat e banuara, vëmendje e veçantë duhet të adresohet për të siguruar hapësira për lëvizjet e këmbësorëve dhe parkimin në anë të rrugës.

- *Rrjeti i rrugëve këmbësore* - Janë të mbyllura për trafik automjetesh, ose në çdo kohë ose gjatë orarit të caktuar dhe nxisin qarkullimin e këmbësorëve dhe përdorimin e biçikletave. Ato duhet të krijojnë një rrjet rrugësh për këmbësorët dhe hapësira publike të hapura, duke përcaktuar qarkullimin e këmbësorëve brenda zonave të vendbanimit. Ky lloj i rrugëve është veçanërisht i rëndësishëm për pjesët tradicionale të vendbanimeve, rrugët me gur të tipit historik dhe kalldrëmet.


Dimensionet e sistemit të rrjetit rrugor janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme



2. Rruget Dytesore Interurbane



3. Rruget Terciale Interurbane



4. Rruget Kryesore Urbane







Figura 1. Hierarkia rrugore



Tabela 4. Kategoritë e sistemit rrugor

Emërtimet		Rrjeti interurban					Rrjeti urban				
		Rrugë kryesore interurbane Autostrada/A2	Rrugë sekondare interurbane A/B		Rrugë terciare interurbane		Rrugë kryesore urbane A/B	Rrugë sekondare urbane A/B		Lokale Urbane A/B	
1	Numri i korsive	2+2	1+1	1+1	1+1	1	1+1	1+1	1	1	1
2	Gjerësia e korsive (për drejtimin e trafikut)	3.75 x (2)	3.75	4.00	3.00	4.75	3.00	3.00	5.50	5.50	4.75
3	Gjerësia e krahut të rrugës	2.00 x (2)	1.75	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Numri i trotuareve	0	0	0	0	0	2	2	2	2	2
5	Gjerësia e trotuareve	0	0	0	0	0	1.50	1.50	1.50	1.50	1.00
6	Numri i shenjave të pjesës anësore të rrugës	4	2	2	2	2	0	0	0	0	0
7	Gjerësia i shenjave të pjesës anësore të rrugës	0.50	0.50	0.50	0.50	0.5	0	0	0	0	0
8	Gjerësia mesatare e brezit ndarës qendror	3.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Numri i anëve me parkim	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
10	Gjerësia e korsise se parkimi	0	0	0	0	0	2	0	1.50	0	0
11	Nr.i rrugëve për biçikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Gjerësia e rrugëve për biçikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Gjerësia totale e rrugës	23.00	11.00	8.00	6.00	4.75	11.00	9.00	10.00	8.50	6.75
14	E drejtë kalimi	24.00	12.00	9.00	7.00	5.75	12.00	10.00	11.00	9.50	7.75
* rrugët me një drejtim – minimumi i gjerësisë së korsisë së rrugës me një drejtim duhet të jetë 3.00 metra											
** Kufizimet e parkimit të specifikohen rast pas rasti											





Harta 74 - (19c) Rrjeti rrugor dhe vendparkimet publike të propozuara

1.4.2.2 Furnizimi me ujë

Duke marrë në konsideratë hartën hidro-geologjike të Shqipërisë, morfologjinë me ujëmbajtës karstik të përhapur gjerësisht dhe malet e larta me shpate të pjerrëta drejt detit Jon, në jug të zonë sbregdetare të Shqipërisë, me një mesatare efektive filtrimi në masivet karstike, e cila varion nga 1000 – 1300mm/vit, mund të thuhet se në këtë zonë gjenden:

- Pasuritë ujore nëntokësore, janë relativisht të kufizuara, për shkak të zhvillimit të fenomenit të karstit dhe sasisë së konsiderueshme të ujërave që derdhen direkt në det;
- Rrjedhje ujore sipërfaqësore shumë të shpejta;
- Ndryshim sezonal të ndjeshëm të rrjedhjes;
- Përrenj përkohësisht të thatë.

Njësia Administrative Xarrë ka burime të pasura dhe të shumëllojshme natyrore. Ajo ofron një peizazh kryesisht fushor, me ujra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, mes tyre edhe laguna e gjire, me masive.

Furnizimi me ujë të pishëm

Njësia Administrative Konispol

Konispol qytet - Aktualisht furnizohet me ujë nga burimi në Çiflik me stacion pompimi me



gjatësi 7000m dhe lartësi 600m por që konsumon shumë energji elektrike si edhe me shpim me pus poshtë Konispolit.

Çiflik - (Pusi/pompa) e Çiflikut (10-12 l/sek.) i shërben fshatrave të Çiflikut dhe Konispolit duke shpërndarë ujin nëpërmjet stacioneve të pompave

Njësia Administrative Xarrë

Për furnizimin me ujë të pishëm në njësinë Administrative të Xarrës përdoren kryesisht dy mënyra: me ujësjellës dhe çezma sipërfaqësore. Furnizimi me ujë të pishëm i popullsisë në këtë njësi realizohet prej 5 ujësjellësash, 18.5 km linjë e jashtme dhe 22 km rrjet shpërndarës. Nga stacioni i pompimit me ngritje mekanike që ndodhet në Mursi marrin ujë me linja fshatrat Mursi, Xarrë, Shëndëlli dhe Vrinë. Ndodhet dhe një stacion pompimi tjetër në Shkallë që furnizon me ujë fshatin Shkallë.

Njësia Administrative Markat

Njësia ka nevojë të përmirësojë sistemin e furnizimit me ujë. Aktualisht furnizimi me ujë bëhet me pus.

Markat - Nuk ka aktualisht furnizim me ujë të pishëm. Banorët shërbehen nga puse personale. Pusi i Markatit me kapacitet (5 l/sek.) duhet të shërbejë për të furnizuar me ujë të pishëm fshatin.

Ninat, Janjar - Ekzistojnë rrjeti shpërndarës dhe depot, mungojnë pompat. Për këtë arsye ka problematika në furnizimin me ujë të pishëm.

Dishat - Nuk ka aktualisht furnizim me ujë të pishëm. Banorët shërbehen nga puse personale. Burimi nëntokësor ka kapacitet (3-5 l/sek.) duhet të shërbejë për të furnizuar me ujë të pishëm fshatin.

Shalës - Ekziston rrjeti i furnizimit me ujë, i cili kërkon disa ndërhyrje të vogla. Burimi nëntokësor ka kapacitet (5-7 l/sek.).

Vërvë - Ka furnizim me ujë në gjendje të mirë. Burimi nëntokësor ka kapacitet (3-5 l/sek.)

1.4.2.3 Rrjeti i kanalizimeve

Rreth 90% e të gjitha zonave të banuara të njësisë administrative Konispol janë duke operuar me gropa septike. Vetëm në Konispol qendër ekziston rrjeti i kanalizimeve i ndërtuar para viteve 90, i cili është amortizuar dhe ka nevojë për përmirësime. Sistemi i kullimit dhe vaditjes ka nevojë të përmirësohet. Për vaditjen e fushës së Vrinës aktualisht përdoret Liqeni i Mursisë. Ky liqen furnizohet nga lumi Pavël.





Figura 2. Gropa sepike familjare
Burimi: Foto nga ekspertët



Figura 3. Humbje teknike të ujit
Burimi: Foto nga ekspertët

1.4.2.4 Furnizimi me energji dhe telekomunikacioni

Furnizimi me energji i bashkisë Konispol është nën juridiksionin e Drejtorisë së Tensionit të lartë jugperëndim me agjenci në Sarandë. Kjo Agjensi mbulon Sarandën dhe Konispolin. Për gjithë jugun e Shqipërisë është në proces zgjerimi i rrjetit 110 kV. Unaza e jugut përfshin linjën Babicë – Sarandë, 104 km e gjatë. Ndërtimi i kësaj linje ka mbyllur në unazë një pjesë të rëndësishme të rrjetit elektrik 110 kV, që do të përmirësojë cilësinë e furnizimit me energji të zonës dhe gjithashtu garanton funksionimin e sigurtë të HEC Bistricë. Përmes këtij projekti është zgjeruar dhe fuqizuar nënstacioni 400/110 kV Zemblak. Në studim janë Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol.

Aktualisht ekziston Unaza e Tensionit të Lartë të Energjisë Elektrike nga stacioni Sarandë në Xarrë, Shkallë dhe nënstacioni Livadhja- Bistricë. Në të njëjtën kohë i vihet në shërbim fshatrave të ndryshme të Bashkisë. Lidhja e fshatrave të njësisë me tensionin e mesëm është në gjendje të mirë. Rrjeti shpërndarës është tepër i amortizuar pothuajse për të gjitha fshatrat.

Telekomunikacioni

Rrjeti telefonik është kabllor, kryesisht në linja tokësore bakri dhe pjesërisht me ato ajrore. Alb telekom ka hartuar projekte me qëllim futjen e shërbimeve të reja përveç thjesht ekzistencës së telefonit, të tilla si interneti i shpejtë dhe televizionit kabllor. Për këtë qëllim është e nevojshme që të ndryshojë teknologjia ekzistuese e rrjeteve, zgjerimi dhe shtrirja e fibrave optike në mënyrë që të reduktohet gjatësia mesatare e linjave. Aktualisht ka një mbulim shumë të kufizuar nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të ish-komunës vetëm me telefoninë valore. Përdorimi i kabllave optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen nga operatorë të fuqishëm mobile si T Mobile, Vodafone, Eagle. Në njësinë Administrative të Xarrës është shumë i përhapur komunikimi me rrjetin e lëvizshëm telefonik. Ky realizohet si shërbim në pesë fshatra të njësisë administrative nëpërmjet telefonisë celulare të kompanive AMC e Vodafone si dhe atë grek.



1.4.2.5 Menaxhimi i mbetjeve urbane

Në bashkinë Konispol hasen një numër problemesh që lidhen me hedhjen dhe grumbullimin e mbetjeve që lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës dhe me menaxhimin e dobët. Vende-vende shikohen grumbullime mbetjesh në afërsi të lumenjve, ujëmbledhësëve etj. Sigurisht që veç dëmit që sjellin në cilësinë e këtyre ujrave këto mbetje krijojnë edhe një imazh të shëmtuar të zonës. Lind një nevojë për rehabilitimin e këtyre vendgrumbullimeve si dhe një përmirësim të sistemit të grumbullimit dhe infrastrukturës në tërësi. Asgjesimi përmes djegjes i mbetjeve sillte një ndotje dhe dëmtim të cilësisë së ajrit të përkohshëm. Mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza krijonte shpeshherë në afërsi të qendrave të banuara aroma të pakëndshme si dhe ndotje jo vetëm në afërsi të tyre por edhe përgjatë kanaleve ujitës dhe kullues. Një problem tjetër mjedisor është edhe prania e varrezave në afërsi të brigjeve të ujëmbledhësit, e cila do bëhet më problematike me kalimin e viteve. Zhvillimi i bujqësisë në zonë sidomos në fushat pranë kanaleve dhe lagunave rrezikon të shtojë ndotjen e tokës nga përdorimi i pesticideve.

1.4.2.6 Hapësirat e gjelbëra dhe publike

Lidhur me dispozitat e hapësirave të gjelbëra publike, çdo njësi (vendbanim) duhet të ketë hapësira të hapura për shërbimin e nevojave lokale (terreneve sportive etj) pavarësisht të popullsisë së saj. Për arsye të qartësisë së "njësive hapësinore" të analizës dhe vlerësimi fazave që janë të lidhura në këtë fazë me njësitë administrative në bazë për të cilat janë të referuara standardet e planifikimit. Në situatën e tanishme, ka një mungesë të madhe të hapësirave publike (për shembull, vetëm në Xarrë është një hapësirë e kufizuar e cila është zhvilluar me pajisje të përshtatshme urbane si një shesh lojrash). Standardi për hapësira të mëdha të gjelbëra (parqe, kopshte etj) shqetësimet, kryesisht në territoret urbane. Megjithatë, standardi i planifikimit është i mbuluar për shkak të ekzistencës së parkut publik në qendër të Mursit (gjendjen e saj e aktuale është në mirëmbajtje të dobët). Hapësira të tjera publike, duke përfshirë sheshet, rrugët, etj pedonalet duhet të forcohet sidomos, në qendër të çdo vendbanimi. Në vendbanimet të cilat nuk e kanë organizuar hapësirat publike, të tilla si Çiflik, sigurimi i këtyre hapësirave duhet të jetë prioritet. Nevojat për hapësira publike në këto vendbanime janë shërbim. Shqetësim janë kryesisht, zonat periferike, ruajtja e zonave të gjelbra periferike dhe valorizimi i tyre si rekreative.

Njësia Administrative Xarre (vendbanimet: Vrinë, Shendelli, Xarrë, Mursi, Shkallë).

Ky standard përfshin sipërfaqen minimale për planifikimin e përdorimeve të tjera të nevojshme publike (shërbimet fetare sociale administrative etj). Ai përfshin, gjithashtu, përdorimet publike kulturore (qendra kulturore, muzeume etj). Në shikim të parë, çdo vendbanim ka institucionet e veta fetare, duke formuar kjo një sipërfaqe ekzistuese është tepër vogël, për shkak të zgjerimit të vendbanimeve si p.sh. të zonës përreth kishës në Shëndelli dhe xhaminë e re pranë Xarrës.



Gjithashtu ekziston një mungesë e gjerë në shërbimet administrative (vetëm një zyrë postare në Xarrë), që tregon varësinë e njësive administrative dhe qendrave të tjera urbane nga Konispoli. Për më tepër, shërbimet kulturore dhe qendra kulturore janë vendosur në ish-zyrat e komunës Mursi. Vështirësitë në identifikimin e njësive për zhvillim dhe nënkategoritë e tyre, na jep më shumë mundësi për planifikimin e tyre. Kështu, një zonë e re me shërbimet administrative është propozuar të jetë e vendosur në Shkallë (funksion të zjarrfikësve, stacioni i ambulancës dhe stacionin e policisë), për shkak të pozitës qendrore të vendbanimit dhe qasjes së tij të mirë nga rrjeti rrugor kombëtar. Theksohet se për vendosjen e zonave të reja, duhet të vlerësohet statusi i përdorimit të tokës nëse strukturat janë pronësi publike apo pronë e Bashkisë. Vihet re se standardi në planifikimin e këtyre përdorimeve "do të bazohet në numrin e përgjithshëm të popullsisë së parashikuar të bashkisë Konispol që do t'u ofrohen këto shërbime. Së fundi, mundësia e zhvillimit të një biblioteke të re publike në qendër të Njësive Administrative Mursi duhet të merret në konsideratë.

Njësia Administrative e Konispolit (Vendbanimet: Çiflik, Konispol).

Në situatën e tanishme, ka një mungesë të madhe të zgjerimit të hapësirave publike në të dy vendbanimet urbane të Konispolit dhe të Çiflikut. Kështu, planifikimi i standardeve për zgjerimin e hapësirave publike duhet të jetë prioritet sidomos për Konispolin. Standardi për hapësira të gjelbra masive (parqe, kopshte etj) është shqetësim, kryesisht në territoret urbane. Megjithatë, standardet e planifikuara që nga periudha (komuniste) për këto zona janë arritur pasi ka pasur pjesë në drejtim të kodrave për zgjerim. Për këtë arsye, një qasje për zhvillimin e zonës është propozuar. Hapësira të tjera publike (përfshirë sheshet, rrugët, pedonalet etj) duhet të zgjerohen, sidomos në qendër të çdo vendbanimi. Më konkretisht, këto lloj hapësirash do të zgjerohen në qendrën historike të Konispolit (shih projektet pilot të propozuara), ndërsa në Çiflik planifikimi i një hapësirë publike (sheshi) duhet të jetë prioritet. Sot, këto nevoja për hapësirë publike janë vendosur kryesisht, në qendra dhe udhëkryqe të rrugëve. Shqetësimet për zonën periferike janë kryesisht ruajtja e zonave të gjelbra dhe vlerësimi i tyre si zona rekreative, zona për zhvillimin e kulturës dhe objekteve sportive etj. Nëpërmjet planit specifik, një zonë kryesore është propozuar për zhvillim në zonën e pyllëzuar të Konispolit. Kjo ndërhyrje ka të bëjë me zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe rekreative (teatër të hapur në hapësirë, pikat e pushimit, shtigje etj) për valorizimin e plotë të zonës së pyllëzuar.

Njësia Administrative Markat (vendbanimet: Markat, Ninat, Janjar, Dishat, Vërvë, Shalës)

Në situatën e tanishme, në Njësine Administrative Markat ka mungesë të rëndë në këto tipe të hapësirave publike. Për këtë arsye, zhvillimi i hapësirave të tilla është e domosdoshme për popullsinë rezidente (si dhe për rolin turistik të vendbanimeve të veçanta). Prioritet duhet t'u jepet vendbanimeve të cilat përqendrohen me popullsi rezidente (Shalës, Markat). Është propozuar që njësi të tilla të zënë një sipërfaqe 0,1 ha. Një nga zgjidhjet e rekomanduara të projektit është projektimi hapësirës publike qendrore duke kombinuar hapësirat e shesheve me shesh lojërash në të njëjtën njësi. Standardi për hapësira të gjelbra masive (parqe, kopshte etj)



në fusha të tilla rurale, në shumë raste nuk është i nevojshëm. Hapësira të tjera publike (përfshirë sheshet, rrugët, pedonalet etj) duhet të zgjerohen, sidomos, në qendër të çdo vendbanimi (siç është përshkruar më lartë). Më konkretisht, këto lloje hapësirash publike duhet të jenë të vendosura në Markat (në afërsi të qendrës ekzistuese) dhe në qendër të Shalës. Në vendbanimet më të vogla, zhvillimi i hapësirave të tilla (sheshi qendror i fshatit) do të mbështesë formimin e identitetit të tyre dhe do të orientojë në strukturën e synuar hapësinore (nevojë për konsolidim, dendësimi etj). Sot, të gjitha nevojat për hapësira publike janë shërbim, kryesisht, në qendrat/akset e rrugëve. Shqetësimi për zonat periferike, qëndron në zhvillimin e zonave rekreative, zonat për zhvillimin e kulturës dhe objekteve sportive etj. Nuk ka nevojë për planifikim specifik për sigurimin e zonave të tilla në pjesët rurale të Bashkisë. Megjithatë, ndërhyrjet e vendosura në zonat ndërrbane (aktivitetet kulturore, rekreative, shtigje etj) duhet të vendosen për një periudhë afatgjatë. Nuk ka analizë fizibiliteti për përcaktimin e zonave speciale të gjelbëra.

Hapësira të tjera publike

Ky standard përfshin sipërfaqen minimale për funksionimin e hapësirave të tjera të nevojshme publike (shërbimet fetare sociale administrative etj). Kjo sipërfaqe përfshin, gjithashtu, shërbimet publike kulturore (qendra kulturore, muzeume etj). Në qendrën administrative Markat, institucioni fetar përbëhet nga një xhami në Shallë. Lidhur me shërbimet kulturore, ka një qendër kulturore në ndërtim e sipër në Markat dhe një muze i ri në Ninat. Përmes këtij plani, një bibliotekë e re komunale është propozuar të jetë e vendosur në Markat. Për vendosjen e këtij shërbimi sugjerohet një prej ndërtesave të vjetra (pas rehabilitimit të saj). Nga ana tjetër, shërbimet kulturore mund të vendosen në ndërtesat ekzistuese me infrastrukturë sociale. Për sa i përket përdorimeve administrative, shërbim administrativ është zyra e njësise administrative, e cila është e vendosur në Markat. Ndërtesat ekzistuese mund të ketë një përdorim të dyfishtë (sallë bibliotekë apo një muze të vogël folklorik). Në përgjithësi, propozohet që zonat e reja publike të shërbejnë dhe për të dyja njësiet e Shalës dhe Markatës.



[illegible]

1. *Journal of Management Studies*, 1997, 34, 1, 1-14.




1.5 Zonat e mbrojtura kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve

Bashkia e Konispolit sot paraqitet e pasur me shumë monumente natyrore, objekte arkeologjike, kulturore dhe historike të trashëgimisë kulturore kombëtare, por pjesa më e madhe e tyre është rrënuar. Një pjesë e Parkut Kombëtar Ligatinor të Butrintit, kategoria e II, shpallur me VKM nr.134 datë 20.02.2015 përfshin në zonat e saj edhe territore të bashkisë Konispol sipas hartës bashkangjitur kësaj VKM-je. Ky park përmbush dhe kushtet për zonë RAMSAR. **Kanali i Vivarit** së bashku me burimet e kripura të **Mullirit, Këneta e Vrinës, Mali i Milese** janë zona të mbrojtura. **Mali i Milesë** ngrihet midis fshatrave Markat, Dishat dhe Shalës, me një lartësi maksimale 1041m. Në juglindje të malit ndodhet Qafa e Dishatit që ndan malin e Milesë nga ai i Saraqinit.

Mali i Saraqinit është vazhdim i malit të Milesë që së bashku përbëjnë vargmalin Saraqin-Mile, ruan drejtimin veriperëndimor dhe juglindor, në fshatin Dishat arrin lartësinë më të madhe 1034 metra. Në anën perëndimore të tij është formuar një tarracë piktoreske që vendosit e quajnë Sheshi i Madh. Po në këtë drejtim formohet një shpat që bie thikë mbi luginën e Lumit Pavëll dhe quhet Pirjot ku zbret dhe përroi Pirjot me ujë të bollshëm në stinën e dimrit.





LEGJENDE

- | | |
|---------------------------------------|--|
| — Rruge e kategorisë së parë | A1 Nivellore në rrugë të vecante |
| — Rruge e kategorisë së dytë | A2 Nivellore Mjedisore Natyrore |
| — Rruge e kategorisë së tretë | A3 Nivellore e Transmigrime Kulturore dhe Natyrore |
| — Lumenj | |
| — Përrenj | |
| — Përrenj të përkohshëm | |
| — Kufiri i Parkut të Butrintit | B Zone Rëzimi |
| — Kufiri bregdetor i Parkut Butrintit | C Zone e Përdarimit Tradicional |
| — Liqene, ujëmbledhëse | C1 Peshqimi Tradicional |
| — Zone Informale | C2 Blegori dhe Rëzimi Tradicional |
| — Zone Urbane | D Zone e përdarimit të përkohshëm |

Figura 4. Harta e zonës RAMSAR Butrint sipas VKM 134.
Burimi: AKZM






Figura 5. Shpella e Konispolit dhe Kanali i Vivarit
Burimi: AKMM, Foto nga ekspertët

Një nga monumentet natyrore (gjeomonument, kategoria III) me rëndësi është vendbanimi shpellor, nga më të rëndësishmit jo vetëm në Shqipëri por edhe në Europën Juglindore, i cili ndodhet në afërsi të Konispolit. Ai përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë. Shpella ka edhe vlera gjeomorfologjike, didaktike, turistike dhe ekonomike. E veçanta e kësaj shpelle është se ka vazhduar jeta që nga njeriu primitiv e deri në shekullin e XII. Jetëgjatësia e shpellës është rreth 27.000 vjet rresht.

Tabela 5. Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në bashkinë Konispol

Nr.	Zona	Emërtimi
1	Konispol	Gryka e Bogazit (III)
2	Konispol	Shpella e Konispolit(III)
3	Vrinë	Këneta e Vrinës(II)
4	Xarrë	Liqeni i Rezës(II)
5	Xarrë	Burimet e Kripura të Mullirit(III)
6	Xarrë	Kanali i Vivarit (II)

Burimi: Ministria e Mjedisit

Trashëgimia kulturore përfaqësohet nga një numër i madh objektesh. Qyteti antik i Çukës është ngritur mbi një kodër pranë fshatit Çiflik, sipërfaqja e shtrirjes së qytetit është rreth 4 ha. Ai përbëhet nga mure rrethuese, ka 4 porta dhe janë rreth 40 banesa të periudhes antike. Manastiri i Shën Kollit ndodhet në një kodër buzë lumit Pavëll mes fushës së Mallahunës e pranë fshatit Çiflik.

Sot në Konispol janë ende në këmbë edhe 7 banesa monument kulture në lagjen Shehat. Në planin historik Konispoli ka edhe themelet e tri kalave mesjetare por sot dihet vetëm një mur i kalasë së Buarit.

Në Xarrë ndodhen monumentet kryesore, veçanërisht atyre arkeologjike, egzistojnë monumentet e kultit si manastiri i Shën Ilias, ai i Shën Thodhorit, Shën Marina.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol


Tabela 6. Lista e monumenteve të kulturës në bashkinë Konispol
(Shpallur monument kulture me Urdhëresën e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 266/1, datë 16/02/1979)

Nr.	Fshati	Emërtimi
1	Janjar	Kulla e Janit
2	Verve	Banesa e Ruzhdi Omerit
3	Dishat	Banesa e Azbi Sheretit
4	Shalës	Banesa e Shaban Xhemaliut
5	Markat	Banesa e Eqerem Myrtos
6	Xarrë	Banesa e Bujar Lamçes

Burimi: Ministria e Kulturës



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol



Harta 16 - (18g) Harta e objekteve dhe zonave të rëndësishme kombëtare të propozuara



1.6 Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban

Zonat e zhvillimit janë përzgjedhur pas përcaktimit të zonave natyrore dhe zonave me kufizime në zhvillim/ndërtim. Ata janë përcaktuar në bazë të një numri kriteresh, me qëllim për të akomoduar nevojat e identifikuara për zhvillimin e turizmit të ardhshëm, sipas vizionit dhe strategjisë së paraqitur. Tri kriteret kryesore janë aplikuar në përcaktimin e zonave të zhvillimit:

- i. Përmirësimi i strukturës së zonave të vendbanimeve dhe racionalizimin e zhvillimit ekzistues. Këto vlejné për zgjerimin e zonave ekzistuese të ndërtuara dhe synojné të trajtojnë problemet e krijuara si pasojë e ndertimeve informale, si karakteristikë në 10-15 vitet e fundit;
- ii. Rritja e interesit për zonat rezervë natyrore për lloje të ndryshme të zhvillimit të turizmit duke ndjekur objektivat e vizionit me qëllim forcimin e avantazhit konkurrues të Bashkisë, në mënyrë që të tërheqë investime të reja për turizmin e cilësisë së lartë. Kjo është një formë proaktive;
- iii. Përshtatja dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike në destinacione që nuk rrezikojné atraktivitetin e pejzazhit dhe të tjera përdorime të tokës.

Zonat e aktiviteteve ekonomike të Konispolit përqendrohen kryesisht në nevojat për agroekonomi të popullsisë vendase dhe së dyti nevoja për shërbime aktivitetet ekonomike janë të përqendruara përgjatë akseve rrugore që lidhin Vrinë-Shendelli-Xarrë-Murësi- Shkallë. Ky do të jetë boshti ekonomik i Bashkisë.



Figura 6. Rehabilitimi i unazës ekonomike të Bashkisë Konispol (Vrinë - Shkallë)

Burimi: Bashkia Konispol

Për sektorin e bujqësisë është evidente nevoja për mbështetjen e funksionimit të magazinuave bujqësore të cilat janë përqendruar përgjatë luginës në vende të rastit. Kjo krijon shumë



probleme për mbledhjen e produkteve. Ky proces është aktualisht duke u zhvilluar në baza ad hoc të organizuara veçmas për secilin prodhues. Aktiviteti ekzistues përfshin qarkullimin e kamionëve nga rruga e brendshme e Cukë-Butrint, si dhe ndërtimin e depove në vende të rastit nga çdo prodhues.

Plani propozon organizimin e sistemit të grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore të bashkisë së Konispolit. Është propozuar që organizimi i proceseve (paketim-produktit, mbledhje-grumbullim-përgatitje, etj), të vendosen përgjatë aksit që lidh Xarrë-Murësi-Shkalla. Një qendër e organizuar paketimi koleksioni është propozuar që të jetë e vendosur në vendin e ish-magazinave bujqësore ndërmjet Xarrës dhe Murësisë. Objekte individuale mund të lejohen të vendosen në bosht me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore.

Ndërtimi dhe funksionimi i një pakete bujqësore dhe i njësisë së shpërndarjes.

Projekt Pilot A.2:

Ky program ka për qëllim investimet publike që do të funksionojë si infrastrukturë kooperative të cilat kanë një rol thelbësor për prodhimin bujqësor. Kjo ndërhyrje ka të bëjë me ndërtimin e një njësie për mbajtjen e objekteve të larjes / pastrimit, ruajtjes, paketimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore. Ky projekt do të sjellë përfitime për shërbimin më të mirë të fermerëve individuale, lehtësimin e transportit dhe logjistikën e produkteve. Këto fakte janë një hap i parë drejt vertikalizimit gradual të prodhimit, duke krijuar mundësi të reja punësimi për banorët lokal.



Figura 7. Objektet e njësive bujqësore të përpunimit dhe paketimit të ullinjve,
Burimi: Kooperativa bujqësore e Agrinion-it, Greqi





Figura 8. Renditja, ruajtja, paketimi dhe shpërndarja e produkteve bujqësore, kompania private
Burimi: "Pantazis Fruits SA" në Greqi

Përveç kësaj zona me kapacitet të vogël për funksionet mbështetëse bujqësore parashikohen si zgjidhje në zgjerimin përreth zonave ekzistuese. Nuk ka ndonjë zonë të sugjeruar për njësitë e prodhimit blegtoral pasi ky lloj produkti është organizuar në nivel familjar në Njësinë Administrative Markat.

Përveç qendrave të paketimit bujqësor dy zona të tjera me aktivitet ekonomik janë propozuar gjatë aksit ekonomik të Bashkisë:

- Një zonë ekonomike është projektuar ndërmjet Murrësit dhe Shkallës me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 16 ha (për depot bujqësore dhe njësi te përpunimit)
- Një zonë ekonomike tregtare është vendosur përgjatë rrugës nacionale në hyrje të vendbanimit të Shkallës brenda kufijve të vendbanimeve të dedikuara për funksion tregtare dhe impakt ekonomik të lehtë (karburante, garazhe).



[illegible]

Journal of Management Education 36(7) 809–826



Zonat ekonomike janë të përqëndruara kryesisht në zonën e Xarrës por edhe në brendësi të bashkisë Konispol. Totali i zonave ekonomike të bashkisë Konispol i shprehur në hektarë është **27.61 ha**; i shprehur në njësi administrative :

Xarre ka një sipërfaqe të dedikuar për zonat ekonomike prej **18.39 ha**

Konispol ka një sipërfaqe të dedikuar për zonat ekonomike prej **9.22 ha**

1.7 Tipologjitë e propozuara hapësinore dhe metodat e ndërhyrjes në territor

Në fazën e analizës territoriale kanë qënë të identifikuar tipologjitë e zonave urbane të bashkisë Konispol sipas zhvillimit të situatës aktuale. Kjo analizë përfshin të gjithë sistemin urban të gjithë territorit të të gjithë Bashkisë .

- Venbanimet fushore me karakter rural janë vendosur në formacione të vogla kodrinore përgjatë luginës së Vrinës dhe njëkohësisht kryejnë aktivitete me destinacion buqësor. Këto janë fshatrat e Vrina, Shendelli, Xarra, Shkalla, Çiflik. Ato përbëhen nga shtëpi rurale për popullsi permanente që ushtrojnë aktivitete agroekonomike. (A4).
- Vendbanimet malore dhe kodrinore me karakter tradicional. Ato përbëhen nga pjesë zone tradicionale (Zona A1) dhe zgjerim banimi(A4). Në këtë kategori janë vendbanimet e Konispolit dhe Murrësit.
- Vendbanimet malore me orientim në aktivitetet blegtoral. Ata përbëhen nga densitet i ulët i shtëpive rurale pa asnjë shërbim. Këto janë vendbanimet e Markat, Ninat Vervë, Dishat, që janë në nevojë për dendësim.



Dendësim/Mbushje urbane e tokës: Kodi [DENDËSI]

Është procesi i densifikimit të një njësie të sistemit urban pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të njëjtë karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet. Kjo mënyrë ndërhyrjeje synon përdorimin e sa më eficient të tokës truall si dhe rrjeteve të infrastrukturave publike. Kjo lloj ndërhyrjeje vlen vetëm për zonat urbane ekzistuese dhe duke iu referuar zonave relativisht të vogla të tokës vakante në mes të territoreve të urbanizuara ose pjesërisht të urbanizuara. Ata zakonisht nuk kërkojnë një PDV.

Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizotërojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësisë. Kjo lloj ndërhyrjeje nuk ndryshon në asnjë rast karakterin dhe tipologjinë e ndërtimit. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

Konservimi Urban Historik: Kodi: [KONSERV]

Konservimi është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar, në formën e tij ekzistuese origjinale. Është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga Bashkia apo çdo person juridik ose fizik, të cilat synojnë ruajtjen e një përdorimi, strukture dhe territori urban, të veshur me vlera ekonomike, sociale, historike e kulturore dhe mjedisore në kohë, dhe të raporteve që ajo krijon me mjedisin natyror apo të ndërtuar që e rrethon, për të realizuar zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi. Konservimi ka dy aplikime të ndryshme duke iu referuar urbanizimit dhe territorit natyror.

Konservimi urban nënkupton ruajtjen e karakterit, tipologjive dhe përdorimit ekzistues të zonave të caktuara të qytetit dhe fshtreve. Shkalla e ndërhyrjeve në lidhje me rritjen e intensitetit dhe strukturat e ndërtimit është minimale, ndaj treguesit e propozuar përputhen ose janë përafërsisht të barabartë me ato të gjendjes ekzistuese. Në qytet dhe qendrat e fshtarave ndërhyrjet nënkuptojnë rehabilitimin e infrastrukturave, shërbimeve publike, banesave, elementëve të dizajnit urban. Këto ndërhyrje aplikohen në zonat e komplekseve të banimit me koncepte hapësinore të qarta të ndërtuara para viteve '90.

Për bashkinë e Konispolit konservimi urban i referohet:

- Zonave qendrore të vendbanimeve ekzistuese me elemente të karakterit tradicional (A1) / Konispol, Murësi, Markat;
- Monumenteve të trashëgimisë kulturore (M3).

Konservimi Natyror: Kodi: [KONSERV]

I referohet territoreve brenda sistemit natyror dhe sistemit të ujit, të cilat formojnë burime të vlefshme natyrore të Bashkisë që meritojnë të jenë të mbrojtura nga zhvillimi. Janë të përfshira në këtë kategori kombëtare zona të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi (N1, N2, N3 dhe U1,



U3, U4) dhe zonat e mbrojtura të propozuara nga PPV-ja duke ju referuar kategorive të zonimit(N5, N6).

Në bashkinë Konispol fushat kryesore të destinuara për konservim natyror janë:

- Pjesa e territorit të përfshirë në Parkun Kombëtar të Butrintit;
- Lugina e Vrinës dhe lugina e lumit Pavel si dhe produktiviteti i lartë i tokës bujqësore;
- Shpatet malore në zonat bregdetare të bashkisë, Xarrë dhe Markat;
- Zonat mbrojtëse të trupave ujqor në kanalin e Vivarit, lumi Pavel, rezervuaret e Murrsisë dhe Janjarit;
- Zonat e mbrojtura panoramike me ullishtet e Konispolit.

Koncepti i Konservimit është aplikuar edhe në zona të tjera të cilat nuk i përkasin sistemit natyror dhe ujqor, por janë të mbrojtura nga zhvillimi me anë të zonimit të tyre të caktuar nga PPV-ja, përkatësisht:

- Toka bujqësore e kategorive (B1, B2) nën konservim bujqësor me kuptimin e mbrojtjes së përdorimit të tokës për qëllime bujqësore;
- Sipërfaqet e gjelbra dhe hapësirat publike, pyjet përreth (AR3, AR4).

Konsolidim Urban Kodi: [KONSOL]

Konsolidimi urban është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Konsolidimi urban korrespondon me kuptimin e zhvillimit kompakt urban. Ai nënkupton zhvillimin e zonave të urbanizuara me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe shfrytëzimin eficient të infrastrukturave publike. Procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit si në nivel zone ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave, dhe ndërtimi i infrastrukturave të shërbimit. Nënkupton gjithashtu rikualifikimin dhe përfortimin e strukturës urbane të atyre zonave, të cilat kanë një skelet hapësinor, ose fillesa të tij të mirëpërcaktuara, por për arsye të ndryshme në zona kanë ndodhur shumë ndryshime.

Konsolidim urban vlen për pjesën më të madhe të zonave ekzistuese urbane të qyteteve shqiptare duke iu referuar kryesisht zhvillimit pas viteve 1990 përmes proceseve të ndërtimit informal apo të zhvillimit me densitet të ulët shpërndarës që të çon në përdorimin joefikas të tokës.

Një (përkufizim) kuptim i dytë i konsolidimit urban i referohet përqendrimit të aktiviteteve ekonomike në zona të specializuara për komunitete të caktuara nëpërmjet planit. Duke pasur parasysh se aktivitetet ekonomike kanë ndjekur si model një zgjerim zhvillimi të ngjashëm dhe zhvillim spontan, ekziston nevoja për përqendrimin e tyre në mënyrë që mund të minimizohet ndikimi negativ për përdorime të tjera dhe për të rritur efektin e mundshëm pozitiv në klastër.

Për bashkinë Konispol fushat kryesore të destinuara për konsolidim urban janë:



- Të gjitha zonat e banimit të fshatrave (A4);
- Zonat e organizuara/përfitues të aktiviteteve ekonomike (IE2,3,4).

Rigjenerim/Rikualifikimi: Kodi [RIGJEN]

Nënkuptohet ringjallja, rikthimi i funksioneve të mëparshme, ose rehabilitimi, rikthimi i vetive natyrore peizazhiste të zonave të degraduara të cilat në gjendjen aktuale e kanë humbur atë. Shkalla e ndërhyrjeve në këto zona varion që nga ndërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemimet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet peizazhiste për të rritur vlerat estetike të qytetit dhe fshatrave. Rikualifikimi ekonomik zbatohet në zona ekonomike të cilat kanë degraduar por nga pozicioni i tyre në qytet, mbeten përsëri të rëndësishme për të funksionuar si të tilla. Rikualifikimi ambjental peizazhist zbatohet në territore të lira të cilat për efekte ambientale apo peizazhiste propozohen të kthehen në breza të gjelbër sanitar dhe rekreativ.

Koncepti i rikualifikimit i referohet kontekstit të sistemeve natyrore dhe bujqësore.

- Rikualifikimi në sistemin urban synon të realizojë përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke u fokusuar kryesisht në hapësirat dhe burimet publike.
- Rikualifikimi në sistemin natyror i referohet konceptit të rehabilitimit të pejzazhit dhe natyrës në rastet e zonave me dëmtime mjedisore ose zona të degraduara.
- Rikualifikimi në sistemin e bujqësisë i referohet rastit të tokës së papunuar, si dhe tokave jo pjellore dhe të pafutshme.

Për bashkinë e Konispolit fushat kryesore të destinuara për rigjenerim / Rikualifikim janë:

- Zonat urbane akupunture - (AR3, AR4);
- Agroturizmit dhe zonat caktuar për ekoturizëm (B5, N4);
- Tokë bujqësore e kripëzuar (B6) (Liqeni i Butrintit).

Rizhvillim: Kodi [RIZHVIL]

Rizhvillimi është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një zone, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore. Ai është një veprim në procesin e planifikimit, në njësitë me dendësi të mesme deri të lartë banimi dhe përdorimi, i cili ka për qëllim të rivlerësojë treguesit e zhvillimit të njësisë. Kryhet në zona të zhvilluara më parë, duke ndryshuar tërësisht strukturën e ndërtimeve ekzistuese, funksionet e tyre dhe/ose treguesit e zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp). Zonat e dedikuara për rizhvillim janë gjithmonë subjekt i PDV-së.

Për bashkinë e Konispolit fushat kryesore të destinuara për rizhvillim janë:


- Magazinat e braktisura bujqësore në aksin Xarrë-Murrësi - rizhvillim, Qendra paketimi dhe grumbulimi (IE4).



Urbanizim, Kodi: [URBAN]

Eshtë procesi i ndryshimit të territorit nga përdorim rural në urban. Urbanizimi është i lidhur me rritjen graduale të përqindjes së popullsisë që jeton në zonat urbane dhe mënyrat në të cilat çdo shoqëri i përshtatet këtij ndryshimi. Ky proces ka filluar në Shqipëri kryesisht në periudhën pas viteve 1990 deri në fillim të viteve 2000 dhe ka kryer një ndryshim të rëndësishëm të përdorimit të tokës nga bujqësore dhe natyrore në favor të sistemeve urbane. Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe mbrojtjen e tokës primare bujqësore dhe natyrore janë propozuar për urbanizimin zona shumë të vogla përmes PPV-ve. Procesi i urbanizimit në kontekstin e zonës së studimit për bashkinë Konispol i referohet kryesisht zonave të propozuara për zhvillime:

- a) Rajonale bujqësore (IE4);
- b) Zona të kufizuara për zhvillime rezidenciale, që nuk përbëjnë tokën primare bujqësore (A4).



Harta 119 – (18e) Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar



1.8 Përcaktimi i njësive që do të nënshtrohen hartimit të PDV-ve sipas ligjit

Zonat dhe njësitë strukturore, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-ve janë të përcaktuara sipas tipologjive kryesore të zonave si edhe mbi bazën e detyrimeve ligjore për ato njësi që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së. Klasifikimet e njësive vijojnë si më poshtë:

Tipologjitë kryesore të zonave të projektuara për PDV janë:

- a. Zonat e propozuara për format e organizuara të investimeve turistike (resorte-vila). Nënkatëgoritë S3 (ose/dhe S2);
- b. Zonat e zgjerimeve rezidenciale me sipërfaqe më shumë se 5 ha, sidomos në zonat bregdetare turistike. Nënkatëgoritë A4, A5;
- c. Zonat e propozuara të aktiviteteve të organizuara ekonomike me sipërfaqe më shumë se 5 ha ose me ndikim të mesëm ambjental. Nënkatëgoritë IE1-4;
- d. Zonat me prioritet zhvillimi, të projektuara nëpërmjet zonimeve të PPV-ve për rizhvillim, ristrukturim ose rikonceptim;
- e. Zonat e ndërtimeve informale.

Tipologjitë kryesore të zonave, ku nuk ka detyrim për hartim të PDV-ve janë:

- a. Qendrat historike të qytetit dhe qendrat e vendbanimeve tradicionale, ku leja e zhvillimit është shqyrtuar rast pas rasti sipas kriterëve morfologjike. Nënkatëgoritë A1, M1, M2;
- b. Zonat ekzistuese urbane të qyteteve (të përiudhës së Pasluftës), ku është zbatuar më parë një plan rregullator dhe ku ekziston një rrjet rrugësh dhe vija e ndërtimit. Nënkatëgoritë A2, A3, A4;
- c. Qendrat ekzistuese të vendbanimeve rurale (të përiudhës së pas luftës), duke përfshirë zgjerimet e vogla deri në 25% , që nuk ndodhen në zonën bregdetare, duke ju referuar kryesisht vendbanimeve të para të popullsisë lokale. Nënkatëgoritë A3, A4;
- d. zona për përdorim publik, për përdorime të veçanta dhe infrastrukturë. Katëgoritë SH, AS, IS, ZU, IN, V.

Të gjitha njësitë strukturore që janë subjekt i PDV-së në bashkinë e Konispolit dhe i përkasin zonave me rëndësi kombëtare, si dhe ndodhen brenda Vijës Blu, do të hartohen me "PDZRK". Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së janë të renditura në tabelën e mëposhtme.



Tabela 7. Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së

Njësia administrative	Vendbanimi	Kodi i zonës	Kodi i njësisë	Sip. (ha)
KONISPOL	CIFLIC	KO.UB.1	KO.UB.1.355	5,48
	KONISPOL	KO.UB.2	KO.UB.2.88	3,09
			KO.UB.2.101	1,74
			KO.UB.2.235	1,39
			KO.UB.2.236	14,29
MARKAT	SHALES	MA.UB.1	MA.UB.1.106	6,51
			MA.UB.1.346	2,71
XARRE	MURSI	XA.UB.4	XA.UB.4.283	0,54
			XA.UB.4.284	1,93
	SHENDELLI	XA.UB.2	XA.UB.2.9	0,21
			XA.UB.2.48	0,11
			XA.UB.2.50	10,15
			XA.UB.2.51	0,54
			XA.UB.2.52	0,23
			XA.UB.2.53	0,02
			XA.UB.2.54	1,02
			XA.UB.2.55	0,12
			XA.UB.2.205	2,39
			XA.UB.2.206	9,56
			XA.UB.2.404	2,65
	XARRE	XA.UB.3	XA.UB.3.175	11,19
			XA.UB.3.299	6,12
			XA.UB.3.300	23,91
			XA.UB.3.365	18,56

Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDZRK-së janë të renditura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9. Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së

Njësia administrative	Vendbanimi	Kodi i zonës	Kodi i njësisë	Sip. (ha)
XARRË	VRINE	XA.N	XA.N.426	199,63



1.9 Shpërndarja e popullsisë dhe parashikimet demografike

Bazuar në Rregulloren e Planifikimit të Territorit, neni 81 pika 2, përcaktohet se, “Standardet e Planifikimit ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territore urbane dhe kategorizohen sipas rastit për grupe popullsie: a) deri në 10,000 banorë, b) mbi 10,000 banorë”. Në këtë kontekst, numri i banorëve, verifikimi i tyre, inventari sa më i saktë i numrit të popullsisë ose atyre personave që parashihet t’iu shërbejë, është kusht paraprak për çdo investim projekti dhe procesi vendimmarrjeje. Duke vlerësuar pasaktësitë për përcaktimin e numrit të saktë të popullatës në diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt të planifikimit të përdoret burimi i Gjendjes Civile, ndërsa për projektim të përdoren burime alternative informacioni me shkallë më të ulët gabimi.

Projeksioni i popullsisë për periudhën e ardhshme është gjithashtu një domosdoshmëri për planifikimin e zhvillimit social-ekonomik të Bashkisë. Në vijim, do të paraqitet projeksioni i popullsisë për 15 vitet e ardhshme i bazuar në parametrat që parashikon INSTAT. Sipas vlerësimeve të INSTAT-it, në nivel kombëtar, popullsia e Shqipërisë është zhvilluar në 25 vitet e fundit në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe gjithashtu është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të të rinjve, përsheptuan ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vihet re në pothuajse të gjitha bashkitë.

Projeksionet e popullsisë në bashkinë Konispol deri në vitin 2031, janë bazuar në metodologjinë e përdorur nga INSTAT-i që ka kryer llogaritjet dhe parashikimet e popullsisë për gjithë Shqipërinë dhe në veçanti për qarqet e saj. Në këtë rast projeksionet për Qarkun e Vlorës të parashikuara nga INSTAT janë përdorur për të kryer projeksionet e popullsisë për bashkinë Konispol dhe njësitë administrative përbërëse të kësaj Bashkie.

Tabela 8. Projeksionet e popullsisë 2016-2031, Bashkia Konispol

Popullsia sipas vitit					
Njësi administrative	2011	2016	2021	2026	2031
Konispol	2123	2206	2227	2210	2187
Markat	1859	19315	1950	1935	1915
Xarrë	4263	4429	4472	4438	4391
Bashkia e re Konispol	8245	8567	8649	8583	8492
	100	103.9	104.9	104.1	103.6

Burimi: INSTAT 2011, vlerësimet e konsulentit






Figura 9: Grafiku i projeksioneve të popullsisë për bashkinë Konispol
Burimi: Punuar nga ekspertët

Siç shihet nga tabela dhe figura e mësipërme bazuar në projeksionet e INSTAT-it, popullsia rezidente e bashkisë Konispol në vitin 2031 parashikohet të arrijë shifrën 8,492 banorë me një rritje prej vetëm 3% në krahasim me vitin 2011, që përbën edhe vitin bazë të përlllogaritjeve për këto projeksione. Nivelin më të lartë të popullsisë bashkia Konispol parashikohet ta arrijë në vitin 2021 me 8,649 banorë me një rritje prej 4.9% më shumë se në vitin 2011.

Me të njëjtën procedurë janë llogaritur edhe ndryshimet e popullsisë brenda njësive administrative të bashkisë Konispol. Kështu, Xarra parashikohet të ketë popullsinë më të madhe nga të gjitha njësitë e tjera administrative me 4,391 banorë në vitin 2031 në krahasim me 4,263 banorë që janë regjistrimet për vitin 2011.

Rritja e popullsisë është një nga treguesit themelorë të progresit të çdo shoqërie. Kjo, pasi një rritje e qëndrueshme e saj jo vetëm flet për një popullsi të shëndetshme nga pikëpamja e moshës mesatare të saj dhe evitimit të tendencës së "plakjes" së popullsisë, por gjithashtu një rritje me baza të qëndrueshme do të krijojë premisa për përthithjen në tregun e punës të një numri më të madh të forcës punëtore, në mënyrë që të garantohet një rritje e qëndrueshme ekonomike.

Projeksionet e popullsisë në bashkinë Konispol deri në vitin 2031, janë bazuar në metodologjinë e përdorur nga INSTAT-i që ka kryer llogaritjet dhe parashikimet e popullsisë për gjithë Shqipërinë dhe në veçanti për qarqet e saj. Në këtë rast projeksionet për qarkun e Vlorës të parashikuara nga INSTAT janë përdorur për të kryer projeksionet e popullsisë për bashkinë Konispol dhe njësitë administrative përbërëse të kësaj Bashkie.



Tabela 9. Projektionet e popullsisë 2016-2031, bashkia Konispol

Popullsia sipas vitit					
Njësi administrative	2011	2016	2021	2026	2031
Konispol	2123	2206	2227	2210	2187
Markat	1859	1932	1950	1935	1915
Xarrë	4263	4429	4472	4438	4391
Bashkia e re Konispol	8245	8567	8649	8583	8492
	100	103.9	104.9	104.1	103.0

Burimi: INSTAT 2011, vlerësimet e konsulentit

Dendësia e popullsisë në bashkinë e Konispolit, sipas regjistrimit të fundit të INSTAT-it dhe parashikimet zyrtare mbetet e ulët. Në një territor të përgjithshëm prej 22.246 ha popullsia e parashikuar në 2031 do të jetë 8492 banorë, e cila korrespondon me 0.38 banorë për hektar.

Shpërndarja territoriale e popullsisë në bashkinë e Konispolit ndikohet nga dy faktorë bazë:

- Tendencat e migrimit të 25 viteve të fundit kane reduktuar ndjeshëm numrin e banorëve të përhershëm në Konispol. Një fenomen tjetër i vërejtur është rënia në mënyrë të ndjeshme e numrit të lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të të rinjve, përshpejtojnë ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vihet re në pothuajse të gjitha bashkitë. Këto tendenca kanë shkaktuar braktisjen e konsiderueshme të fshatrave të largëta në zonat malore të Markatit me një numër të madh shtëpive të braktisura në këto zona.
- Rritja dhe zhvillimi i ekonomisë bujqësore të zonës pas vitit 2000 është shoqëruar me një rritje të butë të popullatës së përhershme banuese në zonat bujqësore të luginës së Vrinës. Ky faktor ndikon kryesisht në Njësinë Administrative të Xarrës. Ky fenomen ka shënuar një ndryshim të shpërndarjes territoriale të popullsisë nga ajo malore në zonat fushore. Ky ndryshim i përket kryesisht popullsisë së përhershme të angazhuar në sektorin e bujqësisë.

Konispoli ka luhatje të lehta të popullsisë sezonale që i atribuohet kryesisht qytetarëve që kthehen dhe në një përqindje të vogël shtëpive të dyta. Ky efekt i kufizuar i luhatjeve reflektohet në popullsinë e turizmit (shih raportin e vizionit dhe të strategjisë territoriale, seksioni 4.5.9). Popullsia e turizmit në bashkinë Konispol bazuar në të dhënat zyrtare arrin në 12.057 persona.



Tabela 10. Të dhënat për përlogaritjen e popullsisë së turizmit

Indikatorët	Bashkia Konispol
Popullsia Rezidente (2011)	8245
Populli e rikthyer në periudhën e verës	3434
Pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore	378
Turistët	-
Të punësuarit sezonale	-
Totali	12057

Burimi: Punuar nga ekspertët me të dhëna nga INSTAT, 2016

Objektivat kryesore të zonimit të propozuar nga PPV-ja në lidhje me shpërndarjen territoriale të popullsisë së bashkise Konispol ka qenë:

- Ruajtja e popullsisë së përhershme ekzistuese në vendbanimet malore dhe të sigurojë stimuj për pronarët për ripërdorimin dhe rinovimim e banesave dhe pronave të tyre (zona A1, A4);
- Sigurimi i zonave të reja banimi në vende të përshtatshme për popullsinë e angazhuar në sektorin e bujqësisë, me qëllim që të tërheqë qytetarët e kthyer dhe qytetar të rinj për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë bujqësore (zona A3, A4);
- Promovimi i një zhvillim të butë të shërbimeve të agroturizmit, ekoturizmit dhe shtëpive të dyta në vende të zgjedhura, në mënyrë që të zhvillojë profilin e zonës me përdorime të lidhura me rivierën turistike (zona B5, N4, S5, A5).

Shpërndarja e zonave të zhvillimit është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11. Shpërndarja e zonave të zhvillimit

	Zona Rezidenciale	Shtëpi të dyta	Zona turistike		
	A1/A3/A4	A5	S5	B5	N4
Konispol	106.63	0	1.86	35	0
Xarrë	134.18	18.56	0.45	24.55	392.88
Markat	124.63	0	1.97	0	229.82
Totali	365.44	18.56	4.28	59.55	622.70

Burimi: Punuar nga ekspertet me të dhëna nga GIS database

Siç shihet në tabelë, shpërndarja e zonave të popullsisë së përhershme i referohet në pjesën më të madhe vendbanimeve ekzistuese. Megjithatë, një pjesë e këtyre zonave janë shumë pak të populluara ose të papërshtatshme për standardet e jetesës të rehatshme për shkak të



pozicionimit në shpatet e larta, aksesit të kufizuar dhe përqindjes së madhe të stokut të ndërtesave të braktisura. Për këtë arsye, janë propozuar dy lagje të reja në Xarrë dhe Konispol. Zgjerime të vogla janë propozuar në Murësi, Çiflik dhe Shalës. Në të gjitha rastet, zonimi ka për qëllim të parandalojë zgjerimin e mëtejshëm të zhvillimit të banimit në tokë bujqësore ose në zonat në shpatet e larta, pa mundësi aksesit. Është propozuar një zone e re për shtëpi të dyta në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit, në pjesën ku lejohet një zhvillim i qëndrueshëm në bazë të planit të menaxhimit. Aktivitetet e agriturizmit janë propozuar në Murësi, Markat dhe Konispol. Aktivitetet e ekoturizmit janë propozuar në zonën bregdetare (gjiri i Ftelias) dhe në rezervuarin e Janjarit.

Dendësitë e parashikuara të popullsisë nga PPV-ja në Konispol radhiten nga dendësi e ulët deri në mesatare. Dendësia e parashikuar në zonat me banorë të përhershëm të vendbanimeve ekzistuese dhe në zgjerimet e reja të banimit është e ulët në masatare në Xarrë dhe Konispol (8-12 persona / 1000m²), që i korrespondon intensitetit 0.4-0.8 dhe dendësi të ulët në Markat (4-8 persona / 1000m²). Dendësia e parashikuar në zonën shtëpive të dyta është e ulët në mesatare (6-10 persona per 1000 m²), që i korrespondon intensitetit 0.6. Dendësia e parashikuar në zonat eko- dhe agroturistike është shumë e ulët (1-2 persona për 1000m²), që i korrespondon intensitetit 0.05-0.1.

Shpërndarja territoriale e popullsisë e parashikuar nga zonimi i PPV-ve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 12. Shpërndarja territoriale e popullsisë

	Rezident të përhershëm, qytetarë të kthyer dhe shtëpi bosh	Popullsia në shtëpitë e dyta	Numri i turistëve, përdoruesve		
	A1/A3/A4	A5	S5	B5	N4
Konispol	8333	0	55	700	0
Xarrë	13661	1392	32	245	1964
Markat	7410	0	76	0	1194
Total	29404	1392	163	945	3158

Burimi: Punuar nga ekspertët me të dhëna nga GIS database

Me këto propozime konsulenti është përpjekur të krijojë kushtet për një zhvillim të qëndrueshëm në bashkinë Konispol në dekadat e ardhshme. Rritja e popullsisë është një nga treguesit themelorë të progresit të çdo shoqërie. Kjo, pasi një rritje e qëndrueshme e saj, jo vetëm flet për një popullsi të shëndetshme nga pikëpamja e moshës mesatare të saj dhe shmangjes së tendencës së "plakjes" së popullsisë, por gjithashtu një rritje me baza të qëndrueshme do të krijojë premisa për përthithjen në tregun e punës së një numri më të madh të forcës punëtore në mënyrë që të garantohet një rritje e qëndrueshme ekonomike.



[illegible]

1.10 Plani strehimit

Nisur nga regjistrimi i popullsisë nga INSTAT në vitin 2011, bashkia Konispol ka në përbërjen e saj 2199 familje. Duke iu referuar kësaj shifre do të vlerësojmë situatën aktuale të strehimit në bashki si dhe shpërndarjen e ndërtimeve sipas njësive administrative. Në total në të gjithë bashkinë Konispol në vitin 2011 janë numëruar gjithsej 2725 banesa. Shpërndarja e tyre pasqyrohet në tabelën 14.

Tabela 13. Statusi i banimit të banesës

Bashkia Konispol	Gjithsej Total	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
Konispol	730	576	32	122
Markat	847	545	86	216
Xarrë	1148	1048	8	92
Total	2725	2169	126	430

Burimi: INSTAT, Census 2011

Nga tabela e mësipërme vihet re se, në krahasim me të gjitha njësitë e tjera administrative të bashkisë Konispol, në Njësinë Administrative Markat ka një shifër të lartë banesash të pabanuara. Kjo shifër kap vlerën 216 banesa ose 26% të totalit të banesave për këtë njësi. Kjo vlerë është një evidencë e dukshme e shpopullimit të kësaj zone, gjë që evidentohet edhe në shifrën e lartë të banesave tashmë të pabanuara. Shumë e ngjashme me Markatin është edhe situata në Konispol ndërkohë që në Xarrë, situata rezulton më e stabilizuar pasi numri i banesave të pabanuara është i pakonsiderueshëm në krahasim me vlerën e banesave të banuara. Kjo e fundit përbën 91% të totalit të banesave në Njësinë Administrative Xarrë.

Numri i familjeve në nevojë është tepër i kufizuar dhe mund të themi i papërfillshëm për t'u konsideruar si një problem i rëndësishëm për bashkinë Konispol.

1.11 Përcaktimi i zonave/njësive, ku do të zbatohen instrumentat për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV - ve

Për zhvillimin dhe zbatimin e PPV-ve janë përcaktuar një seri instrumentash nga Ligji nr. 107/2014 dhe nga Manuali i Instrumenteve Financiare për zhvillimin e tokës (USAid 2016). Qeverisja vendore për zbatimin e PPV-ve mund të shfrytëzojë këto instrumenta. Në këtë paragraf do të përshkruhen shkurtimisht instrumentat kryesorë për zhvillimin e tokës, ndërsa ato financiare janë përshkruar në kapitullin ...të këtij raporti.



Ky instrument është një nga më të ndershmit për t'u zbatuar, edhe pse mund të mos jetë gjithmonë më transparent. IKN i lejon një zhvilluesi të ndërtojë në një intensitet më të lartë (i kufizuar për zhvillimin e banesave) në zona të caktuara të Bashkisë me kushtin e përmirësimeve publike. Ose ndryshe, t'i sigurojë para (që të rrisë intensitetin e ndërtimit) një tjetër strukturë (publike), e cila do t'i bëjë këto investime për të përmirësuar cilësinë e mjedisit për komunitetin. Një kërkesë për një instrument të tillë janë rregulloret transparente dhe të qarta, në mënyrë që të jetë e qartë për zhvilluesin dhe komunitetin se, cilat janë përfitimet e të dyja palëve dhe cilat janë pritshmëritë reale. Gjithashtu Bashkia duhet të hartojë edhe për zonat që nuk janë subjekt i PDV-ve Planet e Zhvillimit të Infrastrukturave Publike, të cilat do të parashikojnë shtrirjen e rrjetit rrugor dhe infrastrukturat e tjera mbi dhe nëntokësore. Në çdo rast këto instrumenta edhe kur janë iniciativa private do të kontrollohen dhe mbikqyren nga autoriteti vendor gjatë procesit të hartimit, në mënyrë që të garantohet zbatimi i PPV-ve dhe mbrojtja e interesit publik në zonë. Ky instrument ndërmerret për zonat e rishvillimit dhe ato të mbushjes urbane sipas hartës përkatëse me kodin 18h, dhe në të gjitha rastet sipas kodeve të njësisë në tabelat përkatëse.

E drejta e preferimit

E drejta e preferimit është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, në kuptim të këtij ligji, për t'u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik. Pasuria e blerë nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është zgjedhur. Nëse autoriteti përgjegjës i planifikimit vendos ta shesë pasurinë e blerë me preferim brenda 5 viteve nga data e blerjes, ai është i detyruar të njoftojë ish-pronarin e saj ose trashëgimtarët e tij, nëse kanë interes ta riblen atë pasuri.

Në bashkinë Konispol propozohet të aplikohet instrumenti i të drejtës së preferimit për të gjitha zonat e hartuara në PPV-të me kategori të përdorimit të tokës AS (arsim), SH (shëndetësi) dhe IS (institucione). E drejta e preferimit i referohet kryesisht shërbimeve të reja publike të propozuara, të projektuara në truall me pronësi private.

Ky instrument është i ilustruar në hartën përkatëse me kodin 20.





2. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Vlerësimi për Planin

Vlerësim i përgjithshëm. Ekonomia bujqësore dhe blegtoria përbëjnë sot bazën e aktiviteteve ekonomike në bashkinë e Konispolit ndërkohë që Plani i Përgjithshëm Vendor synon ta gërshetojë këtë aktivitet me ata të turizmit. Duke qenë se në vitet e ardhshme pritet që zhvillimi i agrobiznesit të këtë një impakt në këtë Bashki, lind nevoja e një monitorimi të mjedist të zonës. Mungesa e kapaciteteve monitoruese në Konispol e vështirëson këtë proces dhe për këtë arsye ekspertët kanë përpunuar një sistem i cili reflekton një nivel mesatar zhvillimi dhe kërkesash për aftësi të stafit, për një bashki evropiane të një niveli të mesatar. Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për t'u integruar në të ardhmen të cilat mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që do të mund të nënshkruhen nga qeveria shqiptare.

Në varësi nga niveli i ekspertizës së administrimit të Bashkisë, të sistemit ekzistues të monitorimit kombëtar, si edhe në varësi të kompleksitetit të zhvillimit dhe të disa parametrave të tjerë mjedisor, sistemi i monitorimit të VSM luhetet nga mjaft i thjeshtë në mjaft i ndërlikuar dhe kjo duke u bazuar si në të dhënat e deritanishme ashtu edhe tek mjetet e monitorimit dhe metodologjia.

Sistemi i përdorur për monitorimin e VSM-së është bazuar kryesisht në të dhëna që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar si dhe në kërkimet e bëra për realizimin e **Planit të Përgjithshëm Vendor** si dhe mbi bazën e potencialit të eksperteve. Ekspertët u munduan të optimizojnë midis kërkesës dhe realitetit për realizimin e matjeve të mundshme për realizimin e monitorimeve.

Disa nga gjetjet më kryesore si kombinime të masave mjedisore që duhen marrë gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor do të grupohen në nënçështjet më të rëndësishme si më poshtë:

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti. Bashkia Konispol është një zonë me larmi terrenesh (karakterizohet nga fusha, kodra dhe male të larta) dhe habitatesh (kullota, fusha, pyje etj) e si rrjedhojë ajo ka një shumëllojshmëri biodiversiteti. Gjithashtu ajo përfshin edhe trajtimin e zonave të mbrojtura (nga kanali i Vitarit deri tek kepi i Stillos si dhe zona të mbrojtura si mali i Milesë etj) me VKM dhe që zhvillohen sipas një plan menaxhimi të miratuar. Zona në studim ka rreth 1600 ha me pyje dhe rreth 4,250 ha kullota. Plani merr në konsideratë edhe basenat ujore (Janjarit, Mursit etj) si të rëndësishme jo vetëm si rezerva ujore për ujitje por edhe duke i konsideruar ato si trupa ujore. Plani respekton objektivat kombëtare (B, B3) dhe ato ndërkombëtare. Gjithashtu në Plan shqyrtohen mënyrat e zhvillimit të qëndrueshëm duke respektuar habitatet.



Menaxhimi i Burimeve Ujore. Burimet ujore në bashkinë Konispol janë të shumta ku mbrojtja e tyre dhe shtrirja e rrjetit të shpërndarjes përbëjnë një nga objektivat kryesore të VSM-së. Në Planin e paraqitur është trajtuar gjerësisht problematika pasi së pari, vihet re mungesa e rrjetit të ujit të pishmën sidomos në zonën administrative Markat. Aty ka nevojë të përmirësohet sistemi i furnizimit me ujë, pasi aktualisht në Dishat furnizimi me ujë bëhet me pus ndërsa në fshatrat e tjerë kërkohet një investim lidhur me pajisjen me pompa.

Një vend të rëndësishëm në burimet ujore për qëllime ujitje, zënë rezervuarët e shumtë dhe të mëdhenj në këtë zonë si ai Janjarit, Mursit, si dhe ai i Bufit i cili luan rol të rëndësishëm në furnizimin me ujë të liqenit të Butrintit. Krijimi i zonave buferike përreth këtyre rezervuarëve si dhe menaxhimi i tyre do të siguronte pastërtinë e tyre.

Mbrojtja e Tokës. Mbrojtja e tokës përbën edhe një nga objektivat kryesore të VSM-së të bashkisë Konispol. Duke e vënë në dukje karakterin bujqësor të zonës në studim si dhe zhvillimin e agroturizmit, si një mundësi për përmirësimin e jetës në zonë, mbrojtja e tokës përbën një nga objektivat kryesore të planit. Plani parashikon investime për riaftësimin e tokave në rrezik përmbetje në zonën fushore përmes rigjenerimit të sistemit të drenazhimit apo atij kullues ekzistues, përmirësimin e bonitetit të tokave, ruajtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet e shpërndara të karakterit industrial apo familjar etj, duke reflektuar kështu plotësimin e objektivave kombëtare (MT1, PT4, BJ-5) dhe ndërkombëtare. INT-3, ME-8, INT-1, ME-1, ME-4)

Cilësia e Ajrit. Në bashkinë Konispol monitorimi i ajrit nuk është realizuar nga institucionet përkatëse por afërsia me detin, zonat me pyje dhe prania e ulët e investimeve bëjnë që ajo të karakterizohet nga një cilësi ajri e pastër. Prania e gropave septike, e kanaleve ujitëse që shërbejnë si kanalizime ujrash të zeza dhe e grumbullimeve të mbetjeve në vende të pautorizuara emetojnë në ajër vende-vende aroma jo të mira dhe të dëmshme. Po ashtu cilësia e dobët e rrugëve dytësore në stinën e verës gjatë lëvizjes së automjeteve krijon ngritjen e grimcave të pluhurit. Plani parashikon investime në infrastrukturën përkatëse që do të sjellin minimizimin këtyre presioneve. Objektivat e VSM-së i përfshijnë në mënyrë indirekte çështjet e mësipërme duke plotësuar edhe objektivat përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menaxhimi i mbetjeve dhe kanalizimet e ujrave të ndotura. Menaxhimi i mbetjeve është një ndër presionet mjedisore të Bashkisë i cili gjen zgjidhje në plan, në mënyrë të veçantë problemi i vendhedhjes së tyre dhe ai i përpunimit. Bashkia i grumbullon dhe i hedh mbetjet e saj në Bajkaj ndërsa më problematike paraqitet Njësia Administrative Markat ku disistanca deri në Bajkaj ka kosto relativisht të lartë. Lidhur me këtë VSM-ja kërkon që edhe për këtë njësi mbetjet të grumbullohen dhe të përpunohen në landfillin e Bajkajt. Gjithashtu VSM-ja do të kërkojë edhe planin e menaxhimit të plotë të mbetjeve dhe listën e projekteve prioritare lehtësuese si për reduktimin dhe eliminimin e aktiviteteve ekzistuese të pakontrolluara të depozitimit të tyre, ashtu dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të mbetjeve për të ardhmen e Bashkisë.



Sistemi i monitorimit

Qëllimet dhe objektivat e VSM-së si dhe masat zbutëse lidhur me mjedisin janë paraqitur edhe në kapitujt e mëparshëm.

Më qëllim që VSM-ja të ketë një përdorim praktik për administratën e Bashkisë dhe për shtresat e interesuara, do të ishte e nevojshme vendosja e një numri indikatorësh dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do t'u mundësojë grupeve të interesit:

- Monitorimin e progresit drejt objektivave të VSM-së.
- Monitorimin e efekteve mjedisore që vijnë nga zbatimi i PPV-ve.
- Identifikim e efekteve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stade të hershme.
- Mundësim për veprime korrigjuese të përshtatshme.
- Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Një proces rishikimi dhe monitorimi është përgatitur për t'u përfshirë në një raport vjetor, që do të hartohet nga sektori i mjedisit në administratën e Bashkisë (me ndihmën e ekspertëve kur është e nevojshme) dhe që do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak.


Po kështu është propozuar që informacioni i mjedisit të përditësohet çdo 6 muaj me qëllim për të siguruar një paralajmërim të në kohë të përshtatshme në rastet e një dëmtimi serioz mjedisor, pavarësisht që raporti i monitorimit të VSM është vjetor.

Sistemi i monitorimit do t'u mundësojë grupeve të interesit të Bashkisë të vlerësojnë nga pikëpamja mjedisore, strategji dhe programe të tjera që mund të zbatohen në të ardhmen, duke ndjekur iniciativat e Këshillit Bashkiak dhe mundësi apo programe të BE-së.

Procesi i monitorimit të VSM-së duhet të ecë që sot e tutje paralelisht me zbatimin e PPV-ve duke u bërë pjesë integrale e tij. Të gjithë qëllimet dhe të dhënat janë të bazuara në objektivat e PPV-së dhe standardet kombëtare. Në rrugën e zbatimit mundet që Shqipëria të përshtatë edhe më tej standardet e saja me ato të BE-së apo nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh. për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja (si dhe arritje të tjera të rëndësishme).

Poshtë janë paraqitur disa të dhëna bazë ekzistuese lidhur me gjendjen aktuale si dhe disa vlera normale për parametra të ndryshëm.





Harta 143- (2f) Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore



2.1 Parashikimet për mbrojtjen e pejzazhit natyror dhe kulturor

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Konispol, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së, ofron mekanizmat për mbrojtjen e zonave pejzazhistike dhe pejsazheve të veçanta që dallojnë edhe në nivel rajonal si dhe për krijimin e një pejzazhi të një cilësie të lartë.

Masat për mbrojtjen e pejzazhit parashtrihen si më poshtë:

1. Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pejzazhit urban dhe pamor, i monumenteve kulturore dhe i trashëgimisë arkitekturore:

- Zbatimi i rregulloreve të zonimit për pejzazhin, në zonat e mbrojtura mjedisore (një pjesë e Parkut Kombëtar Ligatinor të Butrintit, kategoria e II, Kanali i Vivarit, burimet e kripura të Mullirit, Këneta e Vrinës, Mali i Milesë) dhe zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Qyteti antik i Çukës, Manastiri i Shën Kollit, manastiri i Shën Ilias, manastiri i Shën Thodorit dhe manastiri i Shën Marinës).
- Brandimi i zonës Xarrë, Mursi, Konispol si destinacion agroturistik cilësor kërkon një largim të këtyre aktiviteteve nga zonat e banuara që për shkak të profilit të biznesit duke ndikuar në pejzazhin e zonës duke e pastruar pamjen nga godina joestetike në raport me ato të vendbanimeve tradicionale dhe duke i dhënë vlerë pejzazhit të trashëgimisë kulturore dhe atij natyror që do të jenë tërheqjet kryesore për vizitorët.
- Zhvillimi territorial i zonës ku do të ngrihet agroturizmi me profil të tipit “gesthouse” realizohet në brendësi ose pranë zonës së banimit. Kjo do të ndikojë pozitivisht në profilin turistik lidhur me banesat tradicionale në Konispol dhe Markat, duke rehabilituar një pjesë të tyre dhe duke shtuar elementët e nevojshëm (banjo, restorant, tarraca, degustim ushqimesh) në përputhje me biznesin e ngritur duke përmirësuar pejzazhin e trashëgimisë kulturore.
- Vendosja e rregullave morfologjike, si pjesë e rregulloreve të Planit të Përgjithshëm Lokal në mënyrë që të rregullojë ndërtimin në pjesët historike të vendbanimeve dhe të monitorojë në mënyrë efektive zbatimin e tyre.
- Rritja e kriterëve (lidhur me përdorimin e energjisë së rinovueshme) për projektet e restaurimit.
- Prioritet e restaurimit të monumenteve të zgjedhura kulturore, hapësirave dhe kalldrëmeve në vendbanimet me fonde publike, si kusht i nevojshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës për banorët dhe për të rritur atraktivitetin e vendbanimeve për turistët.
- Rigjenerim i shërbimeve, veçanërisht i rrjetit të kanalizimit. Financimi duhet të kërkohej fillimisht në nivelin e qeverisë qendrore dhe nga donatorët. Paralelisht, një pjesë e të ardhurave në rritje të Bashkisë nga turizmi dhe zhvillimeve të ndërtimeve duhet të kanalizohen për të përmirësuar infrastrukturën e vendbanimeve tradicionale.
- Të sigurojë hapësirë të mjaftueshme parkimi në hyrje të vendbanimeve, në bazë të dispozitave të planit, si kusht i nevojshëm për të zbatuar skemat e këmbësoreve.



- Promovimi i turizmit cilësor lidhur me aktivitetet rezidenciale dhe tregtare, së bashku me masat, për të përmirësuar kushtet e jetesës në thelbin e vendbanimeve ekzistuese, priten të kenë një efekt të mesëm dhe afatgjatë sinergjik në rivitalizimin e vendbanimeve dhe përmbysjen graduale të rënies së trendeve demografike dhe zhvillimeve ekonomike.
- Financimi për infrastrukturën e kërkuar është një çështje thelbësore që ndikon në perspektivën e përgjithshme të zhvillimit të Murrsit.
- Krijimi i pikave tërheqëse për vizitorët në bërthamën historike do të ishte i rëndësishëm për promovimin e agroturizmit dhe turizmit kulturor në lidhje me konceptin e 'Rivierës së Brendshme' në mënyrë që fshati të bëhet një destinacion për vizitorët nga Saranda dhe Butrinti.
- Në pejzazhin urban dhe pamor do të ndikojë pozitivisht ngritja e një parku natyror, ndërsa ndërtimi i shtëpizave, me qëllim të mos ndikojë në pejzazhin urban duhet të jetë sipas modelit të shtëpive tradicionale të zonës. Zona e ndërtimit duhet të jetë në një distancë më të madhe se ajo e përcaktuar si zonë buferike e rezervuarit. Zhvillimi i turizmit në zonë do të nxisë përmirësimin e strukturës së vendbanimit duke përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve. Të përcaktohet nga ana e Bashkisë modeli i shtëpizave malore në përputhje me stilin dhe arkitekturën tradicionale
- Në pejzazhin pamor të zonës dhe aksesin në bashki do të ndikojë pozitivisht përmirësimi i cilësisë së rrugëve, duke rritur numrin e vizitorëve ditorë në verë dhe mbase duke u bërë një destinacion dhe një qendër e rëndësishme për promovimin e agroturizmit dhe turizmit kulturor në lidhje me konceptin e 'Rivierës së Brendshme'. Përdorimi i biçikletave duhet stimuluar pasi redukton ndotjen në tërësi. Ngritja e parkimeve në hyrje të këtyre zonave rekreative në bazë të dispozitave të Planit, si dhe parashikimi për një rrugë këmbësorësh dhe biçikletash përgjatë rrugës automobilistike si kusht i nevojshëm për të mundësuar përdorimin e biçikletave dhe ecjet për këmbësorëve duke i shoqëruar me një sistem sinjalistike të saktë dhe të përshtatshme
- Përdorimi i biçikletave duhet stimuluar pasi redukton ndotjen në tërësi.

2.2 Parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore

Plani i Përgjithshëm Vendor, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së duhet të ketë parasysh:

1. Mbrojtjen e trupave ujore, kthimin e përrenjve dhe lumenjve në korridore të gjelbëra natyrore, përcaktimin e vijës blu me parashikimet e masave të mëposhtme:

- Pavarësisht se bregdeti i bashkisë Konispol në Planin e Përgjithshëm Vendor nuk shihet si një bregdet për investime, pasi pjesa më e madhe e tij shtrihet përgjatë zonës së mbrojtur Bashkia ka detyrimin ligjor dhe është përgjegjëse për marrjen e kampioneve të ujit në zonat e plazheve. Bashkia duhet të kryejë të paktën pesë (5) monitorime nëpërmjet kampioneve të ujit të marra në plazhet e identifikuara për çdo sezon plazhi, duke filluar nga një kampion



për sezonin para fillimit të sezonit veror dhe katër të tjera gjatë sezonit veror. Si sezon plazhi të konsiderohet nga 1 qershori deri në 1 shtator dhe parasezon nga 15 maji deri në 31 maj.

Tabela 14 Kërkesat cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE-në		
Direktiva e KE-së për cilësinë e ujërave të plazheve (76/160/EEC)		
Parametra	Udhëzim	I detyrueshëm
Mikrobiologjike		
Totali i coliform (Numri/100ml)	$\leq 500^1$	$\leq 10,000^3$
Foecal coliform (Numri/100ml)	$\leq 100^1$	$\leq 2,000^3$
Fiziko-kimike		
Vajra minerale (mg/l)	$\leq 0.3^2$	Jo film dukshme në sipërfaqen e ujit dhe paerë ³
Substanca me sipërfaqe aktive (mg/l)	$\leq 0.3^2$	Joshkumë të qëndrueshme ³
Fenol (mg/l as C₆H₅OH)	$\leq 0.005^2$	Nuk ka erë specifike $\leq 0.05^3$

Shënim 1: $\geq 80\%$ te mostrave - Shënim 2: $\geq 90\%$ te mostrave - Shënim 3: $\geq 95\%$ te mostrave

- Po kështu është shumë e rëndësishme për Bashkinë që të mund të kryejë këtë monitorim të këtyre parametrave brenda vitit **2017**. Rezultatet e monitorimit duhet të shërbejnë edhe si bazë për masat e nevojshme që duhen marrë. Rezultatet duhen të bëhen të njohura me mënyra të ndryshme për publikun si dhe përmes faqes së internetit të Bashkisë. Bashkia në bazë të rezultateve mund të hartojë një hartë me cilësinë e ujërave dhe plazheve.
- Bashkia në bashkëpunim me institucionet e tjera duhet të monitorojë dhe të ulë disa vlera të parametrave të ujit të pishëm në përputhje me ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare si Direktiva /98/83/EC apo standardet e OBSH. Disa parametra kimikë, mikrobiologjikë, pesticide dhe komponime organike janë plotësisht jashtë monitorimit dhe nuk kanë asnjë vlerë për to. Është shumë e rëndësishme për shëndetin publik që këto parametra të jenë nën monitorim për t'u mbajtur në nivelet e lejuara. Të gjitha zonat përreth burimeve ujore duhet të konsiderohen dhe të shpallen zona sanitare të mbrojtura bazuar kjo edhe në Ligj (Ligj Nr. 8093, 21.3.1996).

Tabela 15 Treguesit fiziko-kimike të ujit të pishëm të bashkisë Konispol dhe objektivat					
Nr	Treguesit kimik	Vlerat e monitoruar a të ujit të pishëm në bashkinë Konispol	Standarde kombëtare ml/ujë	Max	Objektiva nga 2018 (Direktiva e Këshillit 98/83/EC & te tjera)



1	Shija dhe era (numër hollimi)			2deg12°C, 3deg25°C	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/l shkalla Pt/Co)		1	20	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
3	pH		6,5-8,5	9,5	≥ 6.5 dhe ≤ 9.5
4	Konduktiviteti elektrik (μS/cm)		400		2500
5	Kalcium (mg/l)		75	200	200
6	Lëndët pezull (mg/l)				0
7	Turbullira (FTU)		0.4	4	Nuk ka udhëzime
8	Alkaliniteti (mg ekv/l)			n.v	Acc.pH
9	Karbonat (mg/l)				250
10	Bikarbonat (HCO ₃) (mg/l)		H ₂ O not CaCO ₃	n.v	Ac.pH
11	Amonjak (mg/l)		0	0,05	0.50
12	Nitrite (mg/l)		0	0,05	0.5
13	Nitrate (mg/l)		25	50	50
14	Fortësia totale (°german)			20	36-71
15	Fosfate (mg/l)		0,4	2,5	2.5
16	Lëndë organike (mg/l)		1	3	3
17	Klorure (mg/l)		25	200	250
18	Sulfate (mg/l)		25	250	250
19	TDS (mg/l)		500		≤1500
20	Magnez (mg/l)		20	50	0.05

Tabela 16. Treguesit mikrobiologjike të ujit të pishëm të bashkisë Konispol dhe objektiva

N°	Treguesit mikrobiologjikë	Pus i përbashkët para klorinimit	Vlerat në Bashki	Standarde kombëtar e ml/ujë	Objektiva nga 2016 direktiva e Këshillit 98/83/KE ml/ujë
1	E. Coli		n.v	0/100	0/250
2	Strept		n.v	0/100	0/250
3	Pseudomonas aeruginosa		n.v	n.v	0/250
4	Numri i kolonive 22°C		n.v	n.v	100/ml
5	Numri i kolonive 37°C		n.v	n.v	20/ml

Burimi: ISHP

- Rritja e kontrollit mbi territorin nga ana e Bashkisë përmes strukturave të policisë bashkë
- Zhvillimi i njësive të kompostimit për trajtimin e mbeturinave të kafshëve



- Lëvizjet e qytetarëve nëpër shtigjet e përcaktuar në mënyrë të organizuar ose jo do të ndikojë negativisht në cilësinë e ujërave dhe burimeve. Ndikimi i tyre është johomogjen pasi në mënyrë të veçantë është e lidhur zonën e Markatit. Rikualifikimi i qendrës historike dhe hapja e bareve dhe e retoranteve do të shoqërohet me investime edhe në sistemin e shpërndarjes së ujit të pishëm duke e përshtatur atë me standartet e nevojshme për këto lloje biznesi. Përcaktimi i vijës blu të ujërave tokësore dhe i zonave buferike për të gjitha burimet ujore bëhet i domosdoshëm.
- Hartimi i një rregulloreje për sjelljen e njërzëve në hapësirat e përcaktuara për këtë lloj turizmi.
- Krijimi i një parku natyror në zonën e rezervuarit të Janjarit krijon premisa për përmirësim e kushteve për këtë trup ujqor por ngritja e infrastrukturës së tij mund të sjellë ndotje në fazën e ndërtimeve për parkun. Ky rezervuar ka dhe një rol të rëndësishëm për bujqësinë pasi shërben si burim për ujitje dhe është pjesë e planeve të Bashkisë për ujitjet. Hartimi i planit të menaxhimit duhet të jetë me profil të theksuar mjedisor me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujërave të këtij rezervuari.
- Lëvizja e qytetarëve nëpër rrugët e rehabilituara dhe ato të reja me automjete dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ujërave dhe burimeve si pasojë e emetimeve të tyre. Kalimi i rrugëve pranë përrrenjve apo lumenjve duhet të bëhet sipas standarteve të përcaktuara. Ndërtimi i rrugëve mund të shoqërohet me ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për ato zona ku nuk ekziston. Të kryhen VNM-ja për ndërtimin e rrugëve.

2. Mbrojtja e burimeve ujore dhe përmirësimi i rrjetit shpërndarës të ujit të pishëm do të realizohet me masat e mëposhtme:

- Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe të zeza si dhe përmirësimi i sistemit të ujit të pishëm.
- Zbatimi i rregulloreve për trajtimin e mbetjeve nga ana e biznesit pranë zonave me trupa ujorë.
- Grumbullimi i këtij aktiviteti ekonomik në aksin Xarrë-Mursi, që do të përfshijë dhe zonën e fushës së Vrinës, do të lehtësojë ndërtimin e infrastrukturës së duhur për sigurimi e ujit të pishëm dhe të ndërtimit të sistemit të kanalizimeve.
- Rritja e investimeve për infrastrukturën e rrjetit të ujit të pishëm. Nevoja për të rritur sasinë e ujit të pishëm për kapur standartet kombëtare dhe ndërkombëtare do të rrisë kujdesin ndaj burimeve ujore dhe do të përmirësojë sistemin e furnizimit me ujë
- Studime të iniciuara nga Bashkia për zhvillimin e objekteve të trajtimit të ujërave të zeza në të gjitha zonat blegtorale brenda gjashtë muajve nga miratimi i Planit.
- Pajisja me sisteme veçuarë për plotësimin e nevojave në zonat larg qendrave të banimit.

c. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, trajtimit të ujërave të zeza dhe të ndotura:

- Grumbullimi i aktiviteteve ekonomike në aksin ekonomik do të ndikonte pozitivisht në këtë objektiv të VSM-së pasi së pari krijohet mundësia e grumbullimit dhe së dyti do të reduktohen ndotjet nga largimi i këtyre bizneseve nga zonat e banuara dhe zonat ku aksesimi është më i vështirë.



- Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe të zeza si dhe përmirësimi i sistemit të ujit të pishëm.
- Zbatimi i rregulloreve për trajtimin e mbetjeve nga ana e biznesit
- Studime të iniciuara nga Bashkia për zhvillimin e objekteve të trajtimit të ujërave të zeza në të gjitha zonat blegtorale brenda gjashtë muajve nga miratimi i planit. Për të gjitha zonat e tjera: Zhvillimi i zgjidhjeve individuale për trajtimin e mbetjeve të lëngshme, të kërkuara në fazën e lejes së zhvillimit.
- Rritja e numrit të vizitorëve si pasojë e krijimit të zonës së rekreacionit buzë rezervuarit të Janjarit do të shtojë gjenerimin e mbetjeve dhe ujërave të zeza. Nevoja për plotësim të kushteve minimale për qëllime turistike do të nxiste marrjen e masave të nevojshme që do të minimizonte ndikimet negative, si menaxhimi i mbetjeve dhe i trajtimit të ujërave të zeza në njësi individuale apo në nivel më të gjerë.
- Rehabilitimi i infrastrukturës së banesave, shkollave, qendrave etj do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e rrjetit të brendshëm të ujërave të zeza. Të realizohet lidhja e shkarkimeve të ujërave të zeza brenda mjediseve me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe të zeza.
- Zgjerimi dhe konsolidimi i vendbanimeve do të shoqërohet me rritje të kapaciteteve përpunuese dhe grumbulluese. Të realizohet lidhja e shkarkimeve të ujërave të zeza në banesat e reja me rrjetin e kanalizimeve të ujërave apo me sistemet individuale, duke e kushtëzuar këtë me dhëniet e lejeve të ndërtimit.

2.3 Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra.

Mbrojtja e biodiversitetit

Plani i Përgjithshëm Vendor, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së duhet të ketë parasysh:

1. Shtimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura natyrore, pejzazhit natyror, dhe hapësirave të gjelbra brenda zonës së urbanizuar:

- Hartimi i marrëveshjeve për ruajtjen e pejzazhit dhe të trajtimit të mbetjeve ndërmjet Bashkisë dhe bizneseve vendore gjatë zhvendosjes së aktivitetit të tyre në aksin ekonomik si dhe në drejtim të menaxhimit të mbetjeve.
- Zbatimi i rregulloreve të zonimit bazuar në përdorimin e tokës. Ky aspekt është i lidhur në mënyrë të veçantë me zonën e Markat-it me një përcaktim më të mirë të kufijve të kullotave të zonës me qëllim që ato të ruhen më mirë duke i mbrojtur nga zjarret si dhe një mbrojtje më të mirë të pyjeve duke shmangur çpyllëzimet e pautorizuara.
- Bashkia Konispol duke qenë se ka si pasuri të vetën një zonë natyrore me shtrirje kaq të gjerë prej 16083 ha dhe zona urbane tepër të kufizuara në politikat mjedisore do të dallohen dy aspekte: shtimi dhe rehabilitimi i zonave të caktuara të parqeve natyrore si dhe shtimi dhe rehabilitimi i zonave të gjelbra pranë zonave të urbanizuara. Për këtë arsye janë parashikuar rreth 4 ha hapësira të gjelbra publike në Markat, Xarrë dhe Konispol.



Gjithashtu, shndërrimi i Markatit (pjesë e zonës natyrore) dhe zonës përreth tij në një destinacion turistik për ekoturizëm dhe turizëm me akomodim të tipit “guesthouse” do të promovojë lëvizjet e grupeve nëpër shtigjet e përcaktuar. Impakti me natyrën do të jetë i madh për shkak se lëvizjet do të realizohen në zona natyrore të mirëfillta dhe mund të sjellë një degradim të elementëve mjedisore që lidhet me pyjet, biodiversitetin. Konsolidimi dhe rivitalizimi i qendrës historike të Markatit mund të sjellë një përkeqësim të përkohshëm të pejzazhit dhe cilësisë së ajrit në zonën brendësi të sheshit kryesor për shkak të punimeve. Masat janë të nevojshme për zbatimin e rregulloreve gjatë ndërtimit në zonat e gjelbërta.

- Zhvillimi i turizmit masiv drejt zonave malore do të kërkojë masa nga ana e Bashkisë në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin e vizitorëve për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve natyrore. Fushata drejtuar vizitorëve dhe bizneseve lokale për mbrojtjen ndaj pyjeve, burimeve etj. Futja e kriterëve ndërkombëtare ekologjike në funksionimin e akomodimeve të tipit “guesthouse” dhe për këtë tip turizmi.
- Rehabilitimi i rrugëve panoramike të brendëshme ekzistuese si rrugët Çukë-Butrint deri në Xarrë, rruga nga Shalës-Dishat deri në Vervë dhe rruga nga Markati- Ninat deri Janjar rrezikon dëmtimin e e zonave të mbrojtura, pyjeve dhe biodiversitetin. Impakti me natyrën do të jetë i madh për shkak se lëvizjet e automjeteve do të realizohen në zona natyrore të mirëfillta dhe mund të sjellë një degradim të elementëve mjedisore. Të kryhen nga ana e Bashkisë VNM për rindërtimin e këtyre rrugëve për të ruajtur parametrat mjedisore brenda kufijve normalë.
- Ndërtimi i rrugëve që përmirëson aksesin dhe transportin publik në Bashki. Ndër kryesoret është ajo që lidh Shehatin me Qafë Botën do të përmirësojë aksesin e vendbanimeve të Konispolit dhe transportit publik që do të lidhë midis tyre fshatrat e zonës me Butrintin dhe Sarandën. Ndërtimi i rrugëve mund të ndikojë negativisht pejzazhin e zonës dhe biodiversitetin. Impakti me natyrën do të jetë i madh për shkak se lëvizjet e automjeteve do të realizohen në zona natyrore të mirëfillta dhe mund të sjellë një degradim të elementëve mjedisore. Mbjellje të pemëve të zonës përgjatë dy anëve të aksi të rrugëve.

Harta bashkangjitur tregon sipërfaqet e gjelbëra të shtuara në bashkinë Konispol.

Tabela 17. Sipërfaqet e propozuara të zonave të mbrojtura, të trashgimisë kulturore dhe monumenteve

Njësia administrative	Rezerve strikte natyrore, Zona të mbrojtura pejzazhistike	
	Ekzistuese N1,N2,N3, M3 (ha)	Te Propozuara N5, N6 (ha)
Konispol	40.62	3193.83
Xarrë	1636.55	3497.81
Markat	539.05	5782.13
Totali	2216.22	12473.77



Tabela 18. Sipërfaqet e gjelbra dhe publike

Njësia administrative	Sip.sportive, Sip.të gjelbra, hapësira publike	
	Ekzistuese AR.3, AR.4 (ha)	Te Propozuara AR.3, AR4 (ha)
Konispol	2.57	1.34
Xarrë	3.64	2.10
Markat	0.19	1
Totali	6.4	4.44

2.4 Parashikimi i varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar përsa u përket hotspoteve

Në Konispol nuk ekzistojnë hotspotet por mund të themi që ka zona të rrezikuara siç janë guroret dhe industria e vajit.

Në territorin e bashkisë Konispol gjenden dhe gurore monitorimi i të cilave është e një rëndësie të veçantë megjithëse aktualisht ato nuk përbëjnë një shqetësim. Riliçensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisit, Ligj për Vlerësimin e Thelluar Mjedisit). Në mënyrë të veçantë për guroret është e rëndësishme aplikimi i udhëzimit në pikat e nenit 14 (a, b, c, d). Hapja e guroveve të reja duhet të bëhet në zonat e sugjeruara nga Plani ose duke u bazuar në sugjerimet e specialistëve dhe të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Tabela 19. Monitorimi i guroveve dhe rehabilitimi

Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i rinovimit të licencës për guroret pa vlerësimin paraprak mjedisor nga Agjencia e Vlerësimit Rajonale të Mjedisit	100%	2017
Rehabilitimi i guroveve ekzistuese sipas Direktives 3, Maj 2006 MoEFWA	100%	2018

2.5 Parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Në analizën e gjendjes aktuale në bashkinë e Konispolit vlerësimi i cilësisë së ajrit megjithëse nuk është monitoruar nga institucionet përkatëse, ai nuk rezulton shqetësues, por duke marrë parasysh zhvillimin e zonës Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së



ajrit të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, datë 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit". Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë periodike sidomos gjatë sezonit veror, dy herë gjatë muajve korrik dhe gusht dhe të paktën njëherë jashtë këtij sezoni. Në varësi të monitorimeve Bashkia duhet edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO_x - 40 µg/m³, për PM₁₀ - 40 µg/m³, për PM_{2,5-25} µg/m³ dhe 20 µg/m³ dhe SO₂-125 µg/m³ për 24 orë ose 20 µg/m³ në vit.

Tabela 20. Vlerat e kufi të ndotësve				
Përiudha e monitorimit			Objektiva nga 2016	
Ndotësit	Metoda	Vlera e përiudhës mesatare	Standarde AL	Standarde e BE
(µg/m ³)			(µg/m ³)	(µg/m ³)
Pluhuri total	gravim		140	80
PM 10	Ads		40	40
O ₃	Ads		120	110
NO ₂	Ads		50	40

Burimi: ISHP

Tabela 21. Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t'u monitoruar në bashkinë Konispol			
Ndotësit	Përqendrimi	Periudha mesatare	Te monitorohet dhe zvogëlohet nga viti
Grimcat e imëta (PM _{2.5})	25 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
Dyoksidi i squfurit (SO ₂)	350 µg/m ³	1 orë	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	125 µg/m ³	24 orë	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
Dyoksid azoti (NO ₂)	200 µg/m ³	1 orë	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
	40 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn në fuqi 1.1.2014
PM ₁₀	50 µg/m ³	24 orë	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
	40 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014



PLUMB (Pb)	0.5 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Monoksid Karbon (CO)	10 mg/m ³	Maksimalja ditore 8 orë mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Benzen	5 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Ozon	120 µg/m ³	Maksimalja ditore 8 orë mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Arsenik (As)	6 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2016
Cadmium (Cd)	5 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2016
Hidrokarbure Aromatike Policiklike	1 ng/m ³ (i shprehur si përqendrim i benzenit (a)pirene)	1 vit	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2016
PM2.5 Përqendrim i ekspozuar i detyruar	20 µg/m ³ TME (Treguesi Mesatar i Ekspozimit)	Bazuar në mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2018

Bashkia duhet gjithashtu të përgatisë një plan apo program për të siguruar përputhshmërinë e vlerave me standardet përpara datës së synuar limit të përcaktuar në tabelat e mësipërme. Gjithashtu Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacionin mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

2.6 Zhurmat dhe ndotja akustike

Të dhënat mbi ndotjen akustike në bashkinë Konispol mungojnë tërësisht. Një bazë të dhënash lidhur me nivelin e zhurmave në zonë sigurisht që do të ndihmonte shumë në përcaktimin e saktë të masave që duheshin marrë në zonat më të ndjeshme për të siguruar një zonë turistike të shëndetshme dhe relaksuese. Një sondazh i realizuar gjatë periudhës të vlerësimit të territorit rezultoi se zona nuk paraqet probleme nga pikëpamja e ndotjes akustike.

Në përgjithësi vlera e synuar për zhurmat nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej $L_{max}-56$ dB gjatë ditës dhe 45 dB gjatë natës në të gjitha zonat e Bashkisë. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.



2.7 Parashikime për menaxhimin e mbetjeve

Bashkia e Konispolit për nga sasi të llogaritura gjeneron në tërësi rreth 800 t mbetje në vit, pra sasia është modeste. Problemi i mbetjeve është një çështje serioze që shfaqet thuajse në për të gjithë territorin e bashkisë Konispol. Vende-vende shikohen grumbullime mbetjesh në afërsi të lumenjve, ujëmbledhësëve etj. Sigurisht që veç dëmit që sjellin në cilësinë e këtyre ujërave këto mbetje krijojnë edhe një imazh të shëmtuar të zonës. Lind një nevojë për rehabilitimin e këtyre vendgrumbullimeve si dhe një përmirësim të sistemit të grumbullimit dhe infrastrukturës në tërësi. Asgjësimi përmes djegies i mbetjeve shkakton një ndotje dhe dëmtim të përkohshëm të cilësisë së ajrit.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa objektiva, që synojnë në reduktimin kohor dhe riciklimin e mbetjeve për vitet në vijim.

Tabela 22. Objektivat për reduktimi e mbetjeve		
Parimi	Objektiva	Nga viti
Asgjesimi i mbetjeve që shkojnë në landfill	Reduktimi në masën 45%;	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve nga 35%	2020
Përmirësimi i asgjësimit përfundimtar dhe monitorimi	Të gjitha mbetjet e mbledhura me 100%	2017
Shmangia e asgjësimit në shtretër të lumenjve dhe rrugëve anësore	Të gjitha mbetjet 100%	2017
Asgjësimi në landfille në mënyrë të kontrolluar	Në masën 35%	2017
Monitorimi i mbetjeve të industrisë së peshkut	Shmangia e rritjes së peshkut në gjire të mbyllura nga 100%	N/A
Portet e reja dhe ekzistuese (marina)	Shmangia e derdhjes së naftës dhe mbeturinave të tjera në det	N/A

2.8 Parashikime për mbrojtjen e Tokës

Toka bujqësore në bashkinë Konispol është një aset tepër i rëndësishëm duke patur parasysht këtu profilin bujqësor të saj. Monitorimi i saj është mjaft i rëndësishëm sidomos në kushtet kur presioni i zhvillimit po e redukton atë në mënyrë konstante. Grupi i ekspertëve ka vendosur dy objektiva lidhur me gjendjen aktuale të tokës bujqësore me qëllim përmirësimin e gjendjes së saj pas aprovimit të Planit.

Tabela 23. Monitorimi i tokës bujqësore		
Parime	Objektiva	Viti
Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore nën ujë	Me 20%	2019
Rritja e sipërfaqes së tokës me	Me 15%	2020



bonitetit të lartë

2.9 Veprimi mbi asetet e bashkisë Konispol/ kohezioni social

Trajtimi i hapësirave administrative (qytete, bashki, rajone) si një njësi që gjatë funksionimit të tyre marrin dhe shfrytëzojnë nga mjedisi lëndët e para, tokën, ujërat, gjënë e gjallë, prodhojnë (asetet në territor) dhe krijojnë të mira materiale nëpërmjet shfrytëzimit të energjive të ndryshme (fosile, elektrike etj) dhe në fund gjenerojnë mbetje, të cilat mund të shfrytëzohen dhe të riciklohen duke kontribuar në një mjedis të qendrueshëm, i përngjason ato me organizmat e gjallë. Koncepti i krahasimit të zonave urbane që transformojnë lëndët e para në infrastrukturë, në biomasë dhe mbetje me metabolizmin e qënieve të gjalla mund të ndihmojë në analizimin e një ekosistemi apo të disa ekosistemeve (njësive të Bashkive). Metabolizmi urban siguron kuadrin për të analizuar proceset teknike dhe socioekonomike në qytetet.

Këtu përfshihet vlerësimi i inputeve dhe outputeve, energjisë, ujit, materialeve dhe mbetjeve si asete të Bashkisë. Tërësia e lëndëve që deportojnë në këto “organizma mjedisore” jo domosdoshmërisht merren nga hapësirat e këtyre njësive administrative por mund importohen sikurse edhe prodhimet e tyre mund të konsumohen jashtë hapësirës së tyre, pra eksportohen. Këto hapësira administrative sot konsiderohen me një metabolizëm linear, në rritje, pa u shqetësuar për sasi të flukseve burimore që rrjedhin, thithen, shfrytëzohen prej tyre si dhe pa u shqetësuar për fatin e mbetjeve të gjeneruara. Ato kanë kontribuar në një dëmtim sistematik të mjedisit rrethues social, ekonomik dhe mjedisor. Si pasojë e kësaj sjelljeje, trajtimi i këtij impakti mbi mjedisin rrethues dhe siguri i një mjedisi të qëndrueshëm është shndërruar në sfidën më të madhe të ditëve të sotme për zhvillimin urbano-industrial në nivel global si dhe të këtyre njësive administrative si pjesë përbërëse e globalizimit. Politikat e sotme globale dhe lokale më së shumti adresojnë efektet dhe jo shkaqet që i prodhojnë impaktet negative mbi mjedisin rrethues.

Në bashkinë Konispol në veçanti hasen një numër problemesh që lidhen me hedhjen dhe grumbullimin e mbetjeve që lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës dhe me menaxhimin e dobët.





Figura 10. Mbetje të hedhura në mjedise të ndryshme
Burimi: Foto nga Ekspertët

Lind kështu një nevojë për rehabilitimin e këtyre vendgrumbullimeve si dhe të përmirësimit të sistemit të grumbullimit dhe infrastrukturës në tërësi. Asgjësimi përmes djegjes i mbetjeve sjell një ndotje dhe dëmtim të cilësisë së ajrit të përkohshme.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve është akoma i një niveli të ulët, që përbëhet nga sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta vetëm qytetet, por jo në zonat rurale. Riciklimi i mbetjeve është në masën 10% e cila realizohet nga impiante private dhe pjesa tjetër e mbetjeve asgjësohen pranë vendgrumbullimit të mbetjeve. Ndërkohë që nuk ka një sistem të sigurtë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake).

Mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza krijon shpeshherë në afërsi të qendrave të banuara aroma të pakëndshme si dhe ndotje jo vetëm në afërsi të tyre por edhe përgjatë kanaleve ujitës dhe kullues.

Gjuetia në përgjithësi dhe gjuetia e thëllënzave në veçanti jashtë kritereve përbën një tjetër sfidë të rëndësishme mjedisore për biodiversitetin në zonë.

Në fund, zhvillimi i bujqësisë në zonë sidomos në fushta pranë kanaleve dhe lagunave përbën një tjetër sfidë të rëndësishme mjedisore pasi rrezikon të shtojë ndotjen e tokës nga përdorimi i pesticideve.

Në zonën tonë të studimit drejtimet ekonomike në këto 25 vjet kanë qenë të paqarta pavarësisht orientimit qendror. Nga momenti që orientimi parësor ka qenë bujqësia, ka patur një reduktim të tokës së përdorur (si aseti kryesor i Konispolit) për këtë qëllim si pasojë e mosrespektimit të ligjit. Ekziston një lidhje e fortë midis përdorimit të materialeve, energjisë së përdorur, përdorimit të tokës për aktivitetet prodhuese dhe konsumuese të të mirave materiale me njësitë ekonomike, shoqërinë dhe politikat territoriale. Hartimi i planeve rregulluese në nivel lokal dhe kombëtar ndihmon në përmirësimin e fragmentizimit të



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë,
Himarë, Konispol

ekonomisë duke shtuar mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm si dhe ruajtjen e aseteve të zonës dhe burimeve njërëzore të saj.

Bashkia e Konispolit e ka akoma mundësinë që në këtë dhjetëvjeçar të mund të mbyllë kapitullin e zhvillimit kaotik dhe të vendosë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm. Krijimi i vendeve të reja të punës do të rrisë mundësinë për punësim si dhe zhvillimin e komunitetit lokal. Kjo do të kushtëzojë edhe ngritje kapacitetesh e ekspertizë lokale në përputhje me kërkesën për specialistë të fushave të ndryshme.



3. PLANI I SHERBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

3.1 Infrastruktura publike e propozuar

3.1.1 Transporti i propozuar

Përshkrim i përgjithshëm

Reduktimi i kohës së udhëtimit për të aksesuar në destinacionet e zonave të jugut është i rëndësishëm me qëllim që udhëtimet turistike të mund të përballohen lehtësisht. Nga ana tjetër, distanca është një faktor kritik që përcakton parametrat e përvojës së jetuar. Për këtë arsye, një rrugë pejzazhistike bregdetare duhet të zgjasë për një kohë të mjaftueshme me qëllim që vizitorët të vlerësojnë pamjen dhe të përceptojnë kalimin nga peisazhi bregdetar tek ai malor.

Aksesibiliteti mbetet në përgjithësi një problem si për udhëtimet ndërkombëtare ashtu edhe për lidhshmërinë rajonale. Ndërtimi i një aeroporti të dytë në bregdet është një parametër i rëndësishëm që mund të ndikojnë tendencat afatgjata të turizmit. Riviera mund të bëhet një destinacion ndërkombëtar që tërheq investimet e huaja direkte vetëm me një konektivitet të drejtpërdrejtë ajror me jo më shumë se 1orë distancë me makinë nga pjesa më e madhe e qendrave të atraksionit urban. Kështu aeroporti, në mënyrë ideale, duhet të pozicionohet diku midis Vlorës dhe Sarandës pranë autostradës dhe korridorit të transportit publik/privat që lidh territorin nga veriu në jug. Ky duhet të funksionojë gjithashtu edhe si një korridor transporti publik (*Bus Rapid Transit* ose tren), që ndërlidhet me pjesën balllore të destinacioneve kryesore.

Pika e dytë është ndërlidhja nëpërmjet ujit. Korfuzi ka një aeroport, miliona turistë, kompetenca dhe është disa milje larg me anije. Kjo e lehtëson shumë hyrjen në Korfuz nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese. Ndërtimi i një ure është ndoshta jo fort i përshatshëm (edhe pse për këtë do të duhej një studim i mirëfilltë fizibiliteti), por kjo lehtëson shumë ndërlidhjen e rregullt përgjatë verës. Gjithçka që nevojitet janë paketat turistike dhe ndoshta vizat ditë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, transporti ujor, domethënë përgjatë bregdetit me anije lundrimi, është i domosdoshëm. Nëse të shkuarit përgjatë bregdetit me makinë është e mundimshme në të kundërt, të shkuarit me anije është i shpejtë dhe shumë më argëtues. Të gjitha rivierat kanë qasje në një port të madh, ku anijet turistike mund të parkohen dhe zbarkojnë me mijëra përgjatë udhëtimeve ditore. Kjo mundësi ekziston në të dyja qytetet, Vlorë dhe Sarandë.

Transporti Ajror



Një aeroport në Sarandë do të ndryshojë tërësisht karakteristikat e rajonit duke siguruar një aset shumë të rëndësishëm për promovimin jo vetëm për bashkinë e Sarandës por edhe bashkinë e Konispolit, si një destinacion ndërkombëtar për turistët që mund udhëtojnë nga vende shumë larg nga Shqipëria, por edhe për fluturimet e brendshme të cilat mund të programohen nga aeroporti i Tiranës si dhe nga aeroporti i Kukësit i cili është aeroporti i dytë civil në vend, aktualisht jofunksional. Vendndodhja e propozuar e aeroportit të Sarandës. Nëse zhvillohet do të ndikojë në të gjitha parametrat e planit lokal.

Transporti Detar

Bashkia e Konispolit ka dalje të vogël në det por nuk ka një port ekzistues. Kjo Bashki përdor për këto qëllime portin e Sarandës. Rritja e rolit të portit të Sarandës nëpërmjet shtimit të lidhshmërisë me portin e Korfuzit do të ndikojë pozitivisht edhe për aksesueshmërinë në Bashkinë e Konispolit. Vija bregdetare prej 11km për momentin është e paaksesueshme.

Transporti Publik

Transporti publik do të realizohet nëpërmjet një seri ndërhyrjesh potenciale në kuadër të programit për *Përmirësimin i aksesit rajonal*, të cilat do të lehtësojnë aksesin dhe transportin në bashkinë Konispol:

- Rikonstruktimi i rrugës ndërrbane Butrint - Shkallë (1.4km);
- Përmirësimi i aksesueshmërisë së fshatrave në rrugët kryesore interurbane (Markat-Ninat-Janjar, Shalës-Dishat-Verve) ;
- Përmirësimi i transportit publik (frekuencat e rrugëve, më tepër destinacione).

Në kuadër të programit për *Përmirësimi i aksesit lokal* do të realizohen një seri ndërhyrjesh potenciale, të cilat do të lehtësojnë aksesin dhe transportin në njësitë administrative të bashkisë Konispol:

- Përmirësimi i rrjetit sekondar të rrugëve urbane në Konispol, Shendelli, Shales, Mursi, Xarrë
- Linjë e re autobusi që lidh fshatrat e largëta me Konispolin dhe qendrat e tjera

Përmirësimi i transportit publik do të realizohet nëpërmjet një seri ndërhyrjesh :

- Përmirësimi i shërbimit lokal me autobus mes Sarandës - Manastirit -Ksamilit -Butrintit - Finiqit- Konispolit

Itinerari i varkave Taksi të propozuara gjatë sezonit të verës

- Gjiri Fteliash - Kepi Stillos - Gryka e Vrines - Ksamil - Sarandë

Mini Tragetet gjatë sezonit të verës

- Gjiri i Fteliash - Ksamil - Sarandë - Himarë - Dhërmi



3.1.2 Infrastruktura rrugore e propozuar

Rrjeti rrugor

Rrjeti i rrugëve është një pjesë integrale e një zonë urbane apo rurale, pasi lidh zonat dhe vendet, si dhe lehtëson lëvizjen e njërëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë e tij, funksionin dhe qëllimin.

Garantimi me një rritje të qëndrueshme të aktiviteti ekonomik në bashkinë Konispol mbi bazën në vizionin për të si një territor pjellor, kërkon të shoqërohet në të disa prioriteve që mundësojnë këtë zhvillim.

Se pari, përmirësimi i cilësisë së rrjetit rrugor nga Butrinti në Shkallë me qëllim tërheqjen e vizitorëve nga Ksamili për të vizituar Konispolin dhe Rivierën e vazhdueshme të Sarandës. Së dyti është i nevojshëm përmirësimi i rrjetit rrugor të Shalë-Vërvës dhe Markat-Ninat-Janjarit me qëllim rritjen e cilësisë së jetës për popullsisë lokale dhe për turizmin natyror.

Problemet me parkimin ekzistojnë në Konispol për shkak të topografisë së pjerrët.

Përshkrim i përgjithshëm bashkia Konispol

Aksesueshmëria rrugore e zonës së studimit nëpërmjet korridoreve rrugore të jugut të Shqipërisë është përmirësuar ndjeshëm kohët e fundit, kryesisht për shkak të zgjerimit të dukshëm dhe programit të përmirësimit të infrastrukturës zbatuar në të gjithë vendin. Pas përfundimit të korridorit kryesor Tiranë- Durrës- Lushnjë- Fier-Vlorë i cili aktualisht është përmirësuar pjesërisht dhe është në proces modernizimi, pritet që zona e Konispolit të disponojë nivel të lartë aksesueshmërie me Shqipërinë Qendrore dhe Veriore, Malin e Zi, bregdetin Dalmat dhe Kosovën.

Në zonën më jugore të vendit po konsiderohen tri projekte të tjera të infrastrukturës rrugore. Projekti i parë është ndërtimi i rrugës Gjirokastër - Sarandë. Projekti i detajuar për segmentin Kardhiq - Delvinë është përgatitur dhe finalizimi i ndërtimit të këtij segmenti për pjesën jugore të Shqipërisë do bënte të mundur lidhjen e dy zonave të rëndësishme urbane duke shkurtuar kohës aktuale të udhëtimit. Projekti i dytë është i rrugës Orikum - Dhërmi nëpërmjet një tuneli. Ky projekt kërkon një studim të fizibilitetit dhe një projekt paraprak. Ndërtimi i saj është konsideruar i rëndësishëm, sidomos për zhvillimin bregdetar dhe të turizmit. Nëpërmjet tunelit të vendosur në këtë aks do të jetë e mundur të shmangen vështirësitë e rrugës në zonën e Llogarasë, do të rritet ndjeshëm komoditeti dhe siguria e rrugës si edhe do të zvogëlohet koha e udhëtimit. Projekti i tretë është rruga Kranjë - Sarandë - Konispol. Dizajni i detajuar për



segmentin Kranjë-Sarandë është përgatitur dhe finalizimi i ndërtimit të këtij segmenti të pjesës jugore të Shqipërisë do lidh dy zona të rëndësishme urbane duke shkurtuar kohën e udhëtimit. Bashkia Konispol ka dy pika kalimi kufitar me Greqinë, Qafë Botit dhe Ripsin. Rruga kryesore që çon në Konispol ka një AADT përafërsisht 5000 të fluksit të trafikut të dyanshëm dhe vetëm një përqindje e vogël që kalon kufirin ka si destinacion përfundimtar qytetin e Konispolit, ndërsa shumica e udhëtimeve janë të synojnë destinacione të tjera si Saranda.

Rivitalizimi i kushteve të jetesës në zonat malore dhe rurale në bashkinë Sarandë

Rivitalizimi i kushteve të jetesës në këto zona do të realizohet nëpërmjet një seri projektesh të propozuara të cilat synojnë aksesueshmërinë, lëvizshmërinë, rijetëzimin në pjesë të braktisura qytetit .

- Zhvillimi i një zone publike rekreative në pjesën buzë liqenit të Mursisë
- Rikualifikimi dhe rivitalizimi i qendrës historike të Konispolit
- Rikualifikimi dhe rivitalizimi i qendrës historike të Markatit
- Zhvillimi i një sistemi informacioni për turistët (infopoint)
- Zhvillimi i qendrave lokale dhe hapësirave publike në Shëndelli, Çiflik, Shalës dhe Vrinë.
- Rikonstruksioni dhe restaurimi i shkollave ekzistuese në Konispol, Shëndelli, Xarrë, Shalës, Çiflik.
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja e terreneve ekzistuese sportive.
- Krijimi i një njësie për shërbimet administrative në Shkallë (stacioni i policisë, zjarrfikësja, stacioni ambulator)
- Rehabilitimi i shtëpive tradicionale në Konispol, Markat dhe Mursi për akomodimin dhe shërbimin e turistëve
- Nxitjet për transformimin e fermave me profil të mirëfilltë bujqësor në ferma me me profil agroturistik
- Krijimi i një parku me kafshë të egra në Markat
- Ndërtimi dhe vënia në funksionim e shtëpizave të vogla malore në Markat (50 shtëpi)

Udhëzime për infrastrukturen e sistemit rrugor

Infrastruktura e sistemit rrugor do të përmiresohet nëpërmjet një seri ndërhyrjesh potenciale në kuadër të një seri programesh të cilat do të lehtësojnë aksesin, lëvizshmërinë dhe transportin në Bashkinë Konispol:

- Rikonstruktimi i rrugës ndërrbane Butrint - Shkallë (1.4km).
- Përmirësimi i aksesueshmërisë së fshatrave në rrugët kryesore interurbane .(Markat – Ninat – Janjar, Shalës – Dishat – Vervë) .
- Përmirësimi i transportit publik (frekuencat e rrugëve, më tepër destinacione).
- Përmirësimi i rrjetit sekondar të rrugëve urbane në Konispol, Shëndelli, Shalës, Mursi, Xarrë.
- Linjë e re autobusi që lidh fshatrat e largëta me Konispolin dhe qendrat e tjera
- Zhvillimi i rrugëve piktoreske agoturistike



- Zhvillimi i një rrjeti të integruar pikash tërheqëse natyrore dhe kulturore
- Zhvillimi i një sistemi shënjimi në rrugët dhe vendet me interes
- Hapja dhe shënjimi i shtigjeve për turistët.
- Promovimi i aktiviteteve të reja për turizmin aktiv natyror (eksplorim shpellash, ngjitje etj).

3.2 Rrjeti i propozuar i infrastruktures së shërbimeve publike

Shumica e sistemeve të infrastrukturës (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), do të vendosen në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, çdo sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të ndërpritet nga një sistem tjetër si p.sh., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot. Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Në lagjet e qytetit do të bëhen zgjerime me degëzime përpjendikulare në drejtim të lagjeve. Lidhjet me rrjetin duhet të bëhen në korridoret sekondarë më të afërt të linjës kryesore qendrore. Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujit të pishëm, të parametrave kimike dhe mikrobiologjike duhet të bëhet në vazhdimësi në stacionet e pompimit, si edhe në pikat fundore të çdo degëzimi sekondar.




Figura 11. Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore



Relievi i Konispolit është faktor përcaktues për sistemin e kullimit të gjithë zonës. Në zonat e vendosura në shpate kodrash, graviteti dhe forma natyrore e shpatit do të përdoret për kullimin dhe furnizimin me ujë. Në zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat e identifikuara me rrezik për përmbajtje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, nën sipërfaqe për të parandaluar çdo përmbajtje të zonave të ulta. Me studimin e Konispolit, Bashkia do të mund të realizojë rehabilitimin e sistemit të kanalizimeve ekzistuese, sikurse zgjerimin e rrjetit në mënyrë që të lidhë të gjitha zonat e banuara me rrjetin kryesor të kanalizimeve. Trajtimi i sotëm mekanik i ujërave të ndotura duhet të mbyllet/përmirësohet dhe trajtimi i kombinuar mekaniko - biologjik duhet të ndërtohet.

Sistemi i kanalizimeve

Do të ndjekë aksin qendror të infrastrukturës. Për ndërtimet e reja (dhe infomale) ata do të lidhen në zgjerimet e rrjetit grumbullues sekondar dhe terciar, ndërsa gropat ekzistuese septike duhet të monitorohen/rehabilitohen/mbyllen në mënyrë që të shmangët ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore. Meqënëse kjo do të kërkojë investime të mëdha, është propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit të përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe parametrave të cilësisë (p.sh. marrja e mostrave në rrjet, në vendin dhe në kohën e duhur për CSB, E.coli, etj). Në këtë mënyrë mund të arrihet me zbutjen e situatës së tanishme.

Energjia elektrike dhe telekomunikacioni

Kabllot duhet të vendosen në një kanal në njërën anë të rrugës në mënyrë të rregullt. Tubat ujore (të kullimit, kanalizimeve dhe të furnizimit me ujë), duhet të kalojnë në anën e kundërt. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen pranë sipërfaqes (për të parandaluar kontaminimin e mundshëm nga ujërat e ndotura urbane dhe ato të kanalizimeve), tubat për ujërat e ndotura urbane/industriale në mes dhe kanalizimimë poshtë.

Infrastruktura ujore

Zgjidhja më e mirë për infrastrukturën ujore duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makroekonomike afatgjata të burimeve të ujit, duke marrë parasysh të gjitha burimet sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore. Kjo punë tashme ka filluar me Studimin e Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), të cilat mbulojnë të gjithë zonën në jug, nga qyteti i Vlorës në Sarandë dhe Konispol. Meqënëse investimet afatgjata duan kohë dhe vlera të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, për të mbuluar sa më shumë të jetë e mundur zonat e populluara.



3.2.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë

Vlerësimet e kushteve hidrogeologjike dhe hidrologjike

Vlerësimi i rrjetit hidrografik dhe burimeve nëntokësore të ujit në zonë, i kapaciteteve të tyre dhe mundësitë për projekte në perspektivë të zhvillimit të infrastrukturës ujore, janë bazuar në studimet ekzistuese, si edhe në disa studime të ndërmarra rishtazi në zonë.

Situata hidrologjike

Zona e studimit përshkohet nga një numër rrjedhash ujore, ku më i rëndësishmi është uji, i cili merret nga burime nëntokësore (puse) dhe burime sipërfaqësore. Nga burimet nëntokësore kryesore përmendim burimin në Çiflik (10-12 l/sek).

Rezervat e ujërave nëntokësore

Kushtet hidrogeologjike varen nga struktura gjeologjike dhe morfologjike e zonës bregdetare. Ekzistojnë burime natyrore të shumta ujore, me sasi ujitë kufizuar pothuajsenë të gjithë zonën e studimit. Ujërat janë të një cilësie shumë të mirë. Këto burime kanë një origjine karstike dhe dalin në nivele të ndryshme hipsometrike. Nga burimet nëntokësore kryesore të zonës në studim përmendim burimi i Mursisë (18 l/sek), Ciflikut (10-12 l/sek), Shkallës (5-7 l/sek), Markatit (5 l/sek), Dishatit (3-5 l/sek) dhe Vervës (3-5 l/sek).

Bazuar ngasa u përmend më sipër, mund të thuhet se shfrytëzimi i burimeve ujore në zonën e studimit (bashkia Konispol) nuk janë përdorur mjaftueshmerit për të përmbushur kërkesat për ujë, që rrjedhin nga një konsumim në rritje të tij në të ardhmen, duke pasur parasysh kërkesat në rritje nga zhvillimi i turizmit.

Konsulenti mendon se shërbimet definitive të furnizimit me ujë në zonën e projektit duhet të zgjidhen në një fokus më të gjerë hapësinor, ekonomik dhe teknik dhe jo duke u përqendruar në çdo njësi në veçanti. Zgjidhjet e veçanta dhe lokale duhet të mbështeten dhe të zbatohen, duke iu referuar zgjidhjes përfundimtare të gjithë territorit të bashkisë Konispol, ose edhe më gjerë, gjithmonë nëpërmjet studimeve të thella dhe të detajuara të burimeve ujore, jo vetëm në zonën e bashkisë Konispol, por edhe në nivel rajonal duke u lidhur me burimet e bashkisë Sarandë. Ky koncept do të çojë në përdorimin më të mirë të mundshëm të pasurive ujore për zhvillimin e duhur perspektiv të këtij territori.

Uji i nxjerrë nga pusët e cekëta shtetërore dhe private të hapura, është shpesh i ndotur për shkak edhe të efekteve infiltruese të ujërave të zeza, duke bërë që direktivat përkatëse të BE-së 80/778/EEC dhe 98/83/EEC të mos jenë plotësuar deri me sot. Kjo situatë rrezikon drejtpërdrejtë dhe në vazhdimësi shëndetin e njeriut, prandaj kërkon t'i jepet prioritet i lartë kapërcimit të këtij problemi.



Sistemi i kanalizimeve

Në njësinë administrative Konispol, rreth 90% e të gjitha zonave të banuara të njësisë administrative Konispol janë duke operuar me gropa septike. Vadtja është një nga elementët karakteristikë dhe kryesorë sot, në bashkinë e Konispolit pasi çdo familje dhe biznes është i varur nga ky proces. Lidhur me teknologjinë e ujitjes, ajo që po ndodh aktualisht është që fermerët kanë ngritur sisteme individuale pompash me energji elektrike të lidhura me kanalet për t'i shërbyer kopshteve të tyre.

Mundësite e furnizimit me ujë

- Ujëmbledhësi artificial i Bezhanit apo i Mursit

Ndodhet në fshatin Mursi dhe krijohet nga diga e dheut rreth 13m e lartë. Burimet ujore të nëndheshme janë kontribuesit kryesorë me ujë por pjesërisht kontribuon edhe lumi Pavlla. Sipërfaqja e pasqyrës së tij ujore është rreth 1946 ha dhe ka një kapacitet uhor për rreth 4,5 milion m³ ujë. Ndikimi dhe roli tij në zonë është kryesisht për ujitje të fushave të Mursisë, Xarrës dhe Vrinës por gjithashtu edhe si një faktor për mikroklimën e zonës përreth.

- Ujëmbledhësi i Janjarit

Furnizohet me ujë nga lumi Pavëll, ka një sipërfaqe prej 170 ha dhe një vëllim 15,3 milion m³, ka shumë vepra arti ku ia vlen të theksohet tuneli i Markatit me gjatësi 1,2 km. Shërben për vaditje dhe mbulon 64 % të nevojave për vaditje dhe shoqërohet me një rrjetë kanalesh kryesore prej 20k.

Furnizimi i kombinuar

Ky opsion i referohet propozimit të konsideruar më të përshtatshëm në studimin e parafizibilitetit mbi "Burimet ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), i cili sugjeron përdorimin e:

- Pellgut ujëmbajtës të Vrionit;
- Burimi i Vervës;

Këto janë disa mundësi, por zgjidhja më e mirë e mundshme furnizimit me ujë duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makroekonomike afatgjata të burimeve ujore. Kjo punë ka filluar me studimin e parafizibilitetit mbi "Burimet ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), e cila trajton të gjithë zonën jugperëndimore nga qyteti i Vlorës deri në Konispol. Meqënëse zona e projektit për bashkinë e Konispolit është pjesë e bregdetit jugor shqiptar, të gjitha ndërhyrjet aktuale në rrjetin e furnizimit me ujë duhet të marrin në konsideratë, ndërhyrjet e planifikuara në shërbimin e furnizimit me ujë të studimit të mësipërm. Duke qenë se investimet afatgjata kërkojnë kohë dhe sasi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit shpërndarës ekzistues të ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur territorin e populluar.



Sikurse u përmend edhe më sipër kjo do të arrihet nëpërmjet investimeve të konsiderueshme. Aktualisht duhet propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe atyre të parametrave të cilësisë së ujit (p.sh. përcaktimit të vendeve dhe kohës për marrjen mostrave të ujit, CSB, E.coli). Në këtë mënyrë mund të zbutet pakënaqësia për cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë.

Ka disa burime të ujit në zonën e burimeve natyrore me ujë të ujëmbajtësve të ndryshëm. Të gjitha ato kanë sasi të tyre (të qëndrueshme ose të ndryshueshme gjatë vitit), të cilësisë dhe të vendndodhjes. Duke marrë parasysh dhe kombinim e secilës prej tyre me rezultat në skenarë të ndryshëm, për përmirësimin e zgjidhjes së shkurtër/ afatgjatë për këtë çështje të rëndësishme, veçanërisht në zonën e bashkisë së Konispolit, me vlera të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit. Detyra kryesore e pushtetit lokal në infrastrukturën e ujit është që të fokusohet në:

- (a) përmirësimin e situatave ekzistuese (afatshkurtër);
- (b) përgatitja e zgjidhjes përfundimtare lokale apo rajonale (afatgjatë);

Natyrisht mënyra e sipërmendur do të varej nga mbështetja financiare dhe institucionale, si edhe bashkëpunimi në nivel qendror dhe lokal. Krahas perspektivës së furnizimit me ujë, Bashkia duhet të jetë e përqendruar në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, përmes:

- i. Kontrollit dhe furnizimit me cilësinë e ujit (p.sh. përcaktimin e vendndodhjes dhe kohës për marrjen e mostrave të ujit, CSB, E.coli).
- ii. Zgjerimit dhe furnizimit me ujë dhe rrjetin ekzisues të kanalizimeve për të mbuluar shtëpitë e reja.
- iii. Eliminimin e të gjitha rrjedhjeve të ujit.
- iv. Instalimi i matësve të ujit (ujëmatësve).
- v. Përmirësimi i shpërndarjes së ujit.
- vi. Rritja e masave të menjëherëshme për mbledhjen e taksës së ujit, për shërbimet e ujit, duke u përqendruar në çështjet e rëndësishme institucionale dhe parametrat e cilësisë së ujit.

Infrastruktura e ujit të pishëm

Njësia Administrative Konispol

Konispol si qytet aktualisht furnizohet me ujë nga burimi në Çiflik me stacion pompimi me gjatësi 7000m dhe lartësi 600m, por që konsumon shumë energji elektrike si edhe me shpim me pus poshtë Konispolit. Është menduar edhe mundësia që qyteti të furnizohet nga Burimi i Vervës.

Çifliku-(Pusi/pompa) e Çiflikut i shërben fshatrave të Çiflikut dhe Konispolit duke shpërndarë ujin nëpërmjet stacioneve të pompave. Planifikohet të bëhet një projekt i ri ambicioz për përmirësimin e furnizimit me ujë në luginën e Vrinës duke ndërtuar një depo të re uji në kodrat malore mbi Xarrë që merr ujin nga Mursia dhe nga atje shpërndahet duke iu shërbyer të gjitha fshatrave në luginën e Vrinës.



Njësia Administrative Xarrë

Kjo njësi ka burime të pasura dhe të shumëllojshme natyrore. Ajo ofron një peyzazh kryesisht fushor, me ujra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, mes tyre edhe laguna e gjire, me masive. Për furnizimin me ujë të pishëm në këtë njësi përdoren kryesisht dy mënyra: me ujësjellës dhe çezma sipërfaqësore. Furnizimi me ujë të pishëm i popullsisë në këtë njësi realizohet prej 5 ujësjellësash, 18.5 km linjë e jashtme dhe 22 km rrjet shpërndarës. Nga stacioni i pompimit me ngritje mekanike që ndodhet në Mursi marrin ujë me linja fshatrat Mursi, Xarrë, Shëndëlli dhe Vrinë. Ndodhet dhe një stacion pompimi tjetër në Shkallë që furnizon me ujë fshatin Shkallë. Dishat nuk ka aktualisht furnizim me ujë të pishëm. Banorët shërbehen nga puse personale. Në Shalës ekziston rrjeti i furnizimit me ujë, kërkon disa ndërhyrje të vogla.

Njësia Administrative Markat

Kjo njësi ka nevojë të përmirësojë sistemin e furnizimit me ujë. Aktualisht furnizimi me ujë bëhet me pus. Vërvë ka furnizim me ujë në gjendie të mirë. Ninat, Janjar ekzistojnë rrjeti shpërndarës dhe depot, mungojnë pompat. Për këtë arsye ka problematika në furnizimin me ujë të pishëm.

Zgjidhja rajonale

Në kuadër të përmirësimit dhe ndërtimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë janë identifikuar projekte. Rikonstruktimi i rrjetit ekzistues/ndërtimi i infrastrukturës së re të furnizimit me ujë (Vrinë, Shalës, Ninat, Vërvë, Janjar) do të përmirësojë ndjeshëm rrjetin e furnizimit me ujë. Programi Pilot për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e burimeve ujore do të përmirësojë furnizimin dhe reduktimin e humbjeve me ujë si dhe marrja e masave për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e ujit të pishëm.

Projektet më të rëndësishme janë:

- Rikonstruksion i depos së Llazatit
- Rikonstruksion depo qendrore ne Konispol
- Rikonstruksion i burimit Vërvë

Njësia Administrative Konispol

Për Konispolin është hartuar projekti për rehabilitimin e ujësjellësit. Aktualisht furnizohet me ujë nga burimi në Çiflik me stacion pompimi me L=7000m dhe H=600m, i cili konsumon shumë energji elektrike. Propozohet të ndërtohen dy depot e reja duke u furnizuar nga dy burime ujore të cilat ndodhen mbi qytetin e Konispolit dhe bëjnë të mundur furnizimin me vetrrjedhje për qytetin e Konispolit për një periudhë 6 deri ne 8 mujore. Këto burime kanë ujë të mjaftueshëm dhe do të ulin ndjeshëm koston e furnizimit të ujit ne sistemin aktual i cili është me stacion pompimi.

Njësia Administrative Xarrë



Xarrë, Mursi, Vrinë, Shendelli aktualisht furnizohen me ujë nga burimi i Papo Vasilit me stacion pompimi. Propozohet ndërhyrje në rrjetet shpërnarese të këtyre ujësjellsave.

Në Shalës ekziston aktualisht rrjeti i furnizimit me ujë. Propozohen disa ndërhyrje të vogla për përmirësim në rrjetin shpërndarës.

Shkallë, rrjeti i ujësjellësit është në gjendje të mirë.

Vërvë, Dishat propozohet rikonstruktion i burimit në Vërvë dhe linja e furnizimit të fshatit Dishat.

Njësia Administrative Markat

Markati- Gjendia aktuale e furnizimit me ujë është në gjendje të keqe. Përdoren burimet ujore të fshatit. Propozohet për përmirësimin e sasise se ujit shpimi i një pusi në afërsi të fshatit.

Ninat, Janjar ekziston aktualisht rrjeti shpërndarës dhe depot. Propozohet ndërhyrje në furnizimin me ujë nga burimi në depot e ujit.

Në Janjari, ujësjellësi është aktualisht në gjendje të keqe. Propozohet ndërhyrje në rikonstruktionin e rrjetit shpërndarës dhe në rikonstruktionin e stacionit të pompave.



[illegible]

3.2.2 Rrjeti i propozuar i kanalizimeve

Grumbullimi i ujërave të zeza për bashkinë Konispol është një domosdoshmëri edhe për faktin që është një nga të vetmet Bashki në territor që nuk ka rrjet egzistues grumbullimi. Në njësinë Administrative Xarrë, kanalizimi i ujërave të zeza është i pjesshëm. Për godinat ish-shtetërore ka kanalizime të tilla. Rreth 3.9 km rrjet kryesor u ofrojnë shërbim jo të plotë 340 familjeve të fshatrave të kësaj njësie. Pjesa më e madhe e zonave të banuara të njësisë operojnë me gropa septike. Ndërtimi i kanalizimit është një çështje emergjente sidomos për fshatrat e luginës së Vrinës që janë të pozicionuara në ultësirë.

Për qendrat me të banuara të njësive administrative *Konispol* dhe *Xarrë*, përkatësisht Konispol, Çiflik, Xarrë, Mursi, Shkallë, Vrinë, Shendelli propozohet një rrjet qendror kryesor i KUZ duke i dërguar nëpërmjet një stacioni qendror (vaskë depozitimi) që propozohet të ndërtohet në rrethinat e fshatit Shkallë për në impiatin e trajtimit të ujërave të zeza në Çukë, i ndërtuar për këtë qëllim për bashkitë e Sarandës dhe Finiqit.

Njësia Administrative Konispol

Konispol- Për qytetin e Konispolit, propozohet të ndërtohet një depozitë grumbulluese për të gjithë qytetin, e cila shkon me vetrrjedhje deri në depoziten qendrore të propozuar në Shkallë.

Çiflik- Ujërat e ndotura do të grumbullohen në depozitën qendrore të propozuar në rrethinat e fshatit Shkallë.

Njësia Administrative Xarrë

Xarrë, Mursi- Aktualisht në fshatin e Xarrë ekziston një sistem kanalizimesh të hapura që janë një rrezik për shëndetin e banorëve, ndersa në fshatin Mursi pjesë të ujërave të zeza derdhen në rezervuarin e ujit që përdoret për ujitje. Propozohet ndërtimi i një depozite grumbulluese për të dy fshatrat dhe i një stacioni pompimi për në depoziten qendrore që propozohet të ndërtohet në rrethinat e fshatit Shkallë.

Shendelli, Vrinë, propozohet ndërtimi i një depozite grumbulluese për të dy fshatrat dhe i një stacioni pompimi për në depozitën qendrore që propozohet të ndërtohet në rrethinat e fshatit Shkallë.

Shkallë- Në rrethinat e këtij fshati propozohet ndërtimi i një depozite grumbulluese qendrore për të gjithë bashkinë Konispol. Gjithashtu ndërtimi i një stacioni pompimi për në impiatin e trajtimit të ujërave të zeza në afërsi të fshatit Çukë.

Shalës, Vërvë, Dishat-Në këto fshatra trajtimi i ujërave të zeza do bëhet me gropa septike për çdo fshat, mbasi janë larg sistemit të rrjetit të KUZ që propozohet. Çdo banesë në këto fshatra ka grope septike individuale dhe ky sistem propozohet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Njësia Administrative Markat



Markat, Ninat, Janjar- Trajtimi i ujërave të zeza do bëhet me gropa septike për çdo fshat, mbasi keto fshatra janë larg sistemit të rrjetit të KUZ-it që propozohet. Këto fshatra kanë popullsi të vogël dhe gjithmonë pa tendenca të rritjes, si zona rurale që vinë gjithnjë duke u zvogëluar. Çdo banesë në këto fshatra ka gropë septike individuale dhe ky sistem propozohet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Infrastruktura bujqësore

Për përmirësimin e infrastruktures bujqësore janë identifikuar një seri projektesh në plotësim të këtij programi. Plani dhe puna për konsolidimin e tokës. Shpërndarja ose dhënia me qera afatgjatë e tokës bujqësore në pronësi të shtetit. Ndërtimi i kanalit të ri ujitës që vjen nga Janjari. Liqeni i Janarit mbulon me vaditje pothuajse gjithë fushat e teritorit të bashkisë Konispol, për këtë Banka Botërore ka kryer studimin e fizibilitetit. Rindërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe organizimi hapësinor për mbarështrimin blegtoral. Të gjitha këto projekte synojnë modernizimin dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë në sektorin bujqësor.

Një skemë e re kanalizimesh është menduar për të sjellë ujin direkt nga rezervuari i Janjarit që ndodhet në nivelin më të lartë në afërsi të burimit të lumit me qëllim që të ketë një presion më të madh duke u realizuar me rënie të lirë. Uji mendohet të transportohet nëpërmjet tubacioneve që do të ndahen në dy pjesë duke kaluar mbi lumë në shërbim të dy pjesëve të luginës, më së shumti mandarinave dhe kultivimit të pemëve frutore dhe pjesës së vogël të ullinjve në zonën e pasme.

Skema e re e kanalit të ujitjes do të sjellë ujë nga rezervuari i Janjarit nëpërmjet kanalit me një gjatësi 25 km drejt tokës bujqësore. Përgjatë rrugës ai do të lehtësojë edhe ujitjen e kulturave të tjera të krijuara gjatë rrjedhës së lumit më në brendësi.

Projektet e infrastrukturës ujore dhe kanalizimeve në vendbanimet e bashkisë Konispol përshkruhen në listën e projekteve, të grupuar anë katër llojet e ndërhyrjeve të nevojshme (si më poshtë). Projektet specifike do të bazohen në studimet e fizibilitetit përkatës, sipas kushteve të vendbanimeve.

Tipi i ndërhyrjes së nevojshme të kërkuar:

1. Zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet ekzistuese për të mbuluar të gjithë zonën e populluar/sigurimin e impiantëve të trajtimit për çdo njësi banimi, në funksion të kushteve;
2. Ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura: (i) të veçantë për çdo zonë ose (ii) impiant trajtimi të përbashkët me zonën bashkëngjitur.
3. Ndërtimi i objekteve sanitare turistike në afërsi të plazhit, tualet publik lidhur me impiantin e trajtimit më të afërt, (ii) impiant kompakt i ndarë.
4. Ndërtimin e impiantëve kompakt të parafabrikuar ose gropave septike të rregullta për shtëpitë e veçuara.



Në fazën e dytë të trajtimi radikal duhet të realizohet rehabilitimi, kontrolli, ose heqja e gropave septikenë afërsitë objekteve ujore/stacioneve të pompimit dhe respektimin e standarteve të funksionimit dhe menaxhimit të mbetjeve të tyre. Në çdo rast duhet të ekzistojë monitorimi sistematik i cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe atij në rrjetin e furnizimit. Monitorimi i rregullt dhe permanent i parametrave kimike dhe mikrobiologjike për cilësinë e ujit të pishëm duhet të respektohet dhe zbatohet.

Udhëzues për projektet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet

A. Faza e projektim/planifikimit:

- Duhet bërë një studim kompleks (ekonomik, hidrogeologjik, social), që të ofrojë më shumë se një alternativë. Më i miri duhet të zgjidhet bazuar në:
 - a. koston;
 - b. mundësitë e financimit;
 - c. kohës së zbatimit;
 - d. kostove të funksionimit;
 - e. teknologjisë;
 - f. fleksibilitetit të funksionimit të rrjetit, etj.
- Zbatimi në faza i planit, sipas burimeve të financimit.
- Ndarjen e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në seksione, bazuar në njësitë hidraulike (burim, puse, vepërmarrje);
- Disa fshatra të bashkisë së Konispolit mund të kenë rrjete të përbashkëta kolektorësh të ujërave të zeza, në varësi të kushteve duke bërë vlerësime për çdo rast dhe sigurisht i realizuar/zbatuar në faza.

B. Faza e zbatimit:

- Të gjitha projektet parciais duhet të marrin në konsideratë studimin afatgjatë dhe rajonal të furnizimit me ujë.
- Monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pishëm nëpërmjet analizave kimike dhe bakteriologjike (sipas kritereve të Këshillit të Evropës).
- Shpërndarje dhe menaxhim sa më të mirë të ujit për një funksionim sa më të mirë të sistemit;
- Duke ditur që investimet afatgjata kërkojnë kohë dhe sasi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme, që *investimet afatshkurtra dhe afatmesme në infrastrukturëtë jenë të fokusuara në zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur zona të banuara.*

Përmirësimi i gjendjes aktuale duhet të ndjekë aktivitetet/projektet e mëposhtme:

- Detajimi i një programi investimesh në bazë të vlerësimit realist të kostove përkatëse.
- Përmirësimi i shpejtë afatshkurtër që mund të zbatohet deri në tre vjet, për të minimizuar ndryshimin midis nevojës/kërkesës për ujë dhe pasurisë ujore të zonës, *e financiar nga qeveria qendrore/lokale;*



- Hartimi i një plani infrastrukturor afatmesëm dhe afatgjatë, që mund të plotësojë nevojat për ujë familjar, industrial, tregtar dhe atë të sektorit të turizmit, të *financuar nga qeveria qendrore ose donatorët*;
- Formulimi dhe miratimi i një rregulloreje për trajtimin e ujërave të ndotura për shërbimet e reja, hotelet dhe apartamentet (*për më shumë se 20 shtretër/përsona*) për:
 - a. Ndërtimin nga ana e tyre të impiantëve biologjikë të trajtimit të ujërave të ndotura;
 - b. Funkzionimin e tyre nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e inspektoratit publik të Bashkisë;
 - c. Ujërat e mbetura pas trajtimit të derdhen në përrenj ose të filtrohen në tokë pa efekte ndotëse;
 - d. Të organizohet në mënyrë përmanente largimi i mbetjeve fekale sipas një rregulloreje përkatëse, e monitoruar gjithmonë nga inspektorati bashkiak.
- Për hotelet/shtëpite “BB” apo dhomat me qera, me më pak se 20 shtretër duhet të formulohet dhe miratohet një rregullore për:
 - a. Ndërtimin e impiantit të tyre bashkëkohor të trajtimit të ujërave /gropa septike pa efekte mjedisore;
 - b. Pastrimin/shkarkimin përmanent të gropave septike individualisht apo të organizuara nga Bashkia (kundrejt një takse të caktuar).
 - c. Organizimin e derdhjeve të këtyre gropave në një rrjedhë të përcaktuar/kanal.
 - d. Kontrollin, rehabilitimin ose mbylljen e gropave septike në afërsi të burimeve ujore apo stacioneve të pompimit;
 - e. Zbatimi i standardeve për funksionimin dhe menaxhimin e mbetjeve;

Në çdo rast duhet të ketë kontroll sistematik të cilësisë së ujërave në rrjetin e furnizimit me ujë.

Konceptimi i kostos për projektet e propozuara për furnizimin me ujë.

Kostoja e projekteve të veçanta do të kërkojë një studim rajonal fizibilitetit dhe do t'i referohet zgjidhjes dhe teknologjisë përkatëse, e pranuar nga qeveria dhe pushteti vendor.

Kostoja në vetvete është funksion i:

- Numrit të popullsisë që do t'i shërbejë;
- Kërkesës specifike për ujë;
- Relievit të zonës;
- Teknologjisë dhe materialit të përdorur;
- Pronësisë mbi tokën, etj.

Në stadin e këtij studimi, bazuar dhe në informacionin që disponojmë mund të themi se:

Sikurse u përmend edhe në raport, Konsulenti është i mendimit për një zgjidhje rajonale të furnizimit me ujë dhe atij të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura. Për një vlerësim të shpejtë mund të merren në konsideratë kostot aktuale të përafërta për këto lloje punimesh si:

- Kosto për furnizim për vendosjen e tubacionit DN nga 150 - 900 në 330-350 Euro/m;
- Kosto njësi për rezervuarët me kapacitet 1000 m³ deri 170.000 - 200.000 Euro.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë,
Himarë, Konispol


- Kostoja progresive duhet të marrë në konsideratë koston e veprës së marrjes, stacionet e pompimit dhe puseve, të cilat të gjitha së bashku formulojnë koston e projektit për çdo projekt të furnizimit me ujë.

Për ujërat e ndotura:

Edhe përprojektet e largimit dhe të përpunimit të ujërave të zeza, kostoja e projekteve të veçanta do të kërkojë një studim rajonal të fizibilitetit për mundësitë e zgjidhjes për çdo zonë të bashkisë së Konispol. Ajo do të jetë në varësi të zgjidhjes së propozuar dhe teknologjisë së përdorur, të pranuar nga qeveria dhe pushteti lokal.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol



Harta 176 - (19b) Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të propozuar



3.2.3 Rrjeti i furnizimit me energji dhe telekomunikacioni

Shpërndarja e energjisë tashmë është nën administrimin e kompanisë OSHEE. Për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në zonën e projektit, janë planifikuar investime specifike, që konsistojnë në përmirësimin dhe furnizimin nëpërmjet projekteve rajonale. Sipas informacionit të marrë nga zyra përgjegjëse për funksionimin e sistemit të furnizimit me energji, në pjesën jugore të zonës së studimit ndërhyrja e fundit ka si qëllim reduktimin e humbjeve dhe përmbushjen e kërkesave deri në 50 vitë ardhshme. Projekti përbëhet nga:

- Modifikimi i karakteristikave teknike në shpërndarje (ndarjen e dy linjave të tensionit të lartë nga 35 në 110 kV);
- Modifikimi i voltazhit të mesëm nga 10 KV në 20 kV;
- Modifikimi i duhur i nënstacioneve;
- Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët.

Në këtë kuader është ndërmarrë modifikimi i veçorive teknike të shpërndarjes (ndërtimi i dy linjave të tensionit të lartë nga 35 deri në 110 kV dhe të tensionit të mesëm nga 10 deri në 20 kV si dhe modifikimi i stacioneve).

Mundësia e furnizimit të zonës jugore, krijohet nëpërmjet fluksit të fuqisë që futet nga nënstacioni 400/110 kV i Zëmlakut. Për pasojë reduktohet fluksi i fuqisë që vjen nga linjat e largëta të rrjetit 220 kV, duke balancuar më mirë edhe vet unazën 220 kV të jugut, që përbën një problem për sigurinë e furnizimit të një zone të gjerë. Në bashkinë Konispol aktualisht ekziston Unaza e Tensionit të Lartë të energjisë elektrike nga stacioni Sarandë në Xarrë, Shkallë dhe nënstacioni Livadhja- Bistricë. Në të njëjtën kohë i vihet në shërbim fshatrat e ndryshme të Bashkisë. Lidhja e fshatrave të njësisë me tensionin e mesëm është në gjendje të mirë. Propozohet përmirësimi i rrjetit shpërndarës të gjitha fshatrave të cilat janë në gjendje tepër të amortizuar.

Telekomunikacioni

Zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit nuk është aspak një faktor kufizues për zhvillimin e rajonit. Sapo të fillojnë proceset e zhvillimit, infrastruktura e telekomunikacionit do të zgjerohet dhe do të përmirësohet për të përballuar kërkesat shtesë. Albtelekomi ka realizuar projekte, në mënyrë që të fusë shërbime të reja përveç telefonit, të tilla si internetin e shpejtë dhe televizionin kabllor. Për këtë arsye është e nevojshme të ndryshojë teknologjia ekzistuese e rrjetit, me qëllim zgjerimin e përdorimit të fibrave optike. Qëllimi është që të zvogëlojë gjatësinë mesatare të linjave.

Aktualisht ka një mbulim shumë të kufizuar nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të vetëm me telefoninë valore. Përdorimi i kabllove optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen nga operatorë të fuqishëm mobile si T Mobile, Vodafone, Eagle.





3.2.4 Menaxhimi i mbetjeve urbane

Sasia e mbetjeve urbane që prodhohen në këtë njësi është 250 t/ vit. Mbetjet e qytetit të Konispolit dhe fshatit Ciflik grumbullohen dhe depozitohen në landfillin e Bajkajt. Në njësinë Administrative të Xarrë grumbullimi i mbetjeve për Shkallë, Mursi, Xarë, Shendelli, Vrinë depozitohet në landfillin e Bajkajt. Sasia e mbetjeve urbane që prodhohen në këtë njësi është 350 t / vit. Në njësinë Administrative Markat lind nevoja e përmirësimit të trajtimit të mbetjeve. Sasia e mbetjeve urbane në këtë njësi është 120 t/vit. Për fshatrat e kësaj njësie administrative po bëhet studimi mbasi kanë diferencë transporti për t'u çuar edhe ato në Bajkaj. Mbetjet përpunohen në Landfillin e Bajkaj. Ky Landfill i shërben bashkive të Delvinës, Sarandës, Himarës. I ndërtuar në një zonë kodrinore me lartësi rreth 150 m mbi nivelin e detit, në një sipërfaqe prej 12 há, landfilli do të ketë një kapacitet përpunues ditor prej 140 ton mbetje dhe kapaciteti depozitues në total është për 365.000 m³ mbetje për një periudhë shfrytëzimi prej 25 vitesh. Ai ndodhet afërsisht 12 km në veri të qytetit të Sarandës, në distancë 1,5 km nga fshati Bajkaj dhe 1,4 km nga fshati Palavli.

3.2.5 Administrim mbetjesh dhe mbrojtje e mjedisit

Me zhvillimin e agroturizmit në zonë premiset janë për rritje të sasisë së mbetjeve dhe autoritet vendore duhet të synojnë një ulje të gjenerimit të tyre. Kjo mund të arrihet duke u bazuar në një numër të madh ligjesh dhe VKM (Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe disa shtesa 2016; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 “ Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”; Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 “ Për incinërimin e mbetjeve”;Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për landfilllet e mbetjeve”; Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; Vendim nr.117, datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 “Për disa ndryshime në vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; Vendim nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”; Vendim nr.418, datë 25.06.2014 ” Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; Vendim nr.608, datë 17.09.2014 ”Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” dhe Ligjin për importin e mbetjeve 2016) parimet e strategjisë



kombëtare dhe ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar parimet të BE-së lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve:

Parandalimi të krijimit të mbetjeve duke ndihmuar me riciklim dhe ripërdorim, duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve.

Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në Bashki si dhe duke marrë masat specifike për të:

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve:** Masë kryesore në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve të planit të Bashkisë. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.
2. **Ndihmë për industrinë e riciklimit:** Organizimi nga ana Bashkisë i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.
3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi:** Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve** det, në shtretërit e përrenjve dhe lumenjve, buzë rrugës apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

3.2.6 Administrim burimesh natyrore dhe kulturore

Trashëgimia kulturore është aseti kryesor i zonës që përfaqësohet nga një numër i madh objekteve. Qyteti antik i Çukës është ngritur mbi një kodër pranë fshatit Çiflik, sipërfaqja e shtrirjes së qytetit është rreth 4 ha. Manastiri i Shën Kollit ndodhet në një kodër buzë lumit Pavëll mes fushës së Mallahunës e pranë fshatit Çiflik. Gjetjet arkeologjike dhe burime të ndryshme na sigurojnë që territori i Konispolit ka qenë i banuar që në kohët antike.

Konispoli ka qenë një vendbanim i rëndësishëm në rajon, sepse përveç aspektit ekonomik, ndërtimi i qytetit nënkuptonte mbrojtje për vendbanimet antike përreth. Sot në Konispol janë ende në këmbë edhe 7 banesa monument kulture në lagjen Shehat. Në Xarrë monumentet kryesore veçanërisht atyre arkeologjike egzistojnë monumentet e kultit si manastiri i Shën Ilias, ai i Shën Thodhorit, Shën Maria.





Figura 12: Harta skematike e trashëgimisë së Konispolit
Burimi: Bashkia Konispol

Një nga monumentet natyrore me rëndësi është vendbanimi shpellor, nga më të rëndësishmit jo vetëm në Shqipëri por edhe në Europën Juglindore, i cili ndodhet në afërsi të Konispolit. Ai përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinj të gëlqerorë. Ka disa zgjerime dhe ngushtime, me mikroforma kalciti etj. Gjatësia e saj është disa dhjetra metra. Lartësia e gjerësia janë mesatarisht 10 m. Përdorimi dhe veçanërisht marketimi i këtyre aseteve do të jete një vlerë e shtuar në të ardhmen për ekonominë turistike për këtë zonë.

Zonat e mbrojtura natyrore

Zona e parkut kombëtar rregullohet me VKM 693 e 10.11.2005 **“Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit Park Kombëtar”** siç është amenduar nga VKM 134 e 20.02.2013. Kompleksi ligatinor realizon një ndarje të zonës mjedisore në 4 kategori të mbrojtura: A (Zona qendrore), B (Zona rikrijimi), C (Zonat e përdorimit tradicional) dhe D (Zonat e përdorimit të qëndrueshëm) me nënndarjet (A1, A2, B1, B2). Në secilën kategori, veprimtaritë e lejuara dhe ato që nuk plotësojnë kriteret janë të përcaktuara në planin menaxhues. Parimisht kategoritë A përfaqësojnë zonën qendrore të ruajtjes së biodiversitetit, kategoritë B i referohen një zhvillimi turistik të lehtë, përfshirë këtu edhe qytetin e Ksamilit, kategoritë C përcaktohen si zona me burime natyrore ku kryhen veprimtari tradicionale, aktivitete si peshkimi në liqenin e Butrintit, ekoturistike por përjashtojnë zhvillimin e veprimtarive me ndikim të madh mjedisor dhe D përfaqësojnë zonat e zhvillimit të veprimtarive të reja të qëndrueshme.

Modeli i turizmit masiv është për t'u përjashtuar pasi zona duhet të mbrohet dhe të zhvillohet me shumë kujdes. Ky duhet të jetë lloji i turizmit që i shkakton më pak dëm burimeve mjedisore dhe që bën të mundur shpërndarjen sa më të njëtrajtshme të efekteve të dobishme për territorin si edhe perspektivën afatgjatë të stabilizimit në kohë.



Zona kryesore me potenciale të tilla në zhvillimin e turizmit janë Parku Kombëtar i Butrintit në Sarandë-Konispol si dhe parku i Markatit që është propozuar nga ky plan që do shëndërrohet në një park ekologjik me kafshë të egra që është një vlerë e shtuar për këtë zonë. Këto zonat kanë vlera të mëdha të pejzazhit dhe zënë një territor të gjerë që nuk është prekur nga urbanizimi. Butrinti është një sit arkeologjik shumë herë më i rëndësishëm. Zonat vuajnë nga mungesa e menaxhimit dhe degradimi i vazhdueshëm i vlerës ekologjike duke ndikuar kështu në uljen e atraktivitetit për vizitorët. Integrimi i formave të buta të turizmit cilësor, përmes investimeve strategjike, mund të rrisë kapacitetet menaxhuese duke krijuar sinergji pozitive për turizmin. Kjo përpjekje mund të realizohet në nivel kombëtar.

Një pjesë e Parkut Kombëtar Ligatinor të Butrintit, kategoria e II, shpallur me VKM nr.134 datë 20.02.2015 përfshin në zonat e saj edhe territore të bashkisë Konispol sipas hartës bashkangjitur kësaj VKM-je. Ky park përmbush dhe kushtet për zonë RAMSAR. **Kanali i Vivarit** së bashku me burimet e kripura të **Mullirit, Këneta e Vrinës, Mali i Milesë** janë zona të mbrojtura. **Mali i Milesë** ngrihet midis fshatrave Markat, Dishat dhe Shalës, me një lartësi maksimale 1041m. Në juglindje të malit ndodhet qafa e Dishatit që ndan malin e Milesë nga ai i Saraqinit.

Mali i Saraqinit është vazhdim i malit të Milesë që së bashku përbëjnë vargmalin Saraqin-Mile, ruan drejtimin veripërendimor dhe juglindor, në fshatin Dishat arrin lartësinë më të madhe 1034 metra. Në anën përendimore të tij është formuar një tarracë piktoreske që vendosit e quajnë Sheshi i Madh.

3.2.7 Mbrojtje kombëtare, civile e kundër zjarrit

Në kuadër të politikave për mbrojtjen e zonave të rrezikuara në bashkinë Konispol, të cilat kryesisht i referohen rrezikut të dëmtimit nga zjarri, janë parashikuar një sërë objektivash dhe politikash për parandalimin dhe reduktimin e dëmit në zonat pyjore dhe të gjelbra.

Hapësira e pyllëzuar e bashkisë Konispol është 1,563 ha ndërsa ajo e kullotave 4250 ha. për këtë është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe aplikimit të plotë të Ligjit për Pyjet Nr 9385/2005 ndryshuar me Nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshme për t'i mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për qëllim ngrohjeje. Zonat e mbrojtura janë të rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e druve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me speciet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.



Tabela 24. Monitorimi i pyjeve dhe zonave të mbrojtura dhe të gjelbra		
Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i dëmtimit të kullotave dhe pyjeve	Reduktimi i dëmtimit 100%	2018
Hartimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura	Për zonat e reja të shpallura dhe përditësimi/rishikimi i planeve ekzistuese në masën 100%	2019

3.3 Konsiderata mbi planet e niveleve të tjera dhe ndikimi i tyre mbi territorin

Një element shumë i rëndësishëm, që plani merr në konsideratë janë dhe dy dokumentat bazë ku përshkruhen zhvillimet e ardhshme të territorit si dhe zhvillimet strategjike të tij. Plani Kombëtar dhe PINS bregdeti. PINS bregdeti jep direktiva të rëndësishme, të cilat janë marrë ne konsideratë në plan në lidhje me infrastrukturën rajonale dhe mënyrën e zhvillimit të transportit në zonat të ndryshme të bregdetit. Këto dokumente janë marrë në konsideratë gjithashtu për polet e zhvillimit në territorin në studim duke përmendur polin bujqësor, ekonomik, energjitik etj. Gjithashtu elementet strategjike të impaktit kombëtar mbi gjithë territorin e vendit si, aeroport hekurudhë, itinerare të ndryshme të levizjes turistike etj. Harta tregon lidhjen me rajonin që Bashkia siguron si shembull i planifikimit të infrastrukturës në nivel kombëtar.




Figura 13. Poli ekonomik Gjirokastrë-Sarandë, Porta Jugore e Rivierës Shqiptare
Burimi: PPK 2030



3.4 Tipologjia dhe shpërndarja në territor e shërbimeve sociale

Pozicionimi i shërbimeve arsimore, sociale sportive, shëndetësore

Njësia Administrative e Xarrës

Edukimi. Sipas standardeve të planifikimit, nuk ka nevojë për objekte të tjera për arsimin, me përjashtim të mungesës absolute në çerdhe (çerdhe). Kështu, 4 njësi të reja të tilla janë propozuar për ndërtim. Shpërndarja e tyre hapësinore do të marrë parasysh përbërjen demografike në secilin prej vendbanimeve. Më konkretisht, 2 njësitë e reja janë propozuar në Xarrë dhe Mursi për shkak të madhësisë së tyre dhe të popullsisë. Për kategoritë e tjera të objekteve arsimore, nuk ka nevoja të drejtpërdrejta. Nevojat e vetme që janë gjetur gjatë studimit ishin objektet në Shendelli dhe të zonës përreth (ndërtesë e vogël dhe e papërshtatshme) dhe në Xarrë (ndërtesë e dëmtuar me hapësira të papërdorshme). Për këtë arsye, modernizimi, riparimin dhe rindërtimin i këtyre objekteve është një parakusht thelbësor. Së fundi, nevojat e popullsisë për arsimin (shkollë të mesme) e mesëm do të ofrohet në Konispol.

Shëndetësia. Në sektorin e shëndetësisë, ka nevojë për 2 njësi të ambulancës, këshillim dhe 2 njësi shtesë të qendrave shëndetësore. Vendndodhja e ambulancës- njësi këshillimi mund të jetë në Mursi (riaktivizimin e objekteve ekzistuese të vjetra spitalore) dhe Plugin, ndërsa njësitë e reja të qendrave shëndetësore janë propozuar të vendosen në Vrinë dhe në Xarrë (rindërtimin dhe ripërdorimin e infrastrukturës ekzistuese). Funksioni i qendrave shëndetësore mund të jetë periodik.

Shërbimet Sportive. Nevoja për objekte sportive në Vrinë, Xarrë dhe Mursi janë të mbuluara plotësisht nga objektet ekzistuese. Megjithatë, mirëmbajtja e rregullt dhe përmirësimi i këtyre objekteve është vlerësuar si investim thelbësor publike. Standarti minimal i kërkuar nuk përjashton rastet e zhvillimit të infrastrukturës së re për shërbimin lokal të vendbanimeve (njësi të vogla të fushave sportive ose bërthama sportive etj). Sipërfaqja minimale sipas standartit për njësi duhet të jetë 0,15 ha.

Hapësira parkimi: Sasia e sipërfaqes për parkim publik përfshin tërësisht hapësirën për parkim publik (parkim në qendra, parkim në rrugë etj). Për këtë arsye, përqindja e konsiderueshme e sipërfaqes së vlerësuar është propozuar që të shpërndahet në vendbanimet duke marrë në konsideratë nevojat e tyre aktuale dhe potencialin dhe rolin e tyre funksional (komerciale, bujqësore, turistike, shërbimet administrative etj). Në përfundim, 3 zona kryesore propozohen për parkim në qendra, propozohen të jenë të vendosura në vendbanimet e Mursi, Xarrë dhe Shkallë. Hapësira parkimi mund të jenë vendosur në afërsi të qendrave lokale ose pranë hyrjes së vendbanimeve ose pikave turistike (p.sh. objektet e trashëgimisë kulturore). Në rast se kemi mungesë sipërfaqeje atëherë duhet të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të njësive më të vogla.



Shërbimet komerciale. Minimumi i kërkuar i sipërfaqjes për shërbime të kufizuara komerciale është i lidhur me strukturën specifike ose përdorim të përzier banimi. Nevojat për këto sipërfaqe dhe kategorie, propozohen që të shpërndahen në Mursi, Xarrë dhe Shkallë (me formën e përdorimit të përzier për banim) duke rritur rolin turistik të Mursit dhe qendrës administrative në Shkallë. Në Murësi propozohet nga plani krijimi i ndërtesave komerciale ku të ketë pika shitje për promovimin për produktet bujqësore vendase.

Tabela 25. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësisë për shërbime sociale - Njësia Administrative Xarrë

Përdorimet e tokës / Sherbimet	Banorët e parashikuar / Përdoruesit (1)	Standarti minimal për banorë /përdorues (m2) (2)	Hapësi ra minim ale e kërku ar (ha) (3) = (1)*(2)	Njësit ë e kërku ara (4)	Toka e përdors hme ekzistues e (ha)* (5)	Njësit ë ekzist uese (6)	Minim umi i ri i së sipërfa qes së kërku ar (ha) (7)= (3) - (5)	Njësitë e reja të propozu ara (8)=(6)-(4)
Hapësirat e gjelbëra								
Gjelbërim i përgjithshëm publik	4391	5	2.20	N/A	0.64	7	1.56	N/A
i.) Sheshe (njësi)	4391	2.5	1.10	N/A	0.01	1	1.09	N/A
ii.) Parqe etj.	4391	1	0.44	N/A	0.50	1	-0.06	N/A
iii.) Hapësira të tjera publike	4391	1.5	0.66	N/A	0.13	5	0.53	N/A
Zona periferike	4391	8	3.51	N/A	N/A		3.51	N/A
Gjelbërim publik i kufizuar	4391	2	0.88	N/A	N/A		N/A	N/A
Gjelbërimi i veçantë	N/A		N/A		N/A		N/A	N/A
Edukimi	4391	4	1.76	8	1.8	7	-0.04	4
çerdhe	Një njësi për çdo 1.000 banorë		(4*0,15) = 0,6	4	0	0	0.60	4
Kopshte	Një njësi për çdo 1.500 banorë		(3*0,15) = 0,45	3	0.91	4	-0.46	0
shkolla 9-vjeçare	Një njësi për çdo 6.000 banorë		(1*0,15) = 0,15	1	0.89	3	-0.74	0
shkolla të mesme	Një njësi për çdo 9.000 banorë		0.00	0	0	0	0.00	0
Shëndeti								
i.) Qendër shëndetësore	Një njësi për 250 - 1.500 banorë		(3*0,04) = 0,12	Min. 3	0.02	1	0.10	2
ii.) Qendër ambulatorie	Një njësi për 1500 - 2.000 banorë		(2*0,1) = 0,2	Min. 2	0	0	0.20	2



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol

Objekte sportive	4391	1.6	0.70	N/A	1.78	2	-1.08	0
Vend parkime	4391	6	2.63	N/A	N/A		2,63 (inc. gjate rruges)	3
Shërbime tregtare	4391	5	2.20	N/A	N/A		N/A	N/A
Përdorime të tjera publike	4391	2	0.88	N/A	4.83	11	-3.95	Min. 2
Objekte fetare	4391	N/A	N/A	N/A	4.77	9	N/A	N/A
Shërbime kulturore	4391	N/A	N/A	N/A	0.05	1	N/A	N/A
Shërbime administrative	4391	N/A	N/A	N/A	0.01	1	Min.	Min. 2
Kategoria e njësi së planifikimit/strukturore "Deri në 10.000 banorë"								
*: Toka e përdorshme është e bazuar në vlerësimet në GIS.								

Tabela 26. Propozime për shërbime sociale

Hapësiat e gjelbra

Minimumi 1 hapsirë të gjelbër (kënd lojrash etj.) për çdo strukturë banimi

Përmirësimi dhe mirëmbajtja e parkut të Mursisë

Minimumi 1 shesh/ zonë banimi (në qendër)

1 zonë e gjelbër në liqenin e Mursisë dhe 1 në shpatin kodrinor të Shëndellisë

Nuk është I nevojshëm përcaktimi i këtyre tipeve të nësive përmes GLP

Edukimi

4 njësi të reja: 1 në Xarrë, 1 në Mursi, 1 në Shëndelli (që I shërbejnë gjithashtu edhe Vrinës)

Nuk nevojiten/ Përmirësimi i faciliteteve ekzistuese në Shëndelli

Nuk nevojiten/ Përmirësimi dhe rikonstruktimi i atyre akzistuese në Xarre

Nuk nevojitet. Njësia strukturore do të vazhdojë funksionimin në Konispol

Shëndeti

2 njësi të reja: 1 në Vrinë (rikonstruktimi i asaj ekzistuese), 1 në Xarrë

2 njësi të reja: 1 në Shkallë, 1 në Mursi (objektet e vjetra spitalore)

Objektet sportive

Përmirësimi dhe modernizimi i qendrës ekzistuese sportive në Mursi.

Vendparkime



Hapësira të reja parkimi jashtë rruge në Mursi, Xarrë dhe Shkallë

Shërbime tregtare

Shpërndarja e zonave në in Mursi, Shkallë dhe Xarrë (përdorim miks)

Përdorime të tjera publike

**Nuk ka nevojë për o
bjekte fetare**

Qendë e re kulturore në Xarrë, objekt i ri i librarisë publike in Mursi

Zonë e re administrative në Shkallë (zjarrfikëse, stacion policie)

2. Njësia Administrative Konispol

Edukimi: Sipas standardeve të planifikuara, nuk ka nevojë për objekte të tjera për arsim, me përjashtim të mungesës absolute në çerdhe. Kështu, 2 njësi të reja janë propozuar për zhvillim. Më konkretisht, një njësi e re është propozuar të jetë e vendosur në Konispol, ndërsa tjetra në Çiflik. Një nga zgjidhjet, të cilat duhet të shqyrtohen, është rindërtimi dhe rihapja e objekteve ekzistuese të braktisura shkollore, pranë qendrës shëndetësore në Çiflik. Në këto objekte mund të ngrihen çerdhe dhe kopsht. Për sa i përket nevojave për kopshtet e fëmijëve, duhet theksuar nevoja për sipërfaqe shtesë. Për këtë qëllim, aktivizimi i objekteve jo funksionale në Çiflik (si më lart) është i nevojshëm, ndërsa zona përreth për ndërtimin e kopshtit në Konispol ("Kopshti Nr.2") duhet të zgjerohet dhe të modernizohet. Nevojat e popullsisë për arsim primar dhe të mesëm për (shkollën 9-vjeçare) (shkolla e mesme) të vendbanimeve do të qendrojnë në objektet ekzistuese të Konispolit.

Shëndetësia: Për sa i përket sektorit të shëndetësisë, ka nevojë për shtimin në njësitë 1 një ambulancë – qendër këshillimore. Gjithashtu, ka nevojë për modernizimin e qendrës ekzistuese shëndetësore në Çiflic, ndërsa një qendër ambulatorie mund të ndërtohet në qendrën ekzistuese shëndetësore të Konispolit.

Shërbimet Sportive: Nevojat për facilitate sportive janë të mbështëtura nga zona eksituese sportive në Konispol (njësia 1). Megjithatë, propozimi përfshin zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese të shkollës (gjatë orëve të mbrëmjes) për përdorim publik. Gjithashtu, një zonë e re si haësire publike për këtë funksion duhet të përfshihet në njësi. Për zonën e Çiflikut, një njësi e re sportive me rëndësi lokale duhet të sugjerohet, për t'u shërbyer nevojave të të dy zonave Shkallë dhe Çiflik. Sipërfaqja minimale për një njësi të re të qëndrueshme është propozuar që të jetë 0,15 ha.

Hapësira parkimi: Sipërfaqja e parashikuar për parkim publik përfshin tërësisht hapësirën për parkim publik (parkim në rrugë, qendër parkim etj). Për këtë arsye, përqindje konsiderueshme e sipërfaqes së vlerësuar është propozuar që të shpërndahet në Konispol duke marrë në konsideratë nevojat aktuale dhe potencialin e zhvillimit në të ardhmen (komerciale,



turistike, qendrat administrative). Kështu, 2 hapësira të reja parkimi jashtë janë propozuar për t'u vendosur në afërsi të qendrës ekzistuese dhe në fund të lagjes Shehat, për të shërbyer për nevojat ekzistuese dhe nevojat për të ardhmen.

Shërbimet komerciale: Minimumi i sipërfaqjes së kërkuar për shërbime të kufizuara komerciale është i lidhur me hapësirën e përdorimit për banim me strukturë specifike ose të përzier. Nevojat që i shërbejnë kësaj kategorie të përdorimit të tokës, janë mbuluar nga qendra mikse të Konispolit (komerciale dhe përdorim banimi), të cilat janë propozuar të zgjerohen (nëpërmjet planifikimit dhe incentiveve që mund të ndërmerren).

Tabela 27. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësisë për shërbime sociale - Njësia Administrative e Konispolit

Përdorimet e tokës / Shërbimet	Banorët e parashikuar / Përdoruesit (1)	Standarti minimal për banor / përdorues (m2) (2)	Hapësira minimale e kërkuar (ha) (3) = (1)*(2)	Njësitë e kërkuara (4)	Njësitë ekzistuese (5)	Existin g units (6)	Minimum i ri i sipërfaqes së kërkuar (ha) (7) = (3) - (5)	Njësitë e reja të propozuara (8) = (6) - (4)
Hapësirat e gjelbëra								
Gjelbërimi i përgjithshëm publik	2187	5	1.09	N/A	0.45	2	0.64	N/A
i.) Sheshe (njësi)	2187	2.5	0.55	N/A	0	0	0.55	N/A
ii.) Parqe etj.	2187	1	0.22	N/A	0.30	1	-0.08	N/A
iii.) Hapësira të tjera publike	2187	1.5	0.33	N/A	0.15	1	0.18	N/A
Zona përriferike	2187	8	1.75	N/A	N/A		1.75	N/A
Gjelbërimi publik i kufizuar	2187	2	0.88	N/A	N/A		N/A	N/A
Gjelbërimi i veçantë	N/A		N/A		N/A		N/A	N/A
Edukim	2187	4	0.87	6	1.26	5	-0.39	2
Çerdhe	Një njësi për çdo 1.000 banorë		(2*0,15) = 0,3	2	0	0	0.30	2
Kopshte	Një njësi për çdo 1.500 banorë		(2*0,15) = 0,3	2	0.08	3	0.22	0
shkolla 9-vjeçare	Një njësi për çdo 6.000 banorë		(1*0,15) = 0,15	1	0.59	1	-0.44	0
shkolla te mesme	Një njësi për çdo 9.000 banorë		0.45	1	0.59	1	-0.14	0
Shëndeti								
i.) Qendër shëndetësore	Një njësi për 250 - 1.500 banorë		(2*0,04) = 0,08	Min. 2	0.11	2	-0.03	0
ii.) Qendër ambulatorie	Një njësi për 1500 - 2.000 banorë		(2*0,1) = 0,2	Min. 1	0	0	0.20	1



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol

Objekte sportive	2187	1.6	0.35	N/A	0.59	1	-0.24	0
Vendparkime	2187	6	1.31	N/A	N/A		1,31 (inc. roadside)	2
Shërbime tregtare	2187	5	1.09	N/A	2.11		N/A	N/A
Përdorime të tjera publike	2187	2	0.44	N/A	0.17	4	0.27	Min. 2
Objekte fetare	2187	N/A	N/A	N/A	0.09	2	N/A	N/A
Shërbime kulturore	2187	N/A	N/A	N/A	0	0	N/A	N/A
Shërbime administrative	2187	N/A	N/A	N/A	0.08	2	N/A	Min. 2

Kategoria e njësië së planifikimit/strukture "Deri në 10.000 banorë"

* Toka e përdorshme është e bazuar në vlerësimet në GIS.

** Shkolla e mesme e Konispolit shërben për gjithë Bashkinë.

*** Nevoja për shërbimin administrativ mund të llogaritet për gjithë popullsinë e Bashkisë.

Tabela 28. Propozime për shërbime sociale

Hapësiat e gjelbra

Hapësira të reja në Konispol/min. njësi 1 në Çiflik

Përmirësimi i zonave kodrinore të monumenteve dhe përdorimi si park.

Hapësira të reja në Shehat (Konispol)/ Shesh në qendër të Çiflikut.

Zhvillimi i zonës së pyllit e përdorur si park në Konispol

Nuk ka nevojë për të përcaktuar këto lloje të njësive me GLP

Edukim

2 njësi të reja: 1 në Konispol, 1 në Çiflik (vendosur afër kopshtit të fëmijëve)

**Nevoja për sipërfaqe shtesë / përmirësimi sip. ekzistuese në Konispol.
s'ka nevojë**

Nuk ka nevojë. Shkolla e mesme shërben për gjithë Bashkinë .

Kujdesit shëndetësor

Nevoja për modernizimin e njësive ekzistuese në Qytetare. Need for the modernization of the existing unit in Ciflic.

Nevoja për modernizimin e njësive ekzistuese në Çiflik.

Objektet sportive

Njësitë e reja në Konispol dhe Çiflik/ Akses në objektet e shkollës.

Vendparkime

2 hapësira vendbarkimesh në rrugë në qendër të Konispolit.

Shërbime tregtare

Zona ekzistuese me vendbanime të përziera në Konispol

Përdorime të tjera publike



Nuk ka nevojë për institucione fetare

Qendra të reja kulturore, librari publike dhe museume në Konispol.

Zonë e re administrative në Shkallë që shërbejnë të gjithë Bashkisë.

3. Njësia Administrative Markat

Edukimi: Sipas standardeve të planifikimit, ka nevojë për zhvillim të objekteve të 2 çerdheve. 2 njësitë e reja janë propozuar për t'u vendosur në Shalës dhe Markat, të cilat paraqesin një dinamikë demografike në krahasim me vendbanimet e tjera. Për sa i përket nevojave për kopshte, sugjerohet (1 njësi shtesë). Për shkak të projeksioneve të popullsisë, propozimi për një njësi shtesë duhet të shqyrtohet me kujdes. Nëse lind nevojë për një njësi të re, kjo është propozuar të jetë e vendosur në Markat, duke shërbyer për tri fshatrat (Markat, Ninat dhe Janjar). Nevojat e popullsisë për arsim primar për (shkollën 9-vjeçare) do të mbeten në objektet ekzistuese (4 shkolla fillore), duke ofruar një rreze shërbimi për gjithë vendbanimet. Së fundi, nevojat për arsim (shkolla e mesme) do të mbeten për të shërbyer në Konispol.

Shëndetësia: Në sektorin e shëndetësisë, ka nevojë vetëm për 1 qendër ambulance – e qendër këshillimi. Vendndodhja e saj duhet të propozohet për t'u vendosur në Shalë ose në Markat. Këto dy zgjedhje të ndryshme, të cilat do të kenë rezultate dhe avantazhe të ndryshme. Vendndodhja në Shalë siguron lidhje më të mira me zona të tjera të Bashkisë. Vendndodhja e kësaj njësie në Markat do të formojë një bërthamë dinamike të shërbimeve sociale, duke mbështetur rolin programatik të zonës si asaj turistike apo për vendbanimet.

Shërbimet Sportive: shërbimet sportive të të gjithë njësisë administrative janë të vendosura në Shalës (pranë shkollës) është një fushë e re mini futbollit dhe një stadium informal volejbollit me pajisje të papërshtatshme dhe të varfëra. Standardet e planifikimit tregojnë mungesën e këtyre hapësirave. Nëpërmjet planit janë propozuar minimumi 3 objekte sportive. Njëra është propozuar të jetë e vendosur në Markat (që t'u shërbejë Markat dhe Ninat), një në Janjar dhe një në Dishat ose Vervë (që shërbejnë për të dy vendbanimet). Në mënyrë ideale, shpërndarja racionale e zonave të hapësirave publike duhet të zgjedhe të paktën një njësi në bazë të madhësisë së popullsisë. Sipërfaqja minimale për një njësi është propozuar për të zënë 0,15 ha.

Hapësira parkimi: Sipërfaqe e parashikuar për parkim publik përfshin tërësisht hapësirën publike (parkim në rrugë, qendra parking etj). Për këtë arsye, pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes së vlerësuar është propozuar që të shpërndahet në zonën e Shalës dhe Markat, duke marrë në konsideratë nevojat aktuale dhe potencialin e rolit të tyre me zonat (qendrat e shërbimeve). Në përfundim, 2 hapësira të reja parkimi në rrugë propozohen të jenë të vendosura në afërsi të qendrave lokale, ose në hyrje të fshatrave, duke shërbyer dhe duke inkurajuar banorët dhe vizitorët të parkojnë makinat e tyre.



Shërbime tregtare: Sipërfaqja minimale e kërkuar për shërbime të kufizuara komerciale është e lidhur me hapësirën për përdorim banimi me strukturë specifike ose të përzier. Nevojat që i shërbejnë kësaj kategorie toke, janë vendosur në qendra mikse banimi të Markatës dhe Shalës (komerciale dhe përdorim banimi) që ofrojnë tërheqje për investimet private.

Tabela 29. Vlerësimi i nevojave të territorit / njësive për shërbime sociale - Njësia Administrative Markat

Përdorimet e tokës / Shërbimet	Banorët e parashikuar / Përdoruesit (1)	Standart i minimal për banor / përdorues (m2) (2)	Hapësirë minimale e kërkuar (ha) (3) = (1)*(2)	Njësitet e kërkuara (4)	Toka e përdorshme ekzistuese (ha)* (5)	Njësitet ekzistuese (6)	Minimimi i ri i sipërfaqes së kërkuar (ha) (7) = (3) - (5)	Njësitet e reja të propozuara (8) = (6) - (4)
Hapësirat e gjelbëra								
Gjelbërim i përgjithshëm publik	1915	5	0.96	N/A	0.02	1	0.94	N/A
i.) Sheshe (njësi)	1915	2.5	0.48	N/A	0.00	0	0.48	N/A
ii.) Parqe etj.	1915	1	0.19	N/A	0.00	0	0.19	N/A
iii.) Hapësira të tjera publike	1915	1.5	0.29	N/A	0.02	1	0.27	N/A
Zona periferike	1915	8	1.53	N/A	N/A		3.51	N/A
Gjelbërim publik i kufizuar	1915	2	0.88	N/A	N/A		N/A	N/A
Gjelbërimi i veçantë	N/A		N/A	N/A	N/A		N/A	N/A
Edukimi	1915	4	0.77	5		7	0.77	4
çerdhe	Një njësi për çdo 1.000 banorë	(2*0,15) = 0,3	2	0.00	0	0.30	2	
Kopshte	Një njësi për çdo 1.500 banorë	(2*0,15) = 0,3	2	0.08	1	0.22	1	
shkolla 9-vjeçare	Një njësi për çdo 6.000 banorë	(1*0,15) = 0,15	1	0.71	4	-0.56	0	
shkolla të mesme	Një njësi për çdo 9.000 banorë	0.00	0	0.00	0	0.00	0	
Shëndeti								
i.) Qendër shëndetësore	Një njësi për 250 - 1.500 banorë	(2*0,04) = 0,08	Min. 2	0.03	2	0.05	0	
ii.) Qendër ambulatorie	Një njësi për 1500 - 2.000 banorë	(1*0,1) = 0,1	Min. 1	0.00	0	0.10	1	
Objekte sportive	1915	1.6	0.31	N/A	0.08	2	0.23	Min. 3
Vend parkime	1915	6	1.15	N/A	N/A		1,15 (inc. roadside)	2



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol

Shërbime tregtare	1915	5	0.96	N/A	N/A	N/A	N/A
Përdorime të tjera publike	1915	2	0.38	N/A	0.13	4	0.25
Objekte fetare	1915	N/A	N/A	N/A	0.03	1	N/A
Shërbime kulturore	1915	N/A	N/A	N/A	0.06	2	N/A
Shërbime administrative	1915	N/A	N/A	N/A	0.04	1	N/A
Kategoria e njësive së planifikimit/strukture "Deri në 10.000 banorë"							
*: Toka e përdorshme është e bazuar në vlerësimet në GIS.							

Tabela 30. Propozime për shërbime sociale

Hapësiat e gjelbra
Minimumu 1 hapësirë për vendbanim (prioritet në Shalë dhe Markat)
Zonë e re rekreative në Markat (me shërbim tregtar)
Minimumi një hapësirë sheshi për vendbanim (kombinuar me këndlojtrash)
Nuk ka nevojë. Ekzaminim afatgjatë
Nuk është i nevojshëm përcaktimi i këtyre tipeve të nësive përmes GLP
Edukimi
2 njësi të reja: 1 në Shalë, 1 në Markat
Vlerësim i qëndrueshmëri në 1 njësi të re në Markat.
S'ka nevojë
S'ka nevojë. Shkolla e mesme në Konispol shërben për gjithë Bashkinë.
Shëndetësia
S'ka nevojë
Njësi të reja administrative në Shalë ose Markat.
Objektet sportive
Minimumi 3 objekteve lehtësuese në (Markat, Janjar, Dishat ose Vervë)
Vendparkimet
2 hapësira në rrugë vendparkimesh (Markat dhe Shalë)
Shërbimet tregtare
Stimuj në qendrat vendore të Shalë dhe Markatit (Formular përdorimi i përzier)
Përdorime të tjera publike
Nevoja të padefinuara për njësi të reja administrative.
Librarite publike dhe muzeumet në Markat.
S'ka nevojë të drejtëpërdrejta. Njësi të ardhshme do të vendosen në Shalë ose Markat.
S'ka nevojë të drejtëpërdrejta. Njësi të ardhshme do të vendosen në Shalë ose Markat.



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë,
Himarë, Konispol





4. PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PPV-VE

Plani i Përgjithshëm Vendor përcakton në kohë dhe hapësirë të gjithë veprimet, që do të ndërmerren në territorin e bashkisë Konispol. Ai shoqërohet nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor, i cili monitoron impaktin mjedisor për çdo ndërhyrje në territor. Në mënyrë skematike më poshtë janë përfshirë të gjitha ndërhyrjet në territor në formë matricore, sipas programeve/projekteve prioritare përkrah objektivave strategjike të përfuara mbi bazën e vizionit të hartuar nga bashkia Konispol, si dhe të përcaktuara në afate kohore të ndara në bazë fazash 5-vjeçare.

Përveç informacioneve të mësipërme, matrica paraqet koston e përafërt të çdo projekti të bazuar në parametra. Kostoja e parashikuar e projekteve krijon një ide mbi nevojat për investime vjetore, duke i krahasuar dhe priorizuar këto brenda çdo faze zhvillimi. Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e këtyre projekteve nga ana e Bashkisë, si dhe përthithja e ekspertizës përreth tyre, gjë që përkthehet në burime njerëzore, është një element tjetër i vlerësuar në matricë. Indikatorët monitorues janë ata, të cilët në mënyrë direkte dhe indirekte vlerësojnë zbatimin e projektit dhe suksesin e tij.

Elementët e mesipërm do të përshkruhen si më poshtë dhe përmbajnë pikat 4.1, 4.2 dhe 4.3 të PPV-së, si më poshtë:

4.1. Fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit.

- Projektet prioritare/strategjike dhe projektet pilot
- Rrjetet kryesore të infrastrukturave publike
- Zonat prioritare për zhvillimin e turizmit
- PDV-të

Symimi	Programi Strategjik	Projektet	Nën-nyesa/Fazat	Vlera e projektit	FAZA I					FAZA II					FAZA III					
					2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
OSI: Modernizimi dhe përmirësimi i kushtetueshmërisë së sektorit bujqësor	OSIPS1: Menaxhimi i tokës bujqësore dhe modernizimi i infrastrukturës	1.1 Plan dhe puna për konsolidimin e tokës	Për gjithë territorin e bashkisë Konispol	4,850	1,150	1,150	1,150	1,150	1,150											
		1.2 Shpërndarja ose dhënia me qera afatgjatë e tokës bujqësore në pronësi të shtetit	Nanë Muri	3,425	856	856	856	856	856											
		1.3 Ndërtimi i kanalit të rrëqitës që vjen nga Janjari	Janjari	2,000,000	500,000	500,000	500,000	500,000	500,000											



Sherbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për katër bashki: Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol

	1.4	Rindërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese (kanalet)	Për gjithë territorin e bashkisë Konispol	20,500						4,100	4,100	4,100	4,100	4,100						
	1.5	Organizimi hapësior për mbarrëdhënimin blegjor.	Projekte Nishtëfajve	13,400	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000											
OSIPS2: Ndërtimi dhe funksionimi i një pakëti bujqësore dhe i njësisë së shpërndarjes.	2.1	Ndërtimi dhe funksionimi i një pakëti bujqësore dhe i njësisë së shpërndarjes.	Konispol, Xarrë, Mursi, Shkallë	94,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000											
OSIPS3: Promovimi i produkteve bujqësore vendore dhe krijimi i zinxhirëve të prodhimit midis zonave të brendshme dhe bregdetare	3.1	Motivimi dhe mbështetja për krijimin e kooperativave bujqësore	Xarrë Mursi	10,055						2,011	2,011	2,011	2,011	2,011						
- Paraqitjen e detajuar në relacion dhe në hartë të shpërndarjes së intensitetit të ndërtimit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për çdo parcelë, si dhe të distancave dhe lartësive të objekteve në përputhje me rregulloren e zhvillimit.
- Mënyrën e zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në përputhje me ligjin dhe me rregulloret përkatëse.

Rregullorja e PDV-së përmban, të paktën:

- Përkufizimet e termave të përdorur;
- Shpjegimin e kodeve të përdorura për:
 - i. Kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
 - ii. Sistemet/ zonat/ njësitë;
 - iii. Kode të tjera sipas rastit.
- Normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas kësaj rregulloreje;



- Rregullat e ruajtjes së mjedisit, pejzazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, që përfshijnë, të paktën:
 - i. Normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, pejzazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
 - ii. Normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore, nëse ka elemente të tilla në zonë;
- Përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu), nëse ka elemente të tilla në zonë.
- rregullat për zhvillimin e njësisë/zonës që përmbajnë, të paktën:
 - i. kushtet e zhvillimit;
 - ii. Kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
 - iii. Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës;
 - iv. Përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.
- Të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
- Rregullat e nënndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi;
- rregullat e sistemit rrugor dhe transportit që përmbajnë, të paktën:
 - i. Përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
 - ii. Kushte teknike dhe përmasat;
 - iii. Parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit, sipas legjislacionit të posaçëm;
 - iv. Përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë anëve të trupit të rrugës;
- Rregulla arkitektonike, sipas rastit;
- Rregullat për përdorimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

4.6 Përcaktimet kryesore për termat e referencës për planet sektoriale

Dokumentat më të rëndësishëm ku duhet bazuar hartimi i planit vendor sektorial janë: Plani Vendor dhe Plani Kombëtar Sektorial. Pikëprerja e këtyre dy instrumentave përbën pikënisjen e hartimit të planit vendor sektorial. Një element tjetër që duhet marrë në konsideratë është hartimi i buxhetit afatmesëm dhe afatgjatë i buxhetit bashkiak në zbatim të këtij plani. Plani Vendor sektorial, teksa hartohet e zbatohet, duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune përherë në vazhdimësi. Autoriteti përgjegjës, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, nisma për hartimin e PVS-së; hartimi i PVS-së,



bashkërendimi i PVS-së, këshillimi dhe takimi publik në kuadër të PVS-së, botimi në regjistër i PVS-së, miratimi, hyrja në fuqi e PVS-së kryhen duke ndjekur si bazë procedurat e përcaktuara për PPV dhe PKS.

Disa nga planet sektoriale që duhet të hartohen në vijim të zbatimit të kësaj PPV-je janë:

1. Plani sektorial për një zhvillim bujqësor të qëndrueshëm: Ky plan do të tentojë të përfshijë prioritetet në tipet e turizmit, të cilat do të zhvillohen në zonë :

- Konsolidimi i zhvillimit të bizneseve bujqësore me produkte lokale të zonës (mandarina, mjaltë, vaje uliri, produkte bulmeti)
- Prezantimi i vazhdueshëm i produkteve të reja të agroturizmit në formën e guesthouse (shtëpi pritjeje).
- Krijimi i formave të reja të turizmit natyror dhe kulturor, aventurat, kafshët e egra, sportet, kultura dhe shtëpite muze, aktivitetet rurale, etj.
- Promovimi i turizmit kulinar me produkteve lokale të zonës Konispol-Sarandë-Ksamil

1- Plani sektorial i transportit dhe infrastrukturës: Me qëllim dhënien e zgjidhjeve afatgjata për të përmirësuar dhe eficientuar flukset e transportit privat dhe publik, si dhe transportin e mallrave në bashkinë e Konispol, nëpërmjet planit duhet të synojë:

- Lidhje më eficientë të zonave të brendshme dhe të thella malore me qëllim që të kemi përmirësim të shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe sociale përmes transportit publik
- Zgjidhjen e skemës së transportit për çdo fshat, si dhe përmirësimin e transportit ndërkufijetar.
- Mundësimin e krijimit të disa shtigje biçikletash përgjatë zonës pejzazhistike.
- Përmirësimi i infrastrukturës ujore dhe në veçanti i kanalizimeve kulluese dhe vaditëse

2- Plani sektorial i menaxhimit të mjedisit: Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mjedisit në Bashkinë Konispol dhe mbrojtjen e pasurive/burimeve natyrore si avantazhi më i fortë, që kjo zonë ka. Ky plan duhet të përmbajë minimalisht:

- Menaxhimin e zonës së mbrojtur Kombëtare Parku i Butrintit, si dhe zonën e Vrinës.
- Menaxhimin e monumenteve natyrore dhe kulturore.

4.7 Evidentimi i faktorëve, që mund të shkaktojnë një rishikim të pjesshëm të PPV-ve

PPV-ja është një dokument, i cili hartohet nga Bashkia mbi bazën e kërkesave dhe zhvillimeve kombëtare nën drejtimin e AKPT-së, bazuar në Ligjin 107/2014 dhe është dokumenti bazë udhëzues për zhvillimin e territorit në 15 vitet e ardhshme. Faktorët që shkaktojnë rishikimin e PPV-së, sipas pikës 2, të Nenit 26 të Ligjit 107/2014 konform procedurës që përcaktohet në të. Faktorët janë:

- Ne rastin kur kemi ndryshime të caktuara territoriale si ndarje administrative që çon në ndryshime dhe ndarje të re territoriale,
- Ne rastin kur kemi ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore.



- Në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit European.
- Procesi i rishikimit dhe i miratimit të planit realizohet sipas përcaktimeve të procedurës së thjeshtuar në përputhje me nenin 14, të VKM 607, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”. Procedura e thjeshtuar është procedura, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të rishikimit të dokumenteve të planifikimit sipas parashikimeve ligjore përkatëse. Përfundim nga ky rregull përbëjnë planet e detajuara vendore.

Procedura e thjeshtuar, zbatohet kur:

- PPV-ja e bashkisë Konispol do të rishikohet për çështje, që nuk prekin qëllimet e përmbajtjen e saj dhe nuk çenojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore;
- Rishikimi i rregulloreve të planifikimit nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale dhe të parashikimeve të planit përkatës;
- Rishikimi i dokumenteve sipas pikës 1, më lart, shoqërohet me kritere apo kushte më të hollësishme sesa dokumenti në fuqi;
- Parashikohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.

Përdorimi i procedurës së thjeshtuar ka për efekt përfundimin e miratimit të nismës, si dhe përfundimin e afateve të përcaktuara për bashkërendimin e këshillimit dhe takimin publik sipas ligjit të planifikimit dhe akteve nënligjore përkatëse



5. SHTOJCA E PPV-VE

5.1. Vlerësimet për Planin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TEKSTI
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KONISPOL MIRATOHET
KRYETARI I KKT-së

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Miratur me vendim të Këshillit të Bashkisë _____ nr. ____ datë

Hartuar nga: Bashkia

Subjekti i kontraktuar:

Subjekti mbështetës:

Me financim të:

1. Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë			
	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
1.1	Sipërfaqja e njësisë vendore	22205.781 ha	Sipërfaqet natyrore, ujore, tokat bujqësore, tokat urbane, infrastruktura
1.2	Numri i popullsisë ekzistuese	8245 banorë	Popullsia rezidenciale sipas INSTAT
1.3	Zona të rëndësishme kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	16486.90 ha	Parku Kombëtar i Butrintit Monumentet individuale të deklaruara, pyjet
1.4	Sipërfaqet e miratuara të zonave informale	-	Zonat e miratuara nga ALUIZNI
1.5	Problematika mjedisore	-	Rreziku i kontaminimit të sistemit të ujit për shkak të mungesës së infrastrukturës së kanalizimeve në luginen e Vrinës

2. Propozime të PPV-së			
	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
2.1	Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme	-	Zhvillime rezidenciale Zona ekonomike



			Infrastrukturë mbështetëse për agroekonominë Aktivitete me interes të veçantë turistik (Agrotourism-Ecotourism)
2.2	Përdorimet kryesore të propozuara të tokës	-	Rezidenciale, turizëm, bujqësi, Gjendje natyrale
2.3	Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	300-500 banore	Vlerësimi sipas studimeve ekonomike dhe demografike
2.4	Numri total i turistëve të pritshëm për 15 vitet e ardhshme	4500 turiste	Duke përfshirë edhe emigrantë që kthehen, punësimet sezonale dhe banorët e shtëpive të dyta.
2.5	Sipërfaqja totale ekzistuese e urbanizuar	324.16 ha	Sipas hartës orthophoto të vitit 2013 dhe 2015
2.6	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	92.19 ha	Shtëpitë kryesore dhe të dyta në zonat e zgjerimeve të vendbanimeve dhe zonat e reja
2.7	Sipërfaqja totale e ndërtimit të shtuar për zhvillimin e turizmit	5 ha	Zonat e agroturizmit dhe të ekoturizmit
2.8	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	27.40 ha	Sherbimet dhe zonat e aktiviteteve
2.9	Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje	20795.39 ha	Zonat natyrore, zonat bujqësore dhe zonat e trashëgimisë kulturore
2.10	Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social	-	
2.11	Sipërfaqe të gjelbra shtesë	4.44 ha	Strukturat e hapësirave të gjelbra dhe hapësirave të hapura urbane
2.12	Numri i njësive strukturore	213	Harta e njësive strukturore

3: Të dhëna financiare

	Emërtimi	Vlera dhe Njësia	Specifikime
3.1	Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale	8,891,670 Euro	Në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
3.2	Fazat e zbatimit të zhvillimit	Çdo 5 vite ose periudhat përkatëse.	Të ndara në periudha brenda vlefshmërisë kohore, të planit për njësitë dhe nënjësitë strukturore përkatëse\
3.3	Studimin teknik të parafizibilitetit		Argumentohet zgjidhja e propozuar dhe kostot e përafërta me zërat kryesore



4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim

Nr	Kapitulli/Dokumenti	Hartohet / Miratohet	Referenca Ligjore	Check list
1	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 52 i VKM 671, 29.07.2015	✓
2	Analiza dhe vlerësimi i territorit	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 53 i VKM 671, 29.07.2015	✓
3	Parashikimet e planit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Sipas Neni 54 i VKM 671, 29.07.2015	✓
4	Vlerësimi strategjik mjedisor	Hartohet dhe miratohet	Sipas Ligjin Nr. 91/2013	✓
5	Materiali hartografik	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 57 dhe Shtoiça 1 i VKM 671, 29.07.2015	✓
6	Rregullorja e PPV-së	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 56 i VKM 671, 29.07.2015	✓

5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit

Nr	Tematika e hartës	Lloji i hartës	Shkalla	Kodi i Hartës	Check list
1.	Harta bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:25.000	1	✓
2.	Harta përjashtimore	Harta e elementeve përjashtues	1:25.000	1a	✓
3.	Harta administrative	Hartë kufijtë administrativ	1:25.000	1c	✓
4.	Harta topografike	Harta terrenit	1:25000	2	✓
5.	Hartat e elementeve ekzistuese të territorit	Harta gjeologo - inxhinierike	1:25.000	2a	✓
6.		Harta hidrogeologjike	1:25.000	2b	✓
7.		Harta e rrezeve gjeologjike	1:25.000	2c	✓
8.		Harta hidrografike	1:25.000	2d	✓
9.		Harta e burimeve natyrore	1:25.000	2e	✓
10.		Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore	1:25.000	2f	✓
11.		Harta e bonitetit të tokës	1:25.000	2g	✓



12.		Rrezikshmëria sizmike	1:100.000	2h	✓
13.	Pozicionimi strategjik me raport në rajonin	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik	1:100.000 1:300.000	3	✓
14.	Vlerësimi ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punëtore.	1:100.000	4	✓
15.	Vlerësimi social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:25.000	5	✓
16.	Vlerësimi demografik	Përqendrimi i popullsisë në territor	1:25.000	5a	✓
17.	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecures së integritetit	1:25.000	7 7a	✓
18.	Harta e rëndësise kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:25.000	8	✓
19.	Problemet mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor	1:25.000	9	✓
20.	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë, funksionet dhe aktivitetet	1:25.000	10	✓
21.		Nënkategoritë, funksionet dhe aktivitetet	1:10.000	10a	✓
22.	Infrastrukturat	Rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm	1:25.000	11a	✓
23.		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza	1:25.000	11b	✓
24.		Rrjeti rrugor ekzistues	1:25.000	11c	✓
25.		Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji	1:25.000	11d	✓
26.	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rrizhvim.	1:25.000 1:10.000	12 12a	✓
27.	Tipologjitë hapësinore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe vullmit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave	1:25.000 1:10.000	13 13a 13b	✓



28.	Periferaliteti	Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të kriminalitetit; problemeve të ndryshme sociale	1:100.000	14	✓
29.	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim	1:25.000	15	✓
30.	Metabolizmi Urban	Harta e fluksit të ujit	1:25.000	16a	✓
31.		Harta e fluksit të energjisë	1:25.000	16b	✓
32.		Harta e fluksit të mbetjeve	1:25.000	16c	✓
33.		Harta e fluksit të ushqimit	1:25.000	16d	✓
34.	Sistemet Territoriale – (situate eksistuese)	5 Sistemet territoriale	1:25.000	17	✓
35.		Sistemi urban	1:25.000	17a	✓
36.		Sistemi natyror	1:25.000	17b	✓
37.		Sistemi ujor	1:25.000	17c	✓
38.		Sistemi bujqësor	1:25.000	17d	✓
39.		Sistemi infrastrukturor	1:25.000	17e	✓
40.	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:25.000	18	✓
41.	Parashikimi i përdorimit të tokës	Harta e 5 sistemeve territoriale	1:25.000	18a	✓
42.		Harta e kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara	1:25.000	18b	✓
43.		Harta e nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara	1:10.000	18c	✓



44.		Harta e zonave, poleve, korridoreve ekonomik të propozuara	1:25.000	18d	✓
45.		Harta e mënyrave të ndërhyrjes të propozuara	1:25.000	18e	✓
46.		Harta e tipologjisë të ndërtimeve	1:10000	18f	✓
47.		Harta e objekteve dhe zonave të rëndësisë kombëtare të propozuara	1:25.000	18g	✓
48.		Harta e zonave subjekt i PDV të propozuara	1:25.000	18h	✓
49.		Harta e njësive strukturore	1:25.000	18i	✓
50.		Harta e shpërndarja e popullsisë dhe planit të strehimit	1:25.000	18j	✓
51.	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm të propozuar	1:25.000	19a	✓
52.		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar	1:25.000	19b	✓
53.		Rrjeti rrugor dhe vendparkimeve publike të propozuar	1:25.000	19c	✓
54.		Rrjeti i furnizimit me energji te propozuar	1:25.000	19d	✓
55.		Hapësirave publike, rrugëve të biçikletave dhe këmbësorë të propozuar	1:25.000	19e	✓
56.		Objektet e shërbimeve sociale	1:25.000	19f	✓
57.		Transport publik	1:25.000	19g	✓
58.	Instrumentet e drejtimit të zhvillimit	Harta e instrumentet të zhvillimit të propozuara	1:25.000	20	✓
59.	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave;	1:25.000	21	✓



6. RAPORTI PËR KAPACITETET INSTITUCIONALE

Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e qeverive vendore janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe të shumëllojshme. Me gjithë përparimin e bërë gjatë dekadës së fundit, sigurimi me efikasitet dhe përgjegjshmëri i shërbimeve cilësore publike në nivel vendor po përballlet ende me sfida të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve të burimeve institucionale dhe njërëzore. Kapaciteti i kufizuar për të hartuar dhe zbatuar strategji të integruara të zhvillimit vendor dhe planeve të zhvillimit territorial, për hartimin e programit buxhetor afatmesëm vendor, aftësia për të trajtuar kompleksitetin rregullator dhe qëndrueshmërinë e strukturave të trajnimit kanë qenë disa nga sfidat kryesore për funksionimin e administratës së qeverisjes vendore.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Konispol është i domosdoshëm angazhimi i një sërë sektorësh/departamentesh në vënien me sukses në praktikë të tij, duke qenë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një koncept urbanistik. Në këtë kontekst, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe marrja e përgjegjësisë institucionale gjykohet tepër thelbësore veçanërisht për sektorët që përballen me zinxhirin e zbatueshmërisë së PPV:

Drejtoria Ekonomike është monitoruese e programit buxhetor dhe sigurohet që parashikimet e PPV-së reflektohen në PBA. Monitoron situatën e buxhetit dhe çdo vit paraqet raportin për buxhetin ku ofrohen dhe rekomandimet përkatëse për zbatimin e planit. Monitoron të ardhurat të cilat gjenerohen nga Bashkia nëpërmjet bashkëpunimit me *Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore* dhe të ardhurat, të cilat vijnë drejtpërdrejtë nga parashikimet dhe zbatimi i PPV-ve. Në fund ofron rekomandimet përkatëse dhe ndryshimet e nevojshme në PPV.

Drejtoria Juridike dhe Burimet Njërëzore mbështet *Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit*, duke ofruar konsulencën e nevojshme ligjore në zbatimin e planit. Asetet publike, veçanërisht menaxhimi i hapësirave publike dhe objekteve, marrin gjithashtu një rëndësi themelore në sugjerimet e PPV-së.

6.1 Vlerësimi i shpejtë i kapaciteteve institucionale të Departamentit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon një qasje më realiste ndaj burimeve njërëzore, që disponon sot bashkia Konispol. Kërkohet ndryshimi i procedurave, që lidhen me proceset e lejeve të ndërtimit, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e ofrimit të aplikimit *online* dhe në ofrimin e shërbimeve *online* nga Bashkia, si dhe funksionimi i Departamentit të Urbanistikës me ekspertë GIS dhe me shërbimet online të lidhura me regjistrin e AKPT-së.

Për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor janë të nevojshëm një sërë ekspertësh të të gjitha fushave që kanë të bëjnë me territorin, si ata inxhinierë hidro në terren, ekspertë GIS, ekspertë mjedisi, arkitektë dhe urbanistë.

Analiza mbi gjendjen e kapaciteteve institucionale të bashkisë së Konispolit arriti të dallojë se, mes kufizimeve, ato me ndikim më të ndjeshëm janë:

- Mungesa e kapaciteteve të specializuara dhe sidomos mungesa e stafit me arsim të lartë dhe kualifikim master, në pjesët e reja të territorit bashkiak, i cili është disa herë më i madh nga ai i që bashkia e vjetër e Konispol administronte para reformës;
- Mungesa e përvojës institucionale në trajtimin e çështjeve të agroturizmit, të mjedisit, dhe menaxhim toke i lidhur me sistemet e kullimit, kanalizimit dhe të vaditjes.
- Mungesat në të dhënat dhe informacionin mbi territorin e ri;
- Mungesat e njësive administrative në bazë materiale të domosdoshme për performancë efikase si PC, Printer, Software, etj.;

Mungesa e kapaciteteve të plota të specializuara në hartimin e planeve sektoriale lokale të menaxhimit të zonave të mbrojtura e mbetjeje urbane, si dhe të planeve të detajuara vendore.

Drejtoria e Planifikimit dhe e Monitorimit të Territorit kontrollon drejtpërdrejt zbatimin e PPV-ve për bashkinë Konispol. Shërben si koordinues edhe për sektorët e tjerë. Detajon PDV-ja sipas rastit. Hallka më e rëndësishme në procesin e monitorimit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Përgatit raportin përfundimtar të monitorimit në lidhje me ecurinë e investimeve, si dhe jep rekomandime për ndryshimet përkatëse në PPV. Koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e zbatimit të investimeve në fushën mjedisore dhe monitoron situatën mjedisore. Monitoron zbatimin e planit dhe në fund të çdo viti përgatit një raport vlerësimi ku ofron dhe rekomandimet përkatëse për PPV. Aktualisht, Drejtoria e Planifikimit & Monitorimit të Territorit përbëhet nga 7 punonjës, nga të cilët: 2 janë topografë, 1 është Inxhinier ndërtimi, 1 është inxhinier hidroteknik.

6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki

Gjatë procesit të punës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të bashkisë Konispol nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi. Për këtë, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh janë hartuar dhe renditur në vijim. Këto rekomandime prekin si zbatimin e planit vendor, ashtu dhe ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për hartimin e planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore apo dhe të masterplaneve.

Mangësitë kryesore të vëna në dukje janë:

- Mosfunksionimi i rregjistrimit të të dhënave të lidhur me AKPT;
- Vështirësi në aplikimin online të lejeve të zhvillimit;
- Mungesa e ekspertëve mjedisorë;
- Mungesë informacioni të digjitalizuar.



Bazuar mbi gjetjet e mësipërme, gjykohet se, një sërë masash do të mund të kontribuojnë në rritjen e performancës së Bashkisë Konispol sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij. Si më të rëndësishmet ndër të këto masa, renditen:

Krijimi dhe formalizimi i databazës së informacionit

- Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Konispol është krijuar një bazë e mirë informacioni, të cilën, Bashkia duhet ta mirëmbajë, ta përdorë me efikasitet dhe ta plotësojë në mënyrë vazhdueshme;
- Të plotësohet databaza e informacionit dhe inventarizimit të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe elementeve të tjerë të klasifikueshëm që përfshihen në territorin e bashkisë Konispol;
- Të plotësohet baza materiale e vetë Bashkisë, si dhe e njësive administrative me pajisje e domosdoshme për arritjen e këtij objekti si PC, Printer, softë are të nevojshëm si Autocad, GIS, etj.

Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë në fushat më prioritare.

6.1.2 Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit

Mbështetur në VKB-në e vitit 2015 për ndryshimin e funksioneve të ish-komunave dhe përfshirjen e tyre në bashkinë Konispol, në VKB nr.1, datë 04.02.2016 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në Varësi dhe të Njësive administrative 2016”, dhe në Vendimin nr. 46 datë 15.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Konispol “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Konispol dhe Institucioneve vartëse-2016”, struktura organizative e bashkisë Konispol përbëhet nga 103 punonjës.

Ka mungesa në disa kategori specialistësh dhe kjo mund të reflektohet në probleme gjatë zbatimit të planit dhe projekteve të tij, veçanërisht në njësi ku ka zona të ndjeshme me vlera dhe nën presion zhvillimi. Për këtë arsye, sugjerohet pasurimi i organikave, në fillim të njësive të caktuara, me specialistë arkitektë/urbanistë, por edhe inxhinier hidro, specialiste mjedisi dhe ekspertë GIS dhe konkretisht nevojiten të shtohen në organikë: 1 inxhinier hidro, 1 inxhinier mjedisi, 1 arkitekt pejzazhist, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 ekspert GIS.

Të hapet Departamenti i Projekteve të Huaja (PIU - *Project Implementation Unit*), që minimalisht duhet të përbëhet nga 1 specialist për agroturizëm dhe 1 ekspert për projektet ndërkufitare IPA. Ky i fundit duhet të ketë kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve, në research dhe të kenë eksperiencë të ngjashme të mëparshme. Ky departament mund të jetë me financim të Bashkisë ose në marrëveshje me donatorë të ndryshëm për të koordinuar punën në zbatimin e planit gjatë vitit të parë të zbatimit. PIU gjithashtu do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV-ve.

Planifikim proaktiv; takime me përfaqësuesit e komunitetit dhe grupeve të interesit për përgatitjen e planeve dhe raporteve. Bashkia e Konispolit synon të rrisë transparencën ndaj publikut dhe të përmirësojë shërbimet duke modernizuar dhe digjitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me



Bashkinë. Gjithashtu do të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare. Do të krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë.

Në planin afatgjatë, në vizionin e Bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve qëndrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përsa i përket planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësuesit komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qendrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurojnë me njëra-tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia. Ndihet e nevojshme ngritja e kapaciteteve për të gjithë stakeholders për procedurat e aplikimi *online* të AZHT-it.

Nevoja për infrastrukturë dhe lehtësimin e kërkesave të agjensive të shërbimeve. Në kuadër të zbatimit të PPV bashkia Konispol duhet të hartojë një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme qeveritare si dhe me partnerë të tjerë lokale apo edhe me komunitetet. Një sërë marrëveshjesh ndërlidhen me:

- Marrëveshje në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit (me Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencinë e Bregdetit) dhe zhvillimit rural;
- Marrëveshje me seksionin përkatës të Ministrisë së Bujqësisë për përmirësimin e cilësisë së tokës dhe të ruajtjes së tokës bujqësore;
- Marrëveshje në fushën e mjedisit me Agjencinë Rajonale të Mjedisit
- Marrëveshje me institucione akademike dhe profesionale lokale për ngritjen e kapaciteteve vendore në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të territorit;
- Marrëveshje me MZHU/AKPT për mbështetje në zbatimin e PPV-së;
- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar/ rajonal;
- Marrëveshje me ZRPP
- Marrëveshje me seksionin e Monumenteve të Kulturës në Ministrinë përkatëse.

Asistenca për procedurat e legalizim-rregjistrim të pronës dhe ballafaqime me çështje të tjera të planifikimit dhe të zhvillimit. Kryetari i Bashkisë Konispol ngre, me urdhër, grupin përbërës për shqyrtimin dhe këshillin teknik për lejet e ndërtimit. Grupi i ngritur me urdhër të kryetarit shqyrton dokumentacionin, si dhe përgatit me shkrim raportin teknik së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet përkatëse për kryetarin e bashkisë. Grupi duhet të përbëhet të paktën dhe jo vetëm nga:

- Përfaqësues i Drejtorisë Ligjore (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Sektorit të Planifikimit të Territorit (2 përfaqësues - njëri prej tyre kryetar i grupit të punës)
- Përfaqësues i Sektorit të Kontrollit të Territorit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Sektorit të Mjedisit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Infrastrukturës (1 përfaqësues)
- Përfaqësues nga rajoni (për njësinë administrative Konispol) ose përfaqësues nga njësi administrative ku aplikohet leja.



Grupi i punës mund të mbledhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e kërkesave për leje në mënyrë që të respektohen afatet ligjore përkatëse. Gjithashtu, për koordinimin e grupit të punës përdoret sistemi elektronik i lejeve.

6.1.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit

Përsa i përket gjendjes fizike dhe pajimit, në këtë institucion mbetet shumë për t'u përmirësuar, veçanërisht në pjesën e teknologjisë dhe pajisjeve në dispozicion të stafeve teknike. Ndërkohë, përsa i përket njësive administrative nevojiten disa ndërhyrje në zgjerimin e mjediseve, në rregullimin dhe rikonceptimin e tyre për t'i bërë efikase e për t'u përshtatur me kërkesat e reja.

Më tej, lidhur me logjistikën që pritet të mbështesë bashkinë e Konispol në zbatimin e PPV-së dhe kontrollin e zhvillimit të mëtejshëm të territorit, vlen të theksohet se do të nevojitet një përmirësim i kushteve të punës dhe përforcim i kapacitetit logjistik të Bashkisë me mjete transporti, të nevojshme për t'i bërë të gjitha territoret e reja, të përfshirë rishtaz nën këtë Bashki, të arritshme dhe menaxhueshme në kushte optimale.

6.1.4 Vlerësimi i aftësive të stafit ekzistues për të vepruar në departamentin e propozuar.

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të bashkisë Konispol nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi në aspektin e kapaciteteve institucionale. Prandaj, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh, të hartuar dhe renditur në vijim, prekin ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për veprim në departamentin e propozuar, si dhe do të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Konispol sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij. Si më të rëndësishmet ndër to renditen:

Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë në fushat më prioritare si më poshtë:

- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rezeqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.



6.2 Zhvillimi i kapaciteteve dhe marrëveshjet e zbatimit

6.2.1 Përgatitja e një raporti të shkurtër, që përcakton marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV-ve mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- Marrëveshje për zbatim projektsh të përbashkëta.
- Marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e databazës së të dhënave.
- Marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore.
- Marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike.
- Ndërgjegjësimin e publikut.
- Ngritjen e kapaciteteve vendore.
- Monitorim të situatës mjedisore.

Pasurimi i organikave me specialistë arkitektë/urbanistë, por edhe inxhinier hidro, specialiste mjedisi dhe ekspertë GIS si dhe hapja e Departamentit të Projekteve të Huaja (*PIU - Project Implementation Unit*), që minimalisht duhet të përbëhet nga 1 specialist për agroturizëm dhe 1 ekspert për projektet ndërkufitare IPA me kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV.

6.2.2 Korniza e zbatimit, e cila përdor gjetjet nga pika 4.1 dhe identifikon fazën, në të cilën shkrihen propozime organizative, administrative dhe politike dhe/ose ndryshime që mund të prezantohen.

Reforma territoriale e ka vendosur bashkinë e Konispolit në një status krejt të ndryshëm përse i takon hapësirës gjeografike-administrative në juridiksion, e si rrjedhojë problematikave dhe kompleksitetit të tyre. Vetëm fakti, që bashkia e Konispolit ka tashmë në përgjegjësinë e vet edhe hapësira jo urbane, zona rurale dhe toka me përdorime bujqësore, është një sfidë e konsiderueshme për punën e përditshme të këtij institucioni. Si rrjedhojë, këto ndryshime të mëdha dhe nevojat tepër të ndryshme të qytetarëve dhe të territorit në zhvillim, kërkojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale në të tjera nivele, për të përballuar me sukses realizimin e këtij Plani të Përgjithshëm Vendor.

Sipas Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, fuqizimi i administratës vendore është një objektiv kryesor në suksesin e një sërë reformave si ajo territoriale, ajo e decentralizimit të administratës publike në nivel vendor etj. veçanërisht një sfidë e madhe është ajo e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore. Strukturat e bashkive të reja po rishikohen në mënyrë që të përshtaten me ndryshimet e reja, për të siguruar koherencë të mirë mes politikave të hartuara dhe të zbatuara në nivel vendor. Performanca e kërkuar dhe kapaciteti adekuat i administratës vendore do të arrihen përmes promovimit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe trajnimeve afatshkurtër dhe afatgjatë. Trajnimet e vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë duhet të organizohen në fushat më prioritare si në:

- Planifikim dhe menaxhim territori;
 - i. Hartim politikash zhvillimi
 - ii. Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit



- iii. Përdorim i GIS dhe Regjistrimit të Territorit
- iv. Menaxhim projektesh
- v. Rregulla të përdorimit të tokës
- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

Tabela 31. Modulet e trajnimit

Module trajnimi	Përmasat	Kosto e trajnimit	Fazat e Zbatimit			Institucionet përgjegjëse	Burimet / Ekspertët	Përfituesit
			I: '16-20'	II: '21-25'	III: '26-31'			
Promovimi dhe vendosja e <i>Brend-it</i> për produktet lokale.	—	15,000				Bashkia Konispol	Ekspertë marketingu dhe vecanërisht ekspertë të manaxhimit të markave/brandeve	1- Specialistët e bashkisë dhe të njësive administrative; dhe 2- Fermerët kultivues të produkteve
Promovimi i aktiviteteve të reja për turizmin aktiv natyror (eksplorim shpellash, ngjitje etj).	—	8,740				Agjensia Kombëtare e Turizmit	Ekspertë të shërbimeve turistike dhe të promocion-marketingut të tyre.	1- Specialistët mjedisorë e të turizmit të bashkisë e të njësive administrative; 2 - Udhërrëfyesit vendas
Promovimi i bashkëpunimit me bashkinë e Sarandës.	Vjetore	10,000				Bashkia Konispol/ Bashkia Sarandë	Ekspertë të burimeve njerëzore dhe specialistë	Specialistët e departamenteve simotra nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave (ekonomi, turizëm)
Promovimi i prodhimit vendas në bizneset e turizmit.	25 shtëpiza malore	2,740				Bashkia Konispol/ Agjensia Kombëtare e Turizmit	Ekspertë të shërbimeve turistike, të manaxhimit të produkteve ushqimore, të shërbimeve mikpritëse.	Bizneset e vogla dhe ato familjare të turizmit, hotelierisë, të shërbimeve mikpritëse dhe fermerët.
Promovimi i ndërmarrjes në sektorin e agro-turizmit (30 start up).	30 fermerë	1,500				Bashkia Konispol	Ekspertë biznesi, ekspertë të shërbimeve turistike.	30 fermerë për t'u kthyer në sipërmarrës të turizmit.
Iniciativa dhe programe për nxitjen e riciklimit dhe ndërgjegjësimin mjedisor.	min 2 herë në vit	10,000				Bashkia Konispol	Ekspertë mjedisorë dhe ekspertë riciklimi	1- Komuniteti rrit ndërgjegjësimin ndaj çështjeve të ruajtjes së mjedisit. 2 - Specialistët e mjedisit në bashki dhe në njësi administrative.
Përmirësimi i kapaciteteve të bashkisë në zhvillimin e projekteve dhe tërheqjen e fondeve.		40,000				Bashkia Sarandë	Ekspertë për aplikim në projektet IPA, Cross Border.	Specialistët e departamentit të projekteve të huaja (PIU)



Sherbim Konsulence, për Hartimin e Planeve te Përgjithshme Vendore, për Kater Bashki, Vlore, Sarande, Himare, Konispol

Permirësimi i kapaciteteve për zbatimin e planit dhe aplikimin e PDV		20,000				AKPT/MZHU	Ekspertë të urbanistikës, të infrastrukturës dhe ekspertë GIS	Specialistët e Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit
Aplikimi i instrumente tatimore mbi tokën në përputhje me ligjin e urbanistikës	2 herë në vit	20,000				Bashkia Konispol AKPT MZHU	Ekspertë tatimorë, ekspertë të urbanistikës dhe ekspertë ligjorë.	Kalimi në Keshillin bashkiak i të paktën dy instrumentave tatimorë për menaxhimin e taksave të pronës dhe turizmit dhe trajnimi i stafit 2 herë në vit.



7. DËGJESA ME PUBLIKUN

U mbajt në datë 08.12.2016, ora 13:30 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Konispol. Prezantimi i planit u bë nga drejtuesi i ekipit, Z. Thanos Pagonis, ndërsa Kryetari i Bashkisë pasi falënderoi për punën e bërë nga stafi për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Konispol, kërkoi ndërhyrjen në zgjidhjen e problematikave të mëposhtme:

1. Zona e mbrojtur e Butrintit ka zënë një sipërfaqe shumë të madhe të pajustificueshme larg qytetit antik dhe bllokoi zhvillimin e një pjese të vogël të plazheve, që ka në administrim bashkia Konispol. Ne kërkojmë që, në këtë zonë të kihet mundësi të zhvillohen aktivitete në shërbim të plazhistëve dhe të bëhet një zonë atraktive në shërbim të turizmit
2. Të shihet mundësia e zhvillimit të zonës ekonomike sipas kërkesave, që ne kemi bërë.
3. Shohim se, zona e Shkallës është vendosur zonë e mbrojtur me monumente, kur aty nuk ka monumente. Ne kërkojmë që, kjo zonë të jetë zonë zhvillimi, pasi është nyja lidhëse e rrugëve të Konispolit dhe synojmë të bëhet qendra e dytë administrative dhe të jetë zonë me zhvillim ekonomik.
4. Të dy anët e rrugës nacionale të Konispolit të shndërrohen në zona ekonomike me aktivitete shërbimesh dhe tregtare.
5. Per zgjerimet e fshatrave:
 - Xarre është në zhvillim dhe gjendja aktuale nuk e përballon këtë zhvillim; prandaj kërkon shtrirje në zonën e kullotave.
 - Mursia kërkon zgjerim mbi varrezat dhe të bëhet kombinim i zonave ekonomike dhe rezidenciale.
 - Shkalla kërkon mundësi zgjerimi, sepse ndodhet në mesin e arte të territorit të Bashkisë.
 - Shalësi, zona përtej përroit është e aksidentuar, të shihet mundësia e zgjerimit.
 - Verva kërkon shtesë dhe mundësi zhvillimi të ekoturizmit.
 - Dishat kërkon shtesë dhe mundësi zhvillimi të ekoturizmit.

Nga banorët që ishin pjesëmarrës në takim, *Pjetër Perkeqi, banor i fshatit Shendëlli*, kërkoi zhvillim urban në zonën e mbrojtur të Butrintit, të lejohet mundësia e zhvillimit të turizmit, të lejohet të jepen leje për kategoritë e ndërtimeve N4.





Figura 14. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV Konispol



Figura 15. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV-në Konispol



Figura 16. Foto nga takimi i dëgjësës publike për PPV-në Konispol



FORUMI

U zhvillua në datë 07.12.2016, ora 11:00, në Hotel Mondial. Morën pjesë përfaqësues të bashkive të LOT6 dhe të bashkive kufitare, të Agjensisë së Zonave të Mbrojtura, të Ministrisë së Kulturës, të AKPT-së, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Bujqësisë, të Agjensisë së Zhvillimit të Rajoneve, të Qendrës Rajonale të Mjedisit, të GIZ dhe ekspertët e LOT6.

Sipas përfaqësuesit të bashkisë Konispol, kërkohet zgjerimi i fshatrave, si: Xarrë, Mursi dhe Konispol. Gjithashtu banorët kërkojnë përdorimin e zonave detare, që janë aktualisht zona të mbrojtura.

Sipas përfaqësuesit të Agjensisë së Zonave të Mbrojtura, Z. Sulejman Xhepa, përse i përket Konispolit, është rënë dakord për mundësinë e daljes në det dhe zhvillimin e ekoturizmit.

Përfaqësuesi i Agjensisë së Zhvillimit të Rajoneve u interesua për projektet e rëndësishme të infrastrukturës, ra dakord për siluetat mbajtëse, u interesua për komunikimin dhe mundësinë e lidhjes mes fshatrave dhe bashkive, u interesua për rrugët e reja ndërrajonale të propozuara.

Përfaqësuesi i Qendrës Rajonale të Mjedisit u interesua për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe presionin e periudhës turistike, ku manaxhimi i ujërave është i papërballueshëm. A i ka kushtuar vëmendje Vlerësimi Strategjik Mjedisor intensifikimit të rritjes urbane?

Përgjigja - Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe metabolizmi kanë marrë në konsideratë rritjen e e popullsisë dhe pikun e sezonit turistik. Fshatrat e largët do të grupohen dhe do të lidhen tubacione, ndërsa për shtëpitë e veçuara do të përdorin gropa septike.

Sipas përfaqësuesit të Ministrisë së Kulturës u vu theksi te kujdesi me zonat buferike të pjesës së pasurisë kulturore. Ai këshilloi hartimin e PDZHK, por kujdes me zhvillimin e kësaj zone.

Drejtoresha e AKPT-së, Znj. Adelina Greca, lidhur me zonën Sarandë-Konispol, ra dakord me parkun në fushën e dikurshme të aviacionit. Por deklaroi se, zhvendosja e varrezave të Sarandës është e vështirë e mund të krijojë probleme sociale.

Koordinatorja në AKPT për LOT6, Znj. Fiona Mali pyeti për propozimet e zhvendosjes së landfillit të vjetër. Përgjigja ishte: afër kufirit të Bashkisë. Landfilli aktual është në Bajkaj dhe Himara e Konispoli i dërgojnë mbetjet në Bajkaj.

